



RAPORTI **VJETOR 2023**

PËRMBLEDHJE:

Kush jemi ne	2
Objektivat tona.....	3
Vizioni ynë	3
Fjala e Administratorit	4
Modeli Administrativ	7
Drejtimi i Kompanisë	12
Viti 2023, në Numra	13
Rrjeti i Transmetimit	15
Kuadri ligjor dhe Rregullator	21
Kontrolli i Brendshëm dhe Menaxhimi i Riskut	25
Tregu i Energjisë Elektrike.....	29
Siguria Kibernetike	43
Tregu i Transmetimit të Dhënave për Komunikimet Elektronike	44
ALPEX - Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike	45
Operimi - Energjia në Sistemin e Transmetimit	52
Investimet.....	64
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	69
Mjedisi.....	71
Pjesëmarrje në organizmat rajonale	74
Raporti i Audituesve të Pavarur	79
Pasqyrat Financiare Të Konsoliduara 2023	83
Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare Të Konsoliduara	89

KUSH JEMI NE

Numri unik i identifikimit të subjektit	K42101801N
Data e Regjistrimit	01.09.2004
Emri i Subjektit	OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST sh.a.
Data e themelimit	09.07.2004
Adresa	Autostrada "Tiranë-Durrës", km 9, Yrshek, Kashar TIRANË

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) është një kompani publike me 100 % të aksioneve në pronësi të shtetit;

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike;

Ne sigurojmë shërbim me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit, bazuar në standardet, arritjet dhe praktikat më të mira, të cilat aplikohen nga operatorët e sistemeve të transmetimit të ENTSO-E, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe duke mundësuar rrugën drejt një sistemi të besueshëm dhe të qëndrueshëm të shkëmbimit të sigurt dhe cilësor të energjisë elektrike në vend dhe rajon.

OBJEKTIVAT TONA

- ▮ Të ofrojmë sigurinë e furnizimit me energji elektrike;
- ▮ Të sigurojmë besueshmërinë e furnizimit kombëtar dhe rajonal, me energji elektrike;
- ▮ Të zhvillojmë kapacitetet ndërkufitare në përputhje me projektet rajonale dhe më gjerë në bashkërendim me planet dhe projektet zhvillimore të rajonit;

VIZIONI YNË

LIDHJA QË TRANSMETON ZHVILLIM

Operatori i Sistemit të Transmetimit është i angazhuar maksimalisht në zhvillimin e vazhdueshëm e të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit, me qëllim përmbushjen e kërkesës aktuale dhe të ardhshme për energji elektrike, në tregun vendas e rajonal.

FJALA E ADMINISTRATORIT

Të dashur lexues,

Viti 2023 ka qenë një vit sfidues, i ndikuar nga pasojat e luftës në Ukrainë, por edhe shumë frytdhënës për OST, ku kemi arritur të përballojmë sfidat e tregut evropian të energjisë dhe të vazhdojmë të rritemi si një anëtar i plotë i ENTSO-E dhe Med TSO.

Ne kemi nxjerrë mësim të çmuara nga kjo situatë, të cilat kanë kontribuar në përsosjen e strategjive dhe veprimtarive tona.

Për të përballuar sfidat e sektorit të energjisë, OST ka ndërmarrë hapa të guximshëm dhe të vendosur. Kemi investuar në njerëzit tanë, në teknologji dhe në procese që na ndihmojnë të jemi më elastikë dhe të përgjigjemi me shpejtësi ndaj ndryshimeve të tregut. Kjo ka qenë thelbësore, veçanërisht në një kohë kur tregu evropian i energjisë ka përjetuar ndryshime të mëdha dhe sfida, siç janë rritja e kërkesës për energji të rinovueshme dhe nevoja për të diversifikuar burimet e furnizimit.

OST ka vazhduar të operojë në përputhje me standardet më të larta, të diktuar nga rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar që rrjeti ynë të mbetet një nga shtyllat kryesore për rritjen ekonomike të vendit.

Ky vit ka qenë një periudhë transformimi dhe rritjeje, ku investimet e kryera kanë qenë thelbësore në arritjen e objektivave tona strategjike.

Investimet e vitit 2023 u drejtuan nga një vizion strategjik për të ndërtuar një sistem të transmetimit më të sigurt, më cilësor dhe më të qëndrueshëm, duke u përgatitur për sfidat e ardhshme dhe duke mbështetur një të ardhme të qëndrueshme energjetike. Këto investime ishin kritike për të garantuar stabilitetin dhe eficiencën e infrastrukturës sonë.

Gjatë këtij viti, ka përfunduar me sukses projekti i ndërtimit dhe energjizimit të Nënstacionit Shumbat 220/110/35 kV me fuqi të instaluar 120 MW dhe i linjës 220 kV që lidh këtë nënstation me Nënstacionin Koms, rreth 47 km e gjatë duke përmirësuar ndjeshëm treguesit e sigurisë dhe reduktimit të kohës së ndërprerjeve në zonën verilindore të vendit, një hapësirë e madhe në të cilën janë të instaluar një numër i lartë centralësh hidrike jo vetëm në rrjetin e transmetimit por dhe në atë të shpërndarjes. Po ashtu, ky investim ka rritur kapacitetet për të akomoduar lidhjet e burimeve të reja të energjisë, kryesisht hidrocentrale, duke maksimizuar përdorimin e burimeve të energjisë të pastër.

Ne jemi të përkushtuar për të ndërtuar një të ardhme miqësore me ambientin dhe të qëndrueshme në kohë, dhe si dëshmi e kësaj, kemi arritur të energjizojmë parkun fotovoltaiik Karavasta, më i madhi në Ballkanin Perëndimor. Kjo iniciativë jo vetëm që rrit larmishmërinë e burimeve tona të energjisë, por gjithashtu shpreh vendosmërinë tonë për të përfshirë energjinë e rinovueshme në mënyrë të qëndrueshme.

Në vijim të këtij angazhimi në vitin 2023 ka marrë jetë projekti më ambicioz i ndërmarrë nga OST këto vitet e fundit për lehtësimin e integritit të burimeve të reja të rinovueshme në një nga zonat me potencialin dhe kërkesat më të larta për zhvillimin e gjeneruesve të rinj kryesisht nga centralet fotovoltaike siç është ndërtimi i Nënstacionit të ri 220/110 kV në Hoxharë dhe i ndërtimit të linjës 220 kV me dy qarqe Nënstacioni Hoxharë – Nënstacioni Fier – Nënstacioni Babicë.

Ky nënstation do të lidhet me nënstationin e përfunduar të Hoxharës 110/35/20 kV të ndërtuar nga operatori i shpërndarjes dhe me përfundimin e tij aftësia akomoduese do të arrijë deri në 450 MW duke e kthyer rajonin e Fierit në një qendër të rëndësishëm energjitike të vendit.

Gjithashtu në fund të vitit 2023, nisi puna në terren për ndërtimin e linjës 400kV Shqipëri-Maqedoni e Veriut me kapacitet 1500 MW, si një nga komponentet kryesore infrastrukturore të Korridorit VIII që lidh detin Mesdhe me detin e Zi dhe ku Shqipëria gjendet në zemër të tij, një projekt me impakt jo vetëm rajonal por dhe më gjerë Evropian.

Përveç kësaj, OST ka qenë pjesë e iniciativave të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare, duke punuar ngushtë me partnerët tanë në ENTSO-E dhe Med TSO për të promovuar integrimin e tregjeve të energjisë dhe për të përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërkufitar. Kjo ka qenë veçanërisht e rëndësishme në një kohë kur sfidat e sigurisë energjetike janë bërë më të dukshme, dhe nevoja për një qasje të përbashkët dhe të koordinuar është më e madhe se kurrë.

Në këtë mënyrë, në perspektivën afatgjatë, viti 2023 ka shënuar një gur themeli për nisjen dhe përparimin në partneritete strategjike për ndërtimin e linjave të reja të interkoneksionit pothuajse me të gjitha vendet fqinje, veçanërisht me Greqinë Kosovën , Malin e Zi por dhe me Italinë, duke hapur rrugë për një treg energjetik më të gjerë dhe më të integruar.

Në fillim të vitit 2023, Bursa Shqiptare e Energjisë, ALPEX nisi zyrtarisht tregtimin e energjisë elektrike, duke u bërë bursa e dytë operationale në rajon. Operimi i bursës së energjisë dhe realizimi i ankandit të parë në tregun e ditës në avancë në Shqipëri janë hapa të rëndësishëm drejt liberalizimit të tregut të energjisë dhe ofrimit të

mundësive të reja për aktorët e tregut. Këto zhvillime janë dëshmi e angazhimit tonë si pjesë e ALPEX për transparencë , konkurrencë të frytshme dhe për të ofruar çmime më të mira për konsumatorët.

Në fushën e sigurisë kibernetike, OST ka ndërtuar një mjedis të fortë të sigurisë që mbron infrastrukturën, platformat dhe sistemet teknologjike nga sulmet e mundshme. Për të adresuar sfidat e sigurisë, kemi implementuar masa të rëndësishme organizative, duke përfshirë ndërgjegjësimin e stafit dhe rritjen e kapaciteteve të monitorimit të rrjeteve. Trajnime të shumta janë zhvilluar për të rritur vetëdijen dhe aftësitë e stafit në menaxhimin e rrezeve kibernetike. Përveç kësaj, janë kryer investime të konsiderueshme në teknologji inovative dhe kemi krijuar partneritete strategjike me ekspertë të fushës së sigurisë. Ky angazhim i vazhdueshëm ka bërë të mundur që kompania sot të jetë në një pozicion të fortë për të përballuar sfidat e këtij mjedisi të ndërlikuar kibernetik dhe për të ruajtur besueshmërinë dhe efikasitetin e operacioneve të saj.

Jemi të përkushtuar në zhvillimin e vazhdueshëm të protokolleve tona të sigurisë për të garantuar që jemi gjithmonë një hap përpara në parandalimin e kërcënimeve të mundshme.

OST është e angazhuar vazhdimisht në përmirësimin e performancës dhe efikasitetit të saj, për të përmbushur pritshmëritë e shtuara të palëve të interesit. Ne jemi të vendosur të punojmë në mënyrë të ngushtë me partnerët tanë dhe të adoptojmë një qasje të guximshme ndaj inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm për të përballuar sfidat që na presin. Investimi në ekipin tonë do të vazhdojë të jetë një prioritet, pasi besojmë se talenti dhe përkushtimi i tyre janë burimi ynë më i madh i suksesit.

Për të përmbyllur, theksoj se suksesi ynë nuk është vetëm rezultat i përpjekjeve individuale, por është fryt i punës së përbashkët së 850 punonjësve dhe vizionit të përbashkët. Ndërsa shikojmë drejt vitit 2024, ne jemi të vendosur të vazhdojmë me të njëjtin zell dhe inovacion, duke u përqendruar në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit energjetik dhe në kontributin tonë ndaj një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe prosperuese për të gjithë.

Faleminderit,

Skardi Drenova

Administrator i OST sh.a.

MODELI ADMINISTRATIV

DEKLARATA E QEVERISJES SË SHOQËRISË

Kjo deklaratë përmban aspektet kryesore të kuadrit ligjor, nënligjor në bazë të së cilës OST ushtron veprimtarinë e saj, e cila bazohet në:

- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji 43/2018 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Statuti i shoqërisë si dhe aktet e brendshme rregullatore.

ORGANET DREJTUESE DHE PËRBËRJA E TYRE

Operatori i Sistemit të Transmetimit - OST sh.a. është krijuar dhe funksionon në formën e shoqërisë aksionere në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, regjistruar si person juridik me Vendimin nr.31935, datë 17.04.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OST sh.a. është e organizuar në formën e shoqërisë aksionere me kapital 100 % shtetëror me aksioner të vetëm Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas përcaktimeve të VKM nr.503, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, si përfaqësuese të Shtetit, si pronar të aksioneve të OST sh.a., si dhe VKM nr.317, datë 24.07.2016 “Për përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si pronar të Shoqërive të Sektorit të Energjisë Elektrike”.

Bazuar në një sistem administrimi me 2 nivele, organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e Përgjithshme
- Këshilli Mbikëqyrës
- Administratori

që ushtrojnë kompetencat e tyre sipas përcaktimeve të ligjit për shoqëritë tregtare dhe Statutit të Shoqërisë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme është organ drejtues i shoqërisë që vendos për çështjet e lidhura me veprimtarinë dhe funksionimin e shoqërisë.

Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit është Ministria e Ekonomisë dhe Financave që vepron në cilësinë e Aksionerit të Vetëm dhe përfaqësohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë që merr vendime për Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë.

KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse në marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
4. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
5. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
6. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
13. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Këshilli Mbikëqyrës është organ drejtues i shoqërisë që ka kompetenca mbikëqyrje mbi veprimtarinë e Administratorit, anëtarët e të cilit emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, me një mandat me afat tre vjeçar, me të drejtë riemërimi.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë emëruar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e përfaqësuesit të Aksionerit të Vetëm të OST, në bazë të nenit 135 pika “b” të Ligjit për shoqëritë tregtare, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a. përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë.

Më 31 Dhjetor 2023, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a. përbëhet nga:

KRYETARI



Znj. Vasilika Vjero

ANËTARËT



Znj. Viola
Haxhiademi



Znj. Merita
Gurabardhi



Z. Nikolla
Lera



Z. Klodian
Mene



Z. Antonio
Bushati

KOMPETENCAT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

1. Këshilli Mbikëqyrës emëron Administratorin e shoqërisë.
2. Këshilli Mbikëqyrës në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të politikave tregtare të shoqërisë dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin. Ai ka në kompetencë:
 - a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga Administratori;
 - b) të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë;
 - c) të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
 - d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga Administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe një përkthim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

- g) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, dhe raporti i auditimit drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit. Raporti i Këshillit Mbikëqyrës, përmendur në shkronjën "f" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- h) të miratojë Programin Vjetor dhe ndryshimet e tij, si dhe veprimtarinë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë të paraqitur nga Administratori;
- i) të aprovojë hapjen e veprimtarive ose e njësive të reja (degë, përfaqësi etj, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë) sipas legjislacionit në fuqi;
- j) të përcaktojë shpërblimin e Administratorit;
- k) të miratojë krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda kufijve të ligjit sipas përcaktimeve të nenit 5 pika 5.1 të këtij Statuti.

KUFIZIMET E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

1. Nuk mund të zgjidhet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës administratori i shoqërisë, administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 13 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës nuk duhet të jetë anëtar i më shumë se dy këshillave mbikëqyrës të shoqërive të krijuara sipas të drejtës shqiptare.
3. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të një shoqërie konkurrenente.

NDRYSHIMET NË PËRBËRJEN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS GJATË VITIT 2023

Gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2023, janë bërë 2 (dy) ndryshime në përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës dhe është riemëruar 1 (një) anëtar i tij nga Asambleja e Përgjithshme.

ADMINISTRATORI

Administratori është organ drejtues i shoqërisë i cili ushtron administrimin e përditshëm të saj dhe vënien në zbatim të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit Mbikëqyrës.

Administratori emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës në bazë të parashikimeve të nenit 158 të ligjit për shoqëritë tregtare si dhe të nenit 20.1. të Statutit të OST, për një afat deri në 3 vjet, me të drejtë riemërimi.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, OST është drejtuar nga Z. Skerdi Drenova i riemëruar si Administrator me vendim nr.3 datë 28.03.2022 “Për riemërimin e administratorit të shoqërisë OST sh.a., të Këshillit Mbikëqyrës

KUFIZIMET E MANDATIT TË ADMINISTRATORIT

Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe Administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë.


EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin. Me shkresën nr. 23928 prot. datë 28.12.2023 “Mbi caktimin e Audituesve Ligjorë për certifikim bilanci” Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka emëruar Audituesit Ligjorë për të kontrolluar dhe certifikuar llogaritë vjetore të OST për vitin 2023. Në bazë të kësaj shkrese, ndërmjet OST dhe Audituesve Ligjorë është lidhur kontrata nr. 882 prot., datë 07.02.2024. “Për kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2022 të shoqërisë OST sh.a.”



DREJTIMI I KOMPANISË

Drejtuesit e OST, të tillë si Kryetari dhe Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Administratori dhe stafi drejtues (drejtuesit e njësive strukturore), duhet të jenë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të përditshme.

STRUKTURA E DREJTIMIT TË OST SH.A. MË 31 DHJETOR 2023 ISHTE SI MË POSHTË:




VITI 2023, NË NUMRA



TREGUESIT
TEKNIK



TREGUESIT FINANCIAR



765
PUNONJËS

Gjatë vitit 2023, numri mesatar i konsoliduar i punonjësve në kompani, ka rezultuar i tillë



40
MILLION

Të ardhurat e rezultuara për transmetimin e të dhënave



2,124
MILLION

Shpenzimet për blerjen e humbjeve të energjisë në transmetim



0.85
Lekë/kWh

Tarifa e shërbimit të transmetimit

RRJETI I TRANSMETIMIT

Në bazë të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, OST ka në pronësi sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, që përfshin linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, nënstationet e transformimit të energjisë elektrike me nivele të transformimit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV si edhe zbarat 110 kV në të gjitha nënstationet 110/TM kV, deri në pikën e matjes së energjisë në anën 110 kV të transformatorëve 110/TM kV, përfshirë pajisjet kyçëse/shkyçëse të linjave 110 kV.

Rrjeti 400 kV është zhvilluar vitet e fundit, veçanërisht për interkoneksionet me vendet fqinje dhe është i integruar me rrjetin rajonal. Nga pikëpamja konstruktive rrjeti 400 kV është një rrjet i fuqishëm, i përbërë nga linja relativisht të reja me përcjellës ACSR 2x490/65 mm², me kapacitet transmetues 1,350 MVA.

Burimet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura me qendrat kryesore të konsumit nga rrjeti 220 kV dhe më tej, përmes transformimit 220/110 kV (rrjeti 110 kV furnizon të gjitha nënstationet e shpërndarjes 110 kV që përfaqësojnë kryesisht nyjen e ngarkesës). Linjat 220 kV janë linjat kryesore lidhëse të rrjetit të brendshëm të transmetimit të ndërtuara kryesisht me përcjellës të vjetër ACO dhe me seksione 300 mm², 360 mm², 400 mm², 500 mm² me kapacitet termik që varion nga 269 MW deri në 371 MW, ndërsa janë në shfrytëzim dhe linja të ndërtuara me përcjellës ACSR 490/65 mm² me kapacitet 371 MW që përbën dhe standardin e ndërtimit të linjave për këtë nivel tensioni.

Rrjeti 110 kV shtrihet në të gjitha zonat urbane në Shqipëri dhe furnizon nënstatione të tensionit 110 kV që i përkasin sistemit të shpërndarjes, si dhe klientët e tjerë të cilët janë të lidhur direkt me këtë rrjet. Disa nga centralet në pjesën më të madhe hidrike, që arrijnë në rreth 587 MW në kapacitet prodhimi, janë të lidhur me rrjetin 110 kV dhe shumë të tjerë që janë në fazën e ndërtimit janë parashikuar të lidhen së shpejti në nivelin 110 kV dhe 220 kV. Linjat 110 kV (me përjashtim të atyre të ndërtuara vitet e fundit) janë kryesisht me seksione të përcjellësave ALÇ 120 mm² (73 MVA) dhe në çdo rast ALÇ 95 mm² (64 MVA).

Gjatë vitit 2023, në rrjetin e transmetimit është energjizuar centrali i dytë fotovoltaik, Impianti Fotovoltaik Karavasta me fuqi të instaluar totale prej 140 MWp, lidhur në anën 220 kV të Nënstationit 220/110/35/20 kV Fier duke rritur më tej kapacitetin e instaluar nga Burimet e rinovueshme të energjisë dhe diversifikimin e tyre në vend.

Gjatësia e linjave të sistemit të transmetimit, në përputhje me nivelin e tensionit

Niveli i Tensionit	Gjatësia
Linja transmetimi 400 kV	445.7 km
Linja transmetimi 220 kV	1,297.4 km
Linja transmetimi 154 kV	34.4 km
Linja transmetimi 110 kV	1,701 km

4,621 MVA

fuqi transformatorike të instaluar

2,441 MW

kapacitet të instaluar gjenerimi

Sistemi shqiptar i transmetimit është i lidhur me sistemet fqinje të Kosovës, Malit të Zi dhe Greqisë. Shqipëria ka tashmë 6 linja interkonjeksiioni të shkëmbimit ndërkuftar:

Shteti	Emërtimi i Linjës	Niveli i tensionit	Lloji i Përcjellësit	Gjatësia në territorin shqiptar (km)	Viti i Operimit
Greqi	Zemblak-Kardia	400 kV	ACSR 2x490/65	19.3	1984
	Bistrica 1 - Igumenicë	150 kV	ACSR 185/30	34.4	1974
Kosova	Fierzë-Prizren	220kV	ACSR 400/50	26.3	1987
	Koman - Kosova B	400kV	ACSR 2x490/65	51.5	2016
Mali i Zi	Koplik-Podgoricë	220kV	ACSR 360/40	44.75	1972
	Tirana 2 - Podgoricë	400kV	ACSR 2x490/65	125.5	2010

Aktualisht, OST operon impiantet e tensionit të lartë në:

- 4 Nënstacione 400 kV
- 22 Nënstacione 220 kV
- 105 Nënstacione 110 kV

Më poshtë, janë listuar Nënstacionet në pronësi dhe të operuar tërësisht nga OST.

Nr	Nënstacioni		Fuqia e Instaluar (MVA)	Njësia Operative
1	400 kV	N/st 400/220kV Koman	345	Shkodër
2		N/st 400/220kV/110kV Tirana 2	840	Tiranë
3		N/st 400/220kV Elbasan 2	600	Elbasan
4		N/st 400/110kV Zemblak	300	Korçë
5	220 kV	N/st 220/110kV V.Dejës	240	Shkodër
6		N/st 220/110kV Fierzë	120	Shkodër
7		N/st 220/110kV Koplik	90	Shkodër
8		N/st 220/110kV Burrel	120	Shkodër
9		N/st 220/110kV/20kV Tirana1	486	Tiranë
10		N/st 220/110kV Sharrë	190	Tiranë
11		N/st 220/110kV Rrashbull	200	Tiranë
12		N/st 220/110kV Elbasan 1	330	Elbasan
13		N/st 220/110kV Fier	360	Fier
14		N/st 220/110kV Babicë	200	Fier
15		N/st 220/110kV Shumbat	120	Shkodër
16		150 kV	N/st 110/150kV Bistrice 1	80
TOTAL			4,621	

Kapaciteti i Instaluar sipas Nënstacioneve (MVA)





Diagrama Njëvijeëhe – Janar 2024



**SKEMA NJËFAZORE E SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK SHQIPTAR
NË NIVELIN 400-220-150-110 KV.**

MIRËMBAJTJA E SISTEMIT

OST sh.a. mirëmban dhe zhvillon infrastrukturën për rrjetin e transmetimit. Kjo infrastrukturë lejon transmetimin e energjisë dhe adoptimin e teknologjive inovative për rritjen e efijencës dhe besueshmërisë së sistemit. Çdo ndryshim në rrjetin e transmetimit kryhet me anë të konsultave të specialistëve të OST sh.a., të cilët analizojnë në mënyrë efektive nga ana e kostos dhe duke pasur në fokus sigurinë.

Për të garantuar një punë të sigurt të Sistemit Elektroenergjetik, një kujdes i veçantë i kushtohet mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit duke kryer me rigorozitet dhe cilësi të gjithë remontet e planifikuara, duke eliminuar në një kohë sa më të shkurtër avaritë dhe defektet që ndodhin në sistemin e transmetimit si dhe monitorimit online të pajisjeve kryesore të nënstacioneve.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, u bë i mundur realizimi i të gjitha remonteve të planifikuara dhe është ndërhyrë në kohë rekord për eliminimin e të gjitha avarive që janë shfaqur në sistem.


316 orë

stakime gjatë vitit 2023

542

stakime gjatë vitit 2023

Numri i stakimeve sipas natyrës



423 STAKIME TRANZITORE-JANË RREGULLUAR BRENDA DISA MINUTASH

119 STAKIME TË QËNDRUESHME TË RREGULLUARA NË KOHË REKORD GJATË VITIT 2023



LIDHJET E REJA

Për sa i takon procedurave për lidhje të reja, si dhe statusit të aplikimeve për lidhje me rrjetin e transmetimit, për periudhën Janar-Dhjetor 2023 ka patur një sërë aplikimesh për mundësinë e lidhjes së centraleve prodhuese të energjisë elektrike në zona të ndryshme të sistemit elektroenergetik, të përmbledhura si më poshtë:



Centrale të tipit “Gjenerues Hidrik”, 5 aplikime, fuqia totale e kërkuar 64.33 MW, realizuar 3 Marrëveshje Lidhjeje.



Centrale të tipit “Gjenerues Solar”, 83 aplikime, fuqia totale e kërkuar 5,620.82 MWp, realizuar 2 Marrëveshje Lidhjeje.



Centrale të tipit “Gjenerues Eolik”, 50 aplikime, fuqia totale e kërkuar 4,874.10 MW, realizuar 1 Marrëveshje Lidhjeje. Të gjitha aplikimet për këtë kategori kanë qenë për ndërtimin e tyre në tokë.



Centrale të tipit “Gjenerues Termik” 2 aplikime, fuqia totale e kërkuar 300 MW, nuk është realizuar asnjë Marrëveshje Lidhjeje.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është vënë në operim një burim gjenerues, i tipit solar i lidhur në rrjetin e transmetimit 110 kV:

- Impianti Fotovoltaik Karavasta 140 MWp, lidhur në anën 220 kV të Nënstacionit 220/110/35/20 kV Fier, dhjetor 2023,

Kërkesat për lidhjen e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit janë trajtuar edhe mbështetur në VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 i ndryshuar dhe VKM Nr.718, datë 12.10.2016.

Gjithashtu, janë trajtuar dhe kërkesat për lidhje me rrjetin e centraleve eolike në kuadër të ankandit të Erës për përzgjedhjen e projekteve të erës në tokë që do të përfitojnë masa mbështetëse, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të finalizuar në muajin korrik 2023 si vijon:

- Shoqëria Voltalia s.a ka marrë miratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Centralit Eolik South Wind Park, me fuqi të instaluar 75 MW.
- Konsortiumi GURIS INSAAT VE MUHENDISLIK A.S””MORGAN ENERGI YATIRIM HOLDING A.S” dhe “BRD ENERGY” sh.p.k ka marrë ri-miratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Parkut Eolik Kryevindh, me fuqi të instaluar 74.4 MW.
- Shoqëria VERBUND Green Power Albania SHPK ka marrë ri-miratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Parkut Eolik Kryevindh, me fuqi të instaluar 72.6 MW.

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

OST sh.a. e zhvillon aktivitetin në zbatim të:

Ligjit Nr. 43/2015 Për Sektorin e Energjisë Elektrike (i ndryshuar)

Ligji i mësipërm rregullon veprimtarinë e shoqërisë në funksion të garantimit të furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë si edhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Dispozitat e këtij ligji rregullojnë marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendosin rregullat lidhur me:

- hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;

- pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
- dhënien e autorizimeve dhe licensave në sektorin e energjisë elektrike;
- rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;
- integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë elektrike.

Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar)

Ky ligj përcakton aspektet më të përgjithshme të funksionimit të shoqërisë tregtare. Ai rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionerëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Në zbatim të këtij ligji janë hartuar të gjithë aktet e nevojshme të menaxhimit të qeverisjes së shoqërisë, është ngritur Këshilli Mbikëqyrës dhe është miratuar struktura organizative e shoqërisë.

Statutit të Shoqërisë Anonime OST sh.a.

Përcakton emrin, selinë dhe objektin e veprimtarisë së OST. Rregullon marrëdhëniet ndërmjet organeve të shoqërisë dhe kompetencat e secilit prej tyre.

Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519 datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike (i ndryshuar)

VKM NR.456, DATË 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” (i ndryshuar)

Këto vendime synojnë të krijojnë kushtet për një treg konkurrues të energjisë elektrike, i cili lejon vendosjen e çmimeve të drejta që burojnë nga zbatimi i një tregu të qëndrueshëm, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë; - Të krijojë kushtet për një treg të orientuar drejt importit dhe eksportit, që promovon përfitimet e konsumatorëve, si dhe përfitime për sektorin shqiptar të energjisë

elektrike, duke ofruar fleksibilitet për integrimin në tregun e energjisë elektrike panevropiane dhe bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (day ahead market) dhe tregut brenda ditës (intraday market).

Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin ERE Nr. 63, datë 11.04.2022

Kodi i Transmetimit trajton procesin e Planifikimit të Rrjetit të Transmetimit, të Lidhjes së përdoruesve në Rrjetin e Transmetimit, të Planifikimit Operacional dhe Skedulimit të përdoruesve/pjesëmarrësve të Tregut të Energjisë Elektrike, të Operimit dhe Dispečerimit të përdoruesve të Rrjetit të Transmetimit, Operimit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe balancimit të Sistemit Elektroenergetik, si në kushte normale ashtu dhe në kushte jo-normale.

Kodit të Matjes, miratuar me Vendimin ERE Nr.101, datë 26.08.2008

Kodi i Matjes përmban normat minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e Energjisë Elektrike, me qëllim tregtimin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” miratuar me Vendim të ERE Nr. 106, Datë, 02.07.2020

Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike themelojnë menaxhimin me bazë tregu të balancimit të Sistemit Elektroenergetik. Objektivi i tyre është krijimi i një mekanizmi balancues eficient, transparent dhe jodiskriminues që përcakton përgjegjësitë e balancimit dhe nxit pjesëmarrësit e tregut të kryejnë balancimin si dhe të ofrojnë shërbime, të krijojnë një mekanizëm për përcaktimin e çmimit të shërbimeve balancuese të prokuruar nga OST si dhe mekanizmin për llogaritjen e çmimit të shlyerjes së disbalancave dhe pagesave financiare të disbalancave për Palët Përgjegjëse të Balancimit si dhe çështje të tjera që lidhen me operimin e tregut balancues.

Rregullat për Alokimin e Kapaciteteve të Interkoneksionit, Miratuar me Vendimin e ERE Nr. 280, datë 01.11.2022

Këto Rregulla specifikojnë procedurat dhe kriteret e ankandit për alokimin e kapaciteteve disponibël ndërkufitar, në të dy drejtimet import/eksport, ndërmjet zonës së kontrollit të OST sh.a. dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të vendeve fqinje. Këto rregulla përcaktojnë kërkesat që pjesëmarrësit e tregut duhet të

përbushin për të marrë pjesë në ankandet Vjetore, Mujore dhe Ditore, procedurat e zhvillimit të ankandit, dhënien e të drejtës së transmetimit fizik, kushtet për akses në tregun sekondar të drejtës së transmetimit fizik dhe shfrytëzimin e të drejtës së transmetimit fizik.

Rregullat e brendshme

Shoqëria, krahas rregullave ligjore e nënligjore, ka hartuar dhe zbaton një paketë rregullash të brendshme, të cilat synojnë të rregullojnë më në detaje aspekte të funksionimit të veprimtarisë së saj. Ndër këto rregulla përmendim:

Dokumenti “Detyrat funksionale dhe Kriteret e Punësimit për pozicionet e punës në Aparatin Qendror të OST sh.a.” (rishikuar)Nr. 978/1 datë 11.02.2022.

Ky dokument përshkruan detyrat funksionale për çdo pozicion pune në aparatin qendror të OST si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga çdo punonjës në këto pozicione.

Strategjia e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 30, datë 23.05.2018

Kjo strategji për MFK-në, synon të shpjegojë dhe aplikojë thelbin e sistemit të MFK-së si edhe të komponentëve të tij. Strategjia është dokument referues për të zhvilluar dhe ruajtur një sistem të përshtatshëm të MFK në OST sh.a, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin Nr. 110/2015 i datës 15.10.2015, si dhe me manualin e MFK dhe akte të tjera ligjore e nënligjore të fushës.

Brenda kësaj strategjie është integruar edhe Strategjia e Menaxhimit të Riskut të OST sh.a., e cila kontrollon riskun që lidhet me kompaninë në tërësi, riskun e marrëdhënieve të saj me klientët dhe furnitorët, menaxhimin e marrëdhënieve të reja dhe ekzistuese të biznesit me palë të treta.

Kodi i Etikës, Nr. 3952, datë 08.07.2016

Qëllimi i Kodit të Etikës së OST sh.a. është promovimi i rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale për të gjithë punonjësit e OST sh.a., gjatë dhe jashtë ushtrimit të kompetencave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore, nënligjore dhe Rregullat e Brendshme të Shoqërisë.

Manuali i Burimeve Njerëzore, Nr. 5824 Prot,

datë 30.09.2020 dhe 6694/1 datë 29.12.2023

Politika që ndjek OST në lidhje me burimet njerëzore synon të sigurojë përzgjedhjen e personelit të kualifikuar, me eksperiencë dhe aftësi profesionale në të gjitha nivelet e shërbimit në OST sh.a., me qëllim që të mbështesë nevojat e kompanisë në të gjitha fushat ku OST sh.a. operon.

KONTROLLI I BRENDSHËM DHE MENAXHIMI I RISKUT

Korniza e kontrollit të brendshëm e menaxhimit të riskut në OST sh.a. është bazuar gjerësisht në “Strategjinë e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, e cila është përpiluar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin Nr. 110/2015 i datës 15.10.2015, si dhe manualin e MFK dhe akte të tjera ligjore e nënligjore të fushës.

Kontrolli i brendshëm përfaqëson sistemin e politikave, proceseve, dhe procedurave që janë vendosur brenda shoqërisë për të siguruar që operacionet janë efektive, efikase, dhe në përputhje me standardet e përcaktuara.

Menaxhimi i Riskut - Risku është një koncept i përgjithshëm që përcakton mundësinë ose probabilitetin e ndodhjes së një ngjarjeje negative ose dëmtuese.

Ai përshkruan situata të cilat kanë potencialin për të shkaktuar humbje, dëme, ose pasiguri për një individ, organizatë, ose një sistem të caktuar.

Menaxhimi i rrezikut fillon me një kornizë të qartë dhe të strukturuar për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar rreziqet potenciale që mund të prekin kompaninë.

Kjo përfshin një analizë të kujdesshme të rreziqeve të mundshme, duke përcaktuar probabilitetin dhe ndikimin e tyre, dhe zhvillimin e strategjive të përshtatshme për t’u përballur me to.

Në thelb, qëllimi kryesor i menaxhimit të riskut është të sigurojë që shoqëria të ketë një qasje të përgjegjshme dhe të qëndrueshme ndaj rreziqeve të mundshme, duke minimizuar humbjet dhe pasiguritë dhe duke përfituar nga mundësitë që shfaqen.

Objektivat e Menaxhimit të Riskut - Objektivat e menaxhimit të riskut janë të përqëndruara në sigurimin e qëndrueshmërisë, reduktimin e pasigurisë, dhe

përfitimin nga mundësitë e tregut. Këto objektiva synojnë të sigurojnë që shoqëria të jetë në gjendje të përballet me rreziqet në një mënyrë efektive dhe të përfitojnë nga ndryshimet në mjedisin e tyre operacional.

Disa nga objektivat kryesore të menaxhimit të riskut përfshijnë :

- Sigurinë që menaxhimi i rrezikut të jetë i integruar në mënyrë të qartë e të vazhdueshme dhe të evidentohet në kulturën e organizatës.
- Menaxhimin e riskut në përputhje me praktikatat më të mira.
- Parashikimin dhe reagimin ndaj ndryshimeve të kërkesave sociale, mjedisore dhe legjislative.
- Mbajtjen në konsideratë të pajtueshmërisë me standardet minimale të shëndetit dhe sigurisë, sigurimit dhe kërkesave ligjore.
- Parandalimin e vdekjeve, lëndimeve, dëmtimeve dhe humbjeve, dhe uljen e kostove që mbart rreziku me vete.
- Informimin e politikave dhe vendimeve operacionale duke identifikuar rreziqet dhe ndikimin e tyre të mundshëm.
- Rritjen e vetëdijes për nevojën dhe për menaxhimin e riskut nga të gjithë ata që lidhen me ofrimin e shërbimit të organizatës.

Menaxhimi i riskut është një proces i vazhdueshëm dhe zhvillimor i cili rrjedh përgjatë strategjisë së shoqërisë dhe zbatimit të saj, duke vlerësuar të gjitha rreziqet që i rrethojnë aktivitetet në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Të gjithë risqeve të identifikuara u jepet një vlerësim final, i cili i pozicionon ato në matricën e riskut (probabilitetin e ndodhjes, impaktin e tij, monitorimin, veprime për të adresuar boshllëqet, Kategoritë e Përgjigjeve ndaj Riskut), duke na siguruar me një pamje të menjëhershme të risqeve për të cilat nevojiten më së shumti masat mbrojtëse dhe caktimi i prioriteteve.

Në vijim, mbahen regjistra të përcaktuara sipas Strategjisë së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) e cila lejon çdo palë të përfshirë në procesin e shqyrtimit të informacionit të lidhur me nivelin e profilit të tyre.

Gjithashtu, ajo lejon grupimin e risqeve sipas kategorive të mëdha dhe prezantimin nëpërmjet raportimit të integruar të rezultateve të Menaxhimit të Riskut.

Monitorimi dhe menaxhimi efektiv i riskut të OST sh.a., zbatohet duke ndjekur “Strategjinë e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” nëpërmjet një metodologjie, e cila përfshin 4 aktivitete kryesore:



Identifikimi i Riskut: - Identifikimi i të gjitha risqeve që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave (p.sh., ngjarjet që do të kërcënojnë realizimin e secilit objektivi, duke përfshirë dështimin për të përfutur sa më shumë prej mundësive). Këto risqe mund të jenë të brendshme (p.sh., gabim njerëzor, mashtrim, prishje sistemi) dhe të jashtëm (p.sh., ndryshimet në legjislacion, fatkeqësitë natyrore).

Vlerësimi i Riskut: - Pas identifikimit, rreziqet përfshihen

në regjistrin e riskut i cili do të identifikojë pronarin e rrezikut dhe hapat që duhet të ndërmerren për të zbutur apo shmangur këtë rrezik. Risku do të kategorizohet kundrejt impaktit të mundshëm në një shkallë prej 1 (ndikimi më i ulët) deri në 3 (ndikimi më i lartë). Rreziqet gjithashtu kategorizohen kundrejt gjasave që rreziku të haset në një shkallë nga 1 (gjasat më të ulëta) deri në 3 (gjasat më të larta).

Planifikimi dhe Kontrolllet: - Objektivi kryesor i këtij planifikimi është përgatitja e përgjigjeve që duhet të ndërmerren duke përdorur kategoritë e përgjigjeve ndaj riskut për secilin nga rreziqet e identifikuara në mënyrë që të zvogëlohet apo eliminohet ky kërcënim. Ky proces duhet të lërë prapa një plan veprimi, nëse çdo rrezik do të materializohet.

Përqëndrimi, gjithmonë është në rreziqet “e kuqe” pasi këto kanë shansin më të madh të lindin dhe ka të ngjarë të ndikojnë më shumë në veprimtarinë e kompanisë. Gjithashtu, i kushtohet vëmendje e caktuar edhe rreziqeve “të verdhë” dhe atyre “jeshilë”.

Implementimi i Kontrolleve dhe Përgjigjeve ndaj Riskut: - Objektivi kryesor i kësaj pike të strategjisë është të sigurohet se janë zbatuar kontrollet dhe përgjigjet e planifikuara ndaj rrezikut, efektiviteti i tyre monitorohet dhe kryhen veprimet korrigjuese, aty ku përgjigjet nuk ofrojnë zgjidhje efektive.

POLITIKA DHE PROCEDURA TË RISKUT

Në vijim të zbatimit të “Strategjisë së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” monitorimi dhe menaxhimi i riskut zgjerohet edhe më tej nëpërmjet krijimit të Politikave dhe Procedurave të Riskut.

Politikat dhe procedurat e riskut janë dokumente themelore në menaxhimin e riskut të një organizate. Këto politika dhe procedura theksojnë përgjegjësinë dhe rolet për të gjithë personelin në organizatë dhe sigurojnë qëndrueshmërinë dhe integritetin e procesit të menaxhimit të riskut.

PROCEDURA E RAPORTIMIT TË NGJARJEVE ME RISK OPERACIONAL

Qëllimi i kësaj procedure është identifikimi i ngjarjeve të riskut operacional në OST sh.a., duke përcaktuar në mënyrë të qartë procesin e identifikimit, grumbullimit, raportimit dhe monitorimit të ngjarjeve me risk operacional.

Ky dokument përcakton gjithashtu standardet që duhen përdorur në procesin e menaxhimit të riskut në OST sh.a. me qëllim arritjen e përdorimit më eficient të burimeve dhe arritjen e rezultateve sa më optimale në shërbimin e rrjetit të sistemit të transmetimit.

Procedura e raportimit të ngjarjeve me risk operacional është në funksion të plotë e aplikuar në platformën online të OST sh.a. . Kjo platformë mundëson që raportimet të bëhen në kohë reale.

PROCEDURA E KONTROLLIT DHE VETËVLERËSIMIT TË FLUKSEVE TË PUNËS

Kjo Procedurë ka për qëllim identifikimin, vetëvlerësimin dhe zbutjen e risqeve që vijnë si rrjedhojë e flukseve të punës që kryhen brenda njësisë ashtu edhe në bashkëveprim midis njësive apo dhe palëve të treta.

Ky dokument krijon mundësinë që të gjitha detyrat funksionale të kryhen në mënyrë efikase, efektive dhe në kohë. Kjo procedurë ofron një qasje sistematike për menaxhimin e flukseve të punës.

TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

OST sh.a. operon prej vitit 2021 Tregun Shqiptar të Balancimit në të cilin organizohen procedurat respektive për sigurimin e kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese për balancimin e sistemit bazuar në Rregullat e Tregut të Balancimit. Bën evidentimin e aktivizimeve, disbalancave dhe menaxhimin kontraktual e financiar të tyre me palë të përgjegjëse për disbalancat dhe me ofruesit përkatës të shërbimeve të balancimit.

Gjithashtu, OST sh.a. prej muajit Prill 2023 siguron energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjet të nevojshme për funksionimin e Sistemit, në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

Nëpërmjet menaxhimit të Platformës së Sistemit të Matjes së Energjisë, siguron punë të pandërprerë për nxjerrjen e saktë e të dhënave të energjisë elektrike në të gjithë pikat e matjes të energjisë në Sistemin Energjetik Shqiptar.

Tregu Shqiptar i Balancimit

Që prej datës 1 Prill 2021, OST operon Tregun Balancues bazuar në Rregullat e Tregut të Balancimit. Gjatë vitit 2023, ka vijuar puna për përmirësim të mëtejshëm të proceseve, rregullave si dhe sistemeve të përfshira.

Krijimi i tregut balancues ishte pika fillestare për liberalizimin e tregut të energjisë pasi kjo do të lejojë një integrim me tregjet e vendeve rajonale nëpërmjet balancimit ndërkufitar dhe duke u bërë pjesë e platformës pan evropiane të Balancimit. Ky treg përfshin të gjitha veprimet, produktet dhe shërbimet e përdorura nga OST për të garantuar përputhjen e vazhdueshme të Prodhimit dhe Kërkesës, menaxhimin e konxhestioneve, menaxhimin e frekuencës dhe veprimet e tjera të kërkuara që sigurojnë integritetin e funksionimit të sistemit energjetik. Tregu i Balancimit i lejon OST sh.a. të përmbushë detyrimet e saj lidhur me balancimin e sistemit në kohë reale duke siguruar shërbimet e nevojshme në kohë reale bazuar në parimet e tregut të hapur, transparent dhe jo diskriminues. Tregu Shqiptar i Balancimit ka mundësuar kalimin përfundimtar nga një mekanizëm i rregulluar me entitete publike, në një liberalizim të tregut të energjisë balancuese, ku çdo palë ofruese e shërbimeve të balancimit mund të marrë pjesë dhe të bëhet konkurruese me produktet e saj për shërbimet e balancimit.

Kështu prodhuesit/konsumatorët e energjisë elektrike, kanë mundësi të diversifikojnë portofolin e tyre, duke hyrë në tregun e energjisë balancuese në përputhje me aftësitë teknike të njësive gjeneruese/njësive të kërkesës. Me rritjen

e numrit të RES-ve të lidhura në rrjetin elektroenergetik të transmetimit apo të shpërndarjes, bëhet gjithnjë e më thelbësore që edhe RES-të të jenë ofruese të shërbimeve të balancimit të sistemit. Një nga sfidat kryesore është integrimi i RES-ve në tregun balancues; kjo në linjë edhe me Paketën e Energjisë së Pastër (CEP) për Vision 2030, ku ENTSO-E synon hapjen e tregjeve për sa më shumë aktorë të këtij sektori.

Lista e subjekteve në tregun balancues të energjisë elektrike si Palë, Grup Përgjegjës për Balancim apo Ofrues i Shërbimit të Balancimit për vitin 2023 paraqitet më poshtë:

Regjistri i Palëve Përgjegjëse Balancuese të Tregut Shqiptar të Balancimit

Nr.	Kodi	Kompania
1.	PPB-001	GSA Sh.p.k
2.	PPB-003	ReNRGY Trading Group Sh.p.k.
3.	PPB-005	GEN-I Tirana Sh.p.k.
4.	PPB-007	Energji Ashta Sh.p.k.
5.	PPB-009	Danske Commodities Albania Sh.p.k.
6.	PPB-010	NOA Energy Trade Sh.p.k.
7.	PPB-011	Ayen Energy Trading Sh.a.
8.	PPB-012	Ayen AS Energji Sh.a.
9.	PPB-013	EZ-5 Energy Sh.p.k.
10.	PPB-014	AXPO Albania Sh.a.
11.	PPB-015	KESH Sh.a.
12.	PPB-016	Energy Financing Team Tirana
13.	PPB-018	Kurum International Sh.a.
14.	PPB-019	ENER TRADE Sh.p.k.
15.	PPB-020	FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË
16.	PPB-021	Devoll Hydropower Sh.a.
17.	PPB-023	OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
18.	PPB-027	Lengarica &Energy Sh.p.k.
19.	PPB-030	TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT
20.	PPB-031	INFO Telecom Sh.p.k.
21.	PPB-032	DITEKO Sh.p.k.
22.	PPB-033	Spe Gjadër Sh.p.k.
23.	PPB-034	FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL Sh.a.

24.	PPB-035	AlbEsp Trading & Consulting Sh.p.k.
25.	PPB-037	Hec-i Bishnica 1,2 Sh.p.k.
26.	PPB-038	Heci Tervolit Sh.p.k.
27.	PPB-039	ADA Solar SE Sh.p.k.
28.	PPB-040	Lajthiza Invest Sh.a.
29.	PPB-041	FUTURE ENERGY TRADING AND DYNAMICS Sh.p.k.
30.	PPB-042	DRAGOBIA ENERGY Sh.p.k.
31.	PPB-043	Korça Photovoltaik Park Sh.p.k.
32.	PPB-044	SUN BEAT SYSTEM Sh.p.k.
33.	PPB-045	New Technolgy Solution Production (NTSP) Sh.p.k.
34.	PPB-046	TREN SUN SYSTEM Sh.p.k.
35.	PPB-051	ENERGY 24 Sh.p.k.
36.	PPB-052	ENSCO Trading (Albania) Sh.p.k.
37.	PPB-056	NATYRE ENERGY Sh.p.k.
38.	PPB-057	G.S.K Sh.p.k.
39.	PPB-058	PROINFINIT CONSULTING Sh.p.k.
40.	PPB-059	SOLE 24 DOOEL Shkup-Dega në Shqipëri
41.	PPB-060	Duferco Shqipëria Sh.p.k.
42.	PPB-061	KARAVASTA SOLAR Sh.p.k.

Regjistri i Ofruesve të Shërbimit të Balancimit të Tregut Shqiptar të Balancimit


Nr.	Kodi	Kompania
1.	OSHB-001	Ayen As Energji Sh.a.
2.	OSHB-002	KESH sh.a.
3.	OSHB-004	Devoll
4.	OSHB-005	Hydropower sh.a Kurum International Sh.a.

Regjistri i Grupeve të Balancimit të Tregut Shqiptar të Balancimit


Nr.	Emërtimi i Grupit të Balancimit
1	Grupi i Balancimit KESH sh.a.
2	Grupi i Balancimit GSA Sh.p.k.
3	Grupi i Balancimit “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË sh.a.” FTL sh.a., “OSSH sh.a.”, “FSHU sh.a.” dhe 188 prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.

ANKANDET E ANGAZHIMIT PËR DISPONUESHMËRI

Gjatë vitit 2023, në AnkanDET e Angazhimit për Disponueshmëri për sigurimin e kapacitetit rezervë për balancimin e sistemit si dhe për llogari të KOSTT referuar marrëveshjes për ndarjen e rezervave OST-KOSTT janë kontraktuar vlerat e mëposhtme nga OSHB-të të regjistruara në tregun balancues. Grafiku i mëposhtëm paraqet sasi të totale të kapacitetit rezervë të kontraktuar nga OSHB në Tregun Balancues.




Grafiku i mëposhtëm paraqet çmimet mesatare të kapacitetit rezervë që kanë rezultuar nga AnkanDET e Angazhimit për Disponueshmëri në Tregun Shqiptar të Balancimit. Çmimi i kapacitetit është çmimi me të cilin paguhen OSHB-të të cilët kanë fituar kapacitetet në AnkanDET e Angazhimit për Disponueshmëri.



Grafiku i mëposhtëm paraqet kostot dhe të ardhurat e OST për sigurimin e kapacitetit rezervë për balancimin e sistemit si dhe për llogari të KOSTT referuar marrëveshjes për ndarjen e rezervave OST-KOSTT. Një pjesë e këtyre kostove mbulohen nga të ardhurat nga KOSTT bazuar në marrëveshjen për ndarjen e rezervave midis OST dhe KOSTT. Pjesa e mbetur e kostove nga kapaciteti rezervë aktualisht merren parasysht në tarifën e transmetimit.


Kostot dhe të ardhurat e OST nga Kapaciteti Rezervë (Euro)



ANKANDET E ANGAZHIMIT PËR SHPËRNDARJE


Gjatë vitit 2023, në AnkanDET e Angazhimit për Shpërndarje për sigurimin e energjisë balancuese për balancimin e sistemit si dhe për llogari të KOSTT referuar marrëveshjes për ndarjen e rezervave OST-KOSTT janë kontraktuar vlerat e mëposhtme nga OSHB-të të regjistruara në tregun balancues. Grafiku i mëposhtëm paraqet sasinë totale të energjisë balancuese të kontraktuar nga OSHB në Tregun Balancues.

Energjia Balancuese e Kontraktuar në Tregun e Balancimit (MWh)




Në kushtet, kur tregu i brendshëm i balancimit nuk plotëson nevojat e sistemit për ruajtjen e balancës janë devijimet në interkoneksion ato që rregullojnë balancimin e sistemit të OST referuar marrëveshjes FSKAR. Gjatë vitit 2023, devijimet në interkoneksion referuar kësaj marrëveshje paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Devijimet në interkoneksion për Balancimin e Sistemit - FSKAR (MWh)



Grafiku i mëposhtëm paraqet çmimet mesatare të energjisë balancuese që kanë rezultuar nga tregu i brendshëm i balancimit (TSHB) dhe çmimet që kanë rezultuar nga interkoneksioni (FSKAR) lidhur me balancimin e sistemit të OST.


Çmimi mesatar i Energjisë Balancuese (Euro/MWh)



Çmimi i Energjisë Balancuese i tregut të brendshëm të balancimit është çmimi me të cilin OST paguan OSHB-të të cilët kanë ofruar shërbime balancimi për aktivizimin në rritje dhe me të cilin OSHB-të paguajnë OST për shërbime balancimi për aktivizimin në ulje. Çmimi i Energjisë Balancuese dhe çmimi nga devijimi në interkoneksion për balancimin e sistemit janë çmime referuese për llogaritjen e çmimit të disbalancës në varësi se nga ka ardhur balancimi i sistemit, nga tregu i brendshëm apo interkoneksioni.

Grafiku i mëposhtëm paraqet kostot dhe të ardhurat e OST për sigurimin e energjisë balancuese për balancimin e sistemit si dhe për llogari të KOSTT referuar marrëveshjes për ndarjen e rezervave OST-KOSTT.

Kostot dhe të ardhurat e OST nga Energjia Balancuese




Një pjesë e këtyre kostove mbulohen nga të ardhurat nga KOSTT bazuar në marrëveshjen për ndarjen e rezervave midis OST dhe KOSTT. Pjesa e mbetur e kostove nga energjia balancuese mbulohen nga shkaktuesit e disbalancave negative të cilët

paguajnë OST për disbalancat e shkaktuara. Të ardhurat nga energjia balancuese shpërndahen te shkaktuesit e Disbalancës Pozitive të cilët paguhen nga OST për disbalancat e shkaktuara.

DISBALANCAT


Në zbatim të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” miratuar me Vendim të ERE Nr. 106, Datë, 02.07.2020 për periudhën Janar-Dhjetor 2023, dhe mbi bazën e të dhënave orare të marra nga Sektori i Matjeve Tregtare i OST sh.a. dhe të nominimeve të pjesëmarrësve të Tregut Balancues në platformën elektronike të Menaxhimit të Tregut, janë bërë llogaritjet e disbalancave në bazë orare/ditore. Grafiku i detajuar sipas muajve me të dhënat e devijimeve të Palëve Përgjegjëse Balancuese si më poshtë:

Disbalancat Mujore 2023 (MWh)




Grafiku i mëposhtëm paraqet çmimet mesatare të Disbalancave Negative dhe Pozitive të shkaktuara nga Palët Përgjegjëse Balancuese sipas muajve përkatës:

Çmimet Mesatare për Disbalancat (Euro/MWh)




Kapaciteti i alokuar sipas kufijve - Import




Grafikët e mëposhtëm paraqesin çmimet e rezultuar nga Ankandet e zhvilluara për Alokimin e Kapacitetit në interkoneksion për secilin drejtim dhe kufi.



Çmimi mesatar për Alokimin e kapaciteteve Eksport



Çmimi mesatar për Alokimin e kapaciteteve - Import




Të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve për vitin 2023, rezultuan rreth 22.6 mln Euro. Grafikët e mëposhtëm paraqesin të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve për secilin drejtim dhe kufi.



PROKURIMI I ENERGJISË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT:

Për vitin 2023, është prokuruar energji për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në sasinë 216,786 MWh.




Për periudhën 01.01.2023 - 11.04.2023, sasitë e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.456 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, datë 29.06.2022 u vendos që për shkak të krizës energjetike sasia energjisë për mbulimin e humbjeve do të sigurohej nga KESH sh.a. me çmimin e rregulluar të blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, ku çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi do të jetë 8565.2 Lekë/MWh, (për periudhën 01.01.23 – 08.09.2023) dhe 10,000 Lekë/MWh (për periudhën 09.02.23 – 11.04.2023) . Prej 12 Prill 2023 prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve kryhet nëpërmjet platformës ALPEX, ku ALPEX do të sigurojë shlyerjen e volumit të kontraktuar në ALPEX DAM, sipas Rregullave të Tregut. Deri më 31 dhjetor 2023 OST ka patur aktive Kontratë për Diferencë me KESH sh.a. për sigurimin e humbjeve në rrjetin e Transmetimit.

Bazuar në këtë kontratë për diferencë, nëse çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në ALPEX DAM është më i lartë se çmimi i kontratës (me KESH sh.a), Shitësi do të kompensojë Blerësin për diferencën midis çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës dhe anasjelltas.

Gjithsej, vlera e shpenzuar për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 20.6 milionë Euro. Grafikët e mëposhtëm paraqesin kostot e OST nga prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit respektivisht për periudhën Janar – 11 Prill dhe periudhën 12 Prill – Dhjetor.

Kostot e Humbjeve (mln lekë)





BILANCI I ENERGJISË


Në vijim, paraqiten treguesit kryesor energjetik të sistemit të transmetimit për vitin 2023. Për sa i përket balancës energjetike gjatë vitit 2023, vendi rezulton të jetë importues i energjisë me 924 GWh.

Duke konsideruar që kapaciteti prodhues në vend është 98 % hidro-gjenerues, gjatë vitit 2023, kushtet hidrologjike dhe kërkesa kanë ndikuar në parametrat elektro-energetik të vendit si dhe në raportin mes prodhimit vendas dhe shkëmbimit të energjisë.


Nr.	Emërtimi	Njësia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL
I	Energjia Totale në sistemin e OST	GWh	1,089.1	913.8	850.8	774.4	914.3	767.2	773.7	783.1	732.6	665.0	832.5	1,050.8	10,147.4
a)	Prodhim Vendas	"	1,037.8	850.6	719.5	638.5	808.2	653.7	538.0	532.7	463.7	376.3	682.3	924.3	8,225.6
b)	Energji në marrje	"	51.4	63.2	131.3	135.9	106.1	113.5	235.7	250.3	268.9	288.7	150.3	126.5	1,921.7
II	Energjia Totale e transmetuar	GWh	1,063.9	896.7	831.3	756.3	891.4	751.0	757.1	767.2	719.5	653.2	812.2	1,027.4	9,927.1
a)	Energji elektrike e dhënë	"	387.7	265.7	250.9	199.7	364.4	222.0	125.0	142.8	184.9	136.5	244.3	317.7	2,841.6
b)	Energji elektrike për OSHEE sh.a.	"	637.2	605.4	547.7	496.8	446.9	452.5	575.0	576.0	487.2	473.0	526.9	667.1	6,491.8
c)	Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar	"	39.0	25.6	32.7	59.8	80.0	76.5	57.0	48.4	47.5	43.7	41.0	42.5	593.8
III	Humbjet në rrjetin e transmetimit														
a)	Humbjet në GWh	GWh	25.2	17.1	19.5	18.2	22.9	16.2	16.6	15.8	13.1	11.8	20.4	23.4	220.3
b)	Humbjet në %	%	2.32%	1.87%	2.30%	2.34%	2.50%	2.11%	2.15%	2.02%	1.79%	1.78%	2.45%	2.23%	2.17%





Energjia në Rrjetin e Transmetimit (GWh)



Energjia e Transmetuar (GWh)




Prodhimi GWh



SIGURIA KIBERNETIKE

Fokus i Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbetet gjithmonë përmirësimi i sigurisë kibernetike, në veçanti mbrojtja e infrastrukturave, platformave dhe sistemeve teknologjike të saj. Në një mjedis ku këto elemente janë thelbësore për funksionimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të aktivitetit, OST sh.a. ka ndërmarrë hapa për të garantuar sigurinë dhe pacënueshmërinë e tyre. Për të adresuar sfidat e sigurisë, kompania ka implementuar masa të rëndësishme organizative. Përditësimi i politikave dhe procedurave të sigurisë, ka ndërmarrë hapa duke përfshirë ndërgjegjësimin e stafit dhe rritjen e kapaciteteve të monitorimit të rrjeteve. Trajtime të shumta janë zhvilluar për të rritur vetëdijen dhe aftësitë e stafit në menaxhimin e rreziqeve kibernetike. Përveç kësaj, OST sh.a. ka investuar në teknologji inovative dhe ka krijuar partneritete strategjike me ekspertë të fushës së sigurisë. Për të siguruar një qasje të integruar ndaj rreziqeve, OST sh.a. ka ndërtuar një mjedis të fortë të sigurisë që mbron infrastrukturën, platformat dhe sistemet teknologjike nga sulmet e mundshme. Ky angazhim i vazhdueshëm ka bërë të mundur që kompania sot të jetë në një pozicion të fortë për të përballuar sfidat e këtij mjedisi të ndërlikuar kibernetik dhe për të ruajtur besueshmërinë dhe efikasitetin e operacioneve të saj.



TREGU I TRANSMETIMIT TË DHËNAVE PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

Vendi ynë, në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian ka konfirmuar ndjekjen e një modeli evropian të zhvillimit që synon të krijojë një ekonomi të bazuar në shoqërinë e informacionit. Në përpjekje për të mbështetur këto iniciativa, kompania OST sh.a. është duke kontribuar me ofrimin e transmetimit e të dhënave në tregun e komunikimeve elektronike.

OST sh.a., pas marrjes së Autorizimit të Përgjithshëm të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), është duke ushtruar këtë aktivitet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Angazhimi i shërbimeve në aktivitetin e ofrimit të kapaciteteve me shumicë të të dhënave, vjen si nevojë për të optimizuar kostot dhe për të diversifikuar të ardhurat e vetë kompanisë.


Në mënyrë të ngjashme, rritja e kërkesës për përdorimin e shërbimeve me brez të gjërë është e kufizuar nga mungesa e infrastrukturës, sidomos në zonat e largëta dhe me vështirësi në komunikim si edhe në infrastrukturë.

Aktualisht, funksionet dhe detyrat në lidhje me fushën e komunikimeve elektronike kryhen nga Drejtori dhe skuadra brenda strukturës organizative të OST sh.a., të cilët kujdesen për menaxhimin e rrjetit dhe administrimin e kontratave të lidhura ndërmjet OST sh.a. dhe operatorëve të tjerë për kryerjen e shërbimeve të transmetimit të të dhënave.

Përveç kësaj, sigurimi i disponueshmërisë dhe performancës së rrjetit në infrastrukturën e OST mbetet një prioritet thelbësor për të siguruar një përvojë të përdoruesve sa më të mirë. Kjo përfshin zhvillimin e një sistemi të përbashkët për monitorimin e performancës së rrjetit, duke përfshirë parametrat si shpejtësia e transmetimit të të dhënave, koha e përgjigjes, dhe disponueshmëria e shërbimit, si dhe implementimin e masave të rritjes së sigurisë për të mbrojtur rrjetin nga sulmet potenciale të sigurisë.

Gjatë vitit 2023, të ardhurat e realizuara nga veprimtaria në fushën e transmetimit të të dhënave për OST sh.a. arritën në vlerën 39,964,610 Lekë.

Ky sukses vërteton përpjekjet e vazhdueshme të kompanisë për të ofruar shërbime cilësore dhe për të kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në vend.



Bazuar në objektivin tona, synohet që në vitin 2024 do të ketë një rritje të ardhurash që do të gjenerohen nga ky aktivitet.



Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 23 Tetor 2020 me NIPT M02223006B. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 Prill 2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, VKM Nr. 519 datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike (i ndryshuar), Marrëveshjes së Aksionarëve dhe Statutit të Shoqërisë si dhe Vendimeve të Entit Rregullator të Energjisë : Vendim i ERE nr. 247, datë 29.09.2022 “Mbi licencimin e “Bursës Shqiptare Të Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike (i ndryshuar); Vendim i ERE nr. 347, datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e kierimit dhe shlyerjes”; Vendim i ERE nr. 106, datë 23.03.2023 “Mbi miratimin e disa shtesave në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ere nr. 347, datë 27.12.2022”; Vendim i ERE nr. Nr. 139, datë 14.04.2023 “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të

lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”; Vendim i ERE nr. 228, datë 17.07.2023, “Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a., si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (NEMO)” (i ndryshuar); Vendimi i ZR.rE nr. V _I 748_2023“Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a., si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike për territorin e RKS (NEMO)”; Vendim i ERE nr. 287, datë 09.10.2023 “Mbi propozimin për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në alpeX dhe miratimin e listës së tarifave”.

OBJEKTIVI I AKTIVITETIT TË SHOQËRISË ËSHTË:

- a) Krijimi, menaxhimi dhe administrimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike (në vijim referuar edhe si “Tregu”), nëpërmjet platformës së tregut në bazë të ditës në avancë dhe brenda të njëjtës ditë.
- b) Kompensimit financiar (clearing) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Sektorit të Energjisë elektrike, Rregullat e Tregut të Energjisë elektrike dhe Modelin e Tregut të Energjisë elektrike, në fuqi.
- c) Bashkimin e tregjeve (market coupling) të energjisë elektrike.

SA MË SIPËR PËRFSHIN GJITHASHTU, POR PA U KUFIZUAR, AKTIVITETET E MËPOSHTME:

- a) Zhvillimin e produkteve të tregut të energjisë elektrike;
- b) Planifikimin, zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e përpunimit elektronik të të dhënave në lidhje me Tregun;
- c) Mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me produktet e energjisë elektrike në lidhje me Tregun;
- d) Përbushjen e aktiviteteve të kompensimit financiar (clearing & settlement).

Shoqëria zotërohet nga aksionarët Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregu – KOSTT SH.A.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 250,000,000 Lekë, i ndarë në 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) aksione me vlerë nominale 1,000.00 (një mijë) Lekë secila.

Në datën e Pasqyrave Financiare struktura e zotërimit të kapitalit paraqitet si vijon:



143,125
NUMRI I AKSIONEVE

57.25%
% e Kapitalit



106,875
NUMRI I AKSIONEVE

42.75%
% e Kapitalit

Më datë 06.05.2021, u regjistrua Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike SH.A. – Dega në Kosovë me NUIS 811568495, me adresë Rr. Isa Boletini, nr.39, Prishtinë, Kosovë. Veprimtaria e Degës në Kosovë rregullohet në përputhje me dispozitat e Ligjit

Nr.02/L-123 mbi Shoqëritë Tregtare. Themelues dhe Pronar është Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX Sh.A. me kapital 0 dhe 100 % të aksioneve, dhe përfaqësohet nga Z. Sokol Dishnica, në cilësinë e Drejtorit Menaxhues.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Shoqëria ALPEX sh.a. është një shoqëri aksionare, dhe e organizon strukturën e saj të brendshme drejtuese dhe të administrimit në përputhje me sistemin me dy nivele siç përcaktohet në Titullin IV, Kapitulli III të Ligjit të Shoqërive Tregtare.

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Këshilli Mbikëqyrës i përbërë nga:



Z. Shyqeri
Morina



Znj. Kledia
Ngjela



Znj. Ilda
Nushi



Z. Altin
Petre

3. Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori. Administratori është edhe Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë, si dhe është përgjegjës për aprovimin e politikave afatshkurtra dhe kontrollit të përputhshmërisë ligjore si dhe për vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës. Ai është përgjegjës për implementimin e vizionit të aksionerëve, përmirësimin e vazhdueshëm të rezultateve të kompanisë si dhe ndjekjen e të gjitha detyrave në nivel operacional dhe ditor. Gjithashtu, detyrë kryesore është përmirësimi i shërbimit dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit.

Administrator i Shoqërisë nga data 05.10.2020 është Z. Sokol Dishnica.

ECURIA E VITIT 2023

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, ALPEX SH.A. është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nëpërmjet platformës elektronike të tregtimit dhe platformës elektronike të klerimit dhe shlyerjes për tregjet e ankandeve të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe tregjeve të vazhdueshme brenda së njëjtës ditë, ndërmjet anëtarëve të Bursës, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike në fuqi.

Në datë 11 Prill 2023, ALPEX SH.A. ka nisur operimin e Tregut të Ditës në Avancë (Day-Ahead Market) të energjisë elektrike për zonën e ofertimit të Shqipërisë. Në bursë janë anëtarësuar 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë burse, nga të cilët 5 (pesë) janë shoqëri publike dhe 12 (dymbëdhjetë) janë shoqëri private dhe 1 (një) anëtar i përgjithshëm klerimi.

ALPEX, gjatë vitit 2023, ka punuar për lançimin e hapjes së Tregut të Ditës në Avancë (Day-Ahead Market) të energjisë elektrike për zonën e ofertimit të Kosovës dhe njëkohësisht me këtë edhe bashkimin e tregjeve midis zonës së ofertimit të Shqipërisë dhe të Kosovës (Market Coupling). Për zonën e ofertimit të Kosovës, gjatë vitit 2023, janë anëtarësuar 3 (tre) anëtar burse që janë shoqëri publike dhe 1 (një) anëtar i përgjithshëm klerimi.



ALPEX ka vënë në përdorim për anëtarët e Bursës platformën e tregtimit, Sistemi Elektronik të Tregtimit në Cast-ETSS. Kjo platformë ka qënë e aksesueshme gjatë gjithë kohës për përdoruesit dhe ka performuar pa çenuar funksionimin normal të aktivitetit të shoqërisë. Me propozim të ALPEX-it dhe miratim të ERE-s, aplikohet ankand i dytë me qëllim ruajtjen e tregut nga çmimet që konsiderohen të gabuara ose të paqëndrueshme, këto në referencë me kufirin minimal të çmimit 0 (zero) euro/MWh dhe kufirin maksimal të lejuar të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë 900 euro/MWh. Gjatë kësaj periudhe, ankandi i dytë është aktivizuar tre herë, ku çmimet pas këtij ankandi rezultuan të qendrueshme. Tregu DAM, gjatë vitit 2023, u dominua në blerje nga volumet e OST dhe FSHU kurse në shitje nga volumet KESH. Kompanitë private kanë tregtuar me volume të vogla. Pozicioni i tyre ka qënë më shumë në shitje të energjisë elektrike dhe disa herë në blerje. ALPEX ka vënë në përdorim për anëtarët e përgjithshëm të klerimit platformën e klerimit, Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë- EMCS. Aktiviteti i klerimit dhe shlyerja e transaksioneve kryhet çdo ditë pune, bazuar në Kalendarin e Klerimit dhe realizohet në bashkëpunim me ALPEX, Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit dhe Bankës për Shlyerje (RBAL).

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX, u emërua si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për tregun e Shqipërisë dhe Kosovës me vendimin e Enteve Rregullatore të të dy vendeve në një mbledhje të përbashkët të tyre të organizuar në Prishtinë më datë 17.07.2023 (Vendimi i ERE nr.228 dhe Vendimi i ZR.rE nr. V _I 748_2023), si një parakusht ky për integrimin e tregut të energjisë me tregjet e tjera rajonale dhe ato të vendeve të BE-së.



Tregues të transaksioneve gjatë vitit 2023:

Çmimet e Tregut të klerimit në €/MWh -2023			
Periudha	Min	Max	Mesatare
Prill	€ 75.51	€ 217.32	€ 118.85
Maj	€ 26.16	€ 202.90	€ 92.93
Qershor	€ 23.95	€ 170.24	€ 93.53
Korrik	€ 10.30	€ 203.01	€ 105.50
Gusht	€ 24.36	€ 362.07	€ 96.90
Shtator	€ 23.50	€ 315.48	€ 103.84
Tetor	€ 20.00	€ 241.09	€ 107.79
Nëntor	€ 25.87	€ 226.17	€ 99.05
Dhjetor	€ 7.97	€ 300.00	€ 90.07
PROGRESIVE	€ 7.97	€ 362.07	€ 100.15

Volumet në MWh -2023				
Periudha	Min	Max	Mesatare	Total
Prill	2,779	3,698	3,434	65,252
Maj	3,045	3,989	3,626	112,420
Qershor	3,154	4,450	3,736	112,089
Korrik	2,223	4,153	2,978	92,327
Gusht	2,190	2,551	2,397	74,293
Shtator	2,029	2,414	2,224	66,715
Tetor	2,817	3,278	3,115	96,552
Nëntor	2,750	3,753	3,379	101,357
Dhjetor	2,893	3,836	3,437	106,536
Progresive	2,029	4,450	3,135	827,546



Volumet Ditore



OPERIMI - ENERGJIA NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT

OST sh.a. menaxhon sistemin elektroenergjetik në kohë reale duke ruajtur një balancë midis kërkesës për konsum dhe prodhimit të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurojë një furnizim të besueshëm me energji elektrike nëpërmjet praktikave bashkëkohore të operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Operimi në kohë reale i sistemit të transmetimit realizohet nëpërmjet Qendrës Kombëtare Dispeçer, e cila kryen monitorimin, kontrollin dhe marrjen e masave përkatëse për ruajtjen e sigurisë së punës së sistemit elektroenergjetik, në koordinim me përdoruesit e rrjetit dhe OST-të fqinje.

OST sh.a. në rolin e Operatorit të Sistemit, operon Sistemin Elektroenergjetik duke përdorur teknikat më të mira bashkëkohore, duke siguruar balancën ndërmjet prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike. OST sh.a. bën operimin e rrjetit në përputhje me dispozitat e Ligjit 43/2015 “Mbi sektorin e Energjisë Elektrike”, Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike, marrëveshjet dy ose shumë-palëshe si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi. Sistemi i Transmetimit operon në përputhje me të gjithë udhëzimet dhe politikat e ENTSO-E, veçanërisht parashikimet e marrëveshjes së operimit të zonës sinkrone të ENTSO-E si dhe udhëzuesin mbi Sigurinë dhe Operimin e Sistemit të Transmetimit (SO GL).

OST sh.a. në përmbushje të roleve të saj ka realizuar aktivitetet e mëposhtme :

- Operimin e sistemit elektroenergjetik në pajtueshmeri me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe standardeve të ENTSO-E.
- Planifikimin e mbulimit të kërkesës me bazë ditore/orare, skedulimin orar për çdo central dhe kontrollin e nivelit të sigurisë së operimit duke përdorur kriterin e sigurisë “n-1”.
- Menaxhimin e shërbimeve ndihmëse të domosdoshme për funksionimin e sigurtë të Sistemit të Transmetimit.
- Menaxhimin e gjenerimit dhe kërkesën e energjisë elektrike në kohë reale, duke siguruar balancën ndërmjet gjenerimit, shkëmbimit dhe konsumit të energjisë elektrike.
- Shkëmbimin dhe harmonizimin e skedulimit orar të shkëmbimit të energjisë me

OST-të fqinje, për ditën pasardhëse si dhe llogaritjen e shkëmbimit të energjisë për çdo interkonektor për ditën paraardhëse.

- Analizën e punës së Sistemit Energjetik dhe aktivizimin e masave për ruajtjen e sigurisë së punës, në koordinim me Përdoruesit e Rrjetit dhe OST-të e rajonit.
- Parashikimin e punës së Sistemit Energjetik në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.
- Në bashkëpunim me OST-të fqinje, përcakton kapacitetin transmetues ndërkufitar për çdo kufi e drejtim të fluksit të energjisë me bazë vjetore, mujore dhe ditore.

TË DHËNA MBI ENERGINË NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT

Në vijim, janë paraqitur të dhëna të detajuara mbi prodhimin, importin, eksportin, balancën energjetike, konsumin, humbjet dhe gabimin e zonës së kontrollit në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023.


Kërkesa për energji elektrike në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2023 ka qenë 7.3 TWh, e cila është mbuluar nga prodhimi në vend dhe nga importi për periudha kur kushtet meteorologjike në vend nuk kanë qenë të favorshme. Prodhimi vendas për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje me 26 %. Gjatë vitit 2023, kërkesa për energji elektrike në rrjetin e transmetimit është ulur 1.6 %.

Kapaciteti transmetues ndërkufitar, në total 1,100MW, ka qenë i mjaftueshëm për realizimin e kontratave të importit, eksportit, nga pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike si edhe për realizimin e tranziteve.

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e OST sh.a. për vitin 2023 janë 220 GWh, të cilat përkojnë me 2.17 % të energjisë elektrike.


PRODHIMI

Kapaciteti i instaluar për gjenerimin e energjisë elektrike ka pësuar rritje progresive nga viti në vit. Grafiku i mëposhtëm paraqet ndryshimin e kapacitetit të instaluar në Sistemin e Transmetimit në 14 vitet e fundit.




Kushtet hidrologjike gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022 konsiderohen të mira duke reflektuar një rritje të energjisë së injektuar nga centralet e lidhura me rrjetin e transmetimit. Me gjithë rritjen e vazhduar të kapacitetit të instaluar, edhe gjatë vitit 2023 dukshëm konstatohet se peshën kryesore të prodhimit të energjisë në vend vijojnë ta mbajnë HEC-et e kaskadës së lumit Drin, të cilat mbulojnë 60 % të prodhimit të energjisë elektrike në vend.

Në vijim, paraqiten grafikisht të dhënat mbi prodhimin e energjisë në vendin tonë për vitin 2023, ku lehtësisht konstatohet se peshën më të madhe në prodhim e mbajnë centralet e administruara nga kompania KESH sh.a. .




Paraqitja grafike në vijim, pasqyron krahasimin e ndryshimit të prodhimit të energjisë elektrike në % në çdo muaj për vitin 2023 kundrejt vitit 2022. Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2023, në total ka rezultuar rreth 26 % më i lartë se ai i vitit 2022.




KONSUMI

Konsumi total i energjisë në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023 ka qenë 7.3 TWh, vlerë, e cila referuar konsumit të energjisë për vitin 2022 është 1.6 % më e ulët. Duhet


të kemi parasysh që kapaciteti prodhues në vend është kryesisht Hidro-Gjenerues dhe si rrjedhojë edhe pse niveli i gjenerimit në vendin tonë për vitin 2023 ka qenë më i lartë se niveli i konsumit, për periudha të ndryshme kur gjenerimi ka qenë i ulët plotësimi i kërkesës në vend është plotësuar nga importi.



Në vijim, janë paraqitur grafikisht të dhënat e energjisë në rrjetin e transmetimit për vitin 2023 në termat e ngarkesës mesatare, maksimale dhe minimale ditore për çdo muaj.




Grafikët në vijim e paraqesin ndarjen e konsumit total të energjisë sipas 2 kategorive kryesore të konsumatorëve.



Konsumi total i energjisë për konsumatorët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2023 është afërsisht 0.8 % më i ulët krahasuar me një vit më parë.



Nga grafiku duket qartë se kemi një rënie të konsumit edhe nga konsumatorët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes për periudhën 2022 kundrejt 2021 me 0.9%, e cila vazhdon uljen edhe për periudhën 2023 kundrejt 2022 me 0.8 %.



BALANCA E ENERGJISË

Kushtet hidrologjike janë faktori kryesor që ndikojnë në importin dhe eksportin e energjisë elektrike në vend. Gjatë vitit 2023, janë eksportuar nëpërmjet linjave të interkoneksionit 2.84 TWh energji dhe është importuar energji në vlerën 1.9 GWh. Në raportin mes prodhimit vendas dhe shkëmbimit të energjisë, bilanci për vitin 2023 në vlerat të netuara rezulton me 0.91 TWh energji e eksportuar.

Në vijim, paraqiten grafiksht vijimësia e shkëmbimit të energjisë në linjat e interkoneksionit për çdo muaj të vitit 2023.



IMPORT / EKSPORTI

Për vitin 2023, konsumi arriti në 7.3 TWh. Janë importuar 1.9 TWh energji për të plotësuar nevojat e vendit me energji gjatë periudhës së thatë dhe janë eksportuar 2.8 TWh energji në periudha të favorshme meteorologjike. Balanca e shkëmbimit në interkonjeksion është 0.9TWh në eksport. Edhe pse prurjet në kaskadën e lumit Drin, në pranverë dhe gjatë muajve nëntor - dhjetor, rezultuan të larta, kjo gjë nuk ndihmoi në përmbushjen e plotë të kërkesës së vendit për energji gjatë periudhave të thatësirës, dhe kështu për të përballuar kërkesën u sigurua energji elektrike nga importi për të plotësuar kërkesat e vendit.

**10.14 TWh**

Energjia Hyrëse në sistem

8.24 TWh


Prodhimi Vendas



1.9 TWh

Importi

2.8 TWh


Eksporti






Në vijim janë paraqitur grafikisht të dhënat mbi importin, eksportin për vitin 2023, të ndara këto sipas muajve dhe kufijve.


Eksporti i Energjisë



Importi i Energjisë




Shkëmbimi i netuar për vitin 2023 sipas muajve dhe kufijve



MENAXHIMI I KONTROLLIT TË FREKUENCËS (BALANCËS)

Kontrolli i frekuencës për Sistemin e Transmetimit në zbatim të kërkesave dhe përcaktimeve për operimin e integruar dhe funksionimin e qëndrueshëm të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar sipas Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” (i ndryshuar), Kodit të Rrjetit të Transmetimit, të miratuar me Vendim të ERE, Nr.63, datë 11.04.2022, “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” të miratuara me Vendimin ERE Nr.106 datë 02.07.2020 edhe vendimit ERE Nr. 275 datë 28.12.2021 i cili përcakton se Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike hyjnë në fuqi më datë 01.04.2021 dhe OST sh.a. i merr shërbimet balancuese nga Përdoruesit e kualifikuar si OSHB, Korporata Energjetike Shqiptare KESH sh.a.; Ayen as Energji sh. a.; Devoll Hydropower sh.a.

Gjatë vitit 2023, gabimi i zonës ka qenë brenda intervalit ± 20 MW në 87% të orëve.



ZBATIMI I KODIT TË TRANSMETIMIT NGA ANA E PËRDORUESVE TË RRJETIT.

Shoqëria OST sh.a., në rolin e tij si administrator i Kodit të Transmetimit ka detyrim evidentimin dhe trajtimin e problematikës së ndeshur në administrimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit nga shoqëria OST sh.a. , si dhe çështjet e zbatimit të Kodit të Rrjetit të Transmetimit nga përdoruesit e rrjetit, me qëllim plotësimin e standardeve të sigurisë operative në Rrjetin e Transmetimit si dhe për garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të pandërprerë me energji elektrike.

ERE me vendim nr. 63, datë 12.04.2022, miratoi versionin e ri të Kodit të Transmetimit, i cili hyri në fuqi më datë 01.07.2022.

Gjatë ushtrimit të detyrave funksionale për monitorimin e zbatimit të Kodit, OST sh.a. udhëhiqet nga parimi i krijimit të kushteve të barabarta dhe jo-diskriminuese duke dhënë suportin e nevojshëm për arritjen e standardeve dhe kërkesave teknike, për të ruajtur dhe garantuar sigurinë e sistemit dhe furnizimin me energji elektrike.

E gjithë veprimtaria e OST sh.a. është transparente dhe është bazuar në analiza të detajuara të çështjeve dhe rrethanave konkrete me qëllim shmangien e pasojave apo kostove të panevojshme si për përdoruesit ashtu dhe për OST sh.a. .

OST sh.a. është përpjekur të nxisë në mënyrë të vazhdueshme koordinimin dhe bashkëpunimin afatgjatë duke suportuar me anë të instruksioneve për përdoruesit apo duke ndërmarrë masat e nevojshme nëpërmjet strukturave të saj sipas nevojës dhe hapësirës që i lejon ligji. Komunikimi me përdoruesit ka qenë i vazhdueshëm dhe në çdo rast prej tyre është kërkuar që planifikimi dhe operimi i aseteve të tyre të bëhet bazuar në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit.

Duke patur parasysh se çdo dispozitë e Kodit të Transmetimit mund të jetë subjekt i vlerësimit të pajtueshmërisë, vlerësimi i përdoruesve mbi pajtueshmërinë e tyre është bërë sipas sipas :

- i. monitorimeve të realizuara sipas planit vjetor të vlerësimit të pajtueshmërisë;
- ii. rasteve të ngjarjeve në sistem;
- iii. rastet e papajtueshmërisë së përsëritur; dhe
- iv. pajtueshmërinë e përdoruesve e rinj, të lidhur gjatë 2023

OST monitoron zbatimin e Kodit të Transmetimit nga përdoruesit e rrejtit :

- a) gjatë fazës së ndërtimit;
- b) gjatë energjizimit;
- c) në operim;

Nëpërmjet sistemeve të kontrollit dhe monitorimit të OST, kryerjes së inspektimeve, testimit të sistemeve dhe proceseve apo mbledhjes dhe analizës së informacionit të nevojshëm nga përdoruesit e sistemit të transmetimit. Duke patur parasysh që bashkëpunimi ndërmjet OST dhe përdoruesit është në terma afatgjatë, fryma e bashkëpunimit mes OST dhe Përdoruesve konsiderohet pozitive.

SISTEMET E KONTROLL MONITORIMIT AUTOMATIK

Për të përmbushur objektivat, OST disponon sistemin SCADA/EMS për kontrollin automatik të Rrejtit të Transmetimit nëpërmjet sistemeve të kontrollit lokal (sisteme të instaluar në nënstacione). Këto sisteme, mundësojnë monitorimin dhe operimin në kohë reale të të gjithë nënstacioneve 220/400kV, si dhe pjesës më të madhe dhe

më të rëndësishme të nënstacioneve 110 kV. Krahas nënstacioneve monitorohen dhe operohen Centralet e lidhura në Rrjetin e Transmetimit.

Në sistemin SCADA/EMS janë të implementuara aplikacionet EMS. Paketa e aplikacioneve EMS shërben për analizën e sistemit të transmetimit.

Në qendrën e kontrollit të OST sh.a. është implementuar paketa e Rregullimit Automatik të Gjenerimit (AGC-Automatic Generation Control), modul i cili kontrollon prodhimin e gjeneratorëve në mënyrë që të mbajë frekuencën dhe shkëmbimin në vlerat e skeduluara. Ky modul është konfiguruar duke ju përmbajtur manualeve operacionale të publikuara nga ENTSO-E.

Në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit, si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera. Tashmë nga muaji korrik 2023, OST dispeçeron sistemin elektroenergjetik nëpërmjet sistemit “Network Manager 10.3”


Implementimi i versionit të ri të platformës SCADA/EMS na mundëson zhvillimet e mëposhtme :

- Implementimi i bllokut të kontrollit AK (Albania Kosovo).
- Integrimi i sistemit SCADA me sistemin e Balancimit.
- Përmirësim i Infrastrukturës së Sistemit SCADA/EMS.
- Rregullimit Automatik të Gjenerimit (AGC-Automatic Generation Control).
- Përmirësim i modulit AGC –aFRR.
- Përmirësim i modulit AGC-mFRR.
- Rregullimi Fuqi-Ngarkesë (LFC-Load Frequency Control).
- Përmirësim i Skedulimit të Gjenerimeve.
- Përmirësim i parashikimit të ngarkesës afatshkurtër.
- Përmirësime në ndërfaqet grafike të përdoruesit.
- Zëvendësimi i pajisjeve hardware dhe përditësim i sistemeve operative dhe “third-party softwares”.
- Përmirësime në kuadër të sigurisë kibernetike.
- Përmirësime në protokollin e komunikimit me nyjet periferike.
- Përmirësime në standardet CIM si dhe implementimi i standardit ENTSO-E CGMES.
- Përgatitje për platformën IGCC-International Grid Control Cooperation.


INVESTIMET

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të Transmetimit në funksion të garantimit dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike, është një nga objektivat kryesore të OST sh.a. . Në këtë drejtim një vëmendje e veçantë i kushtohet realizimit të projekteve të investimeve.

Realizimi i investimeve ndër vite paraqitet si më poshtë vijon:



Gjatë vitit 2023, OST sh.a. ka realizuar rreth 3,435 milionë lekë investime.



PROJEKTET KRYESORE TË FINANCUARA NGA OST SH.A. GJATË VITIT 2022

NDËRTIMI I LINJËS SË RE 220 KV DOPJO QARK FIER-HOXHARË ME PËRCJELLËS ACSR 490/65 SI DHE NDËRTIMI I N/ST TË RI 220/110/20 KV HOXHARË, BASHKË ME DY DALJE 220 KV

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a. . Gjatë vitit 2023 janë realizuar 788 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Rritje e kapaciteteve transmetuese dhe aksesit të burimeve të reja të prodhimit të energjisë së rinovueshme. Rritje të kapaciteteve transmetuese deri në 600 MW për fazën e parë, me mundësi shtimi deri në 1.2 GW gjatë fazës së dytë kur do të kalohet në nivelin e tensionit 400 kV. Ulje të energjisë së importuar.

NDËRTIMI I LINJËS 220 KV ME DY QARQE KOMSI-SHUMAT

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a. . Gjatë vitit 2023 janë realizuar 270 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Rrit kapacitetin pritës të rrjetit elektrik në segmentet Fierzë – Fushë Arrëz – Kukës – Lapaj – Peshkopi – Bulqizë – Burrel që përfaqëson një unazë 110 KV me një shtrirje në të gjithë zonën verilindore të vendit, në të cilën janë lidhur dhe janë në proces ndërtimi një numër i madh burimesh hidrike.

Synon operimin optimal të burimeve hidrike të zonës dhe një furnizim cilësor për konsumatorët e zonës.

Rrit sigurinë nëpërmjet reduktimit të numrit të stakimeve dhe kohës së ndërpre-rjeve tek HEC-et ekzistues dhe konsumatorët e zonës.

Ndikon në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimin e profilit të tensionit.

RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 110 KV LIBRAZHID - PREENJAS

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a. . Gjatë vitit 2023 janë realizuar 166 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Realizimi i këtij investimi do të sjellë rritjen e kapaciteteve transmetuese, rritjen e sigurisë së operimit për shkak të uljes së numrit të stakimeve, të konsumatorëve dhe gjenerimeve, përmirësim të niveleve të tensionit, reduktim të humbjeve të energjisë.

NDËRTIMI I LINJËS SË RE ME DY QARQE 110 KV BURREL - BULQIZË DHE REHABILITIMI I N/ST 110 KV BURREL E BULQIZË

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a. . Gjatë vitit 2023 janë realizuar 143 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Rritje e kapaciteteve dhe e sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Reduktimi i humbjeve me 0.79%, reduktimi i energjisë së mosfurnizuar, shtim të kapaciteteve transmetuese nga 70 MW në 246 MW. Ulje e kostove të mirëmbajtjes.

RIKONSTRUKSIONI I SHTYLLAVE METALIKE TË TENSIONIT TË LARTË

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a. . Gjatë vitit 2023 janë realizuar 108 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Rritje e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe rritje e kohëzgjatjes së shfrytëzimit të aseteve.

RIKONSTRUKSION I LINJËS 110 KV LUSHNJE - FIER

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a. . Gjatë vitit 2023 janë realizuar 92 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Rritje e kapaciteteve dhe e sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Reduktimi i humbjeve me 0.75 %, reduktimi i energjisë së mosfurnizuar, shtim të kapaciteteve transmetuese nga 70 MW në 123 MW. Ulje e kostove të mirëmbajtjes.

ZHVILLIMI I SKEMËS DHE RIKONSTRUKSIONI I N/ST 220/110/35/20 KV SHARRË

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a. . Gjatë vitit 2023 janë realizuar 87 milionë Lekë.

FURNIZIM VENDOSJE E QARKUT TË DYTË TË LINJËS 220 KV TEC FIER-BABICË-TEC VLORË

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a. . Gjatë vitit 2023 janë realizuar 51 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Rritje e kapaciteteve transmetuese dhe aksesit të burimeve të reja të prodhimit të energjisë së rinovueshme.

STUDIMET PËR ZHVILLIMIN E RRJETIT

Në kuadër të menaxhimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të rrjetit të transmetimit gjatë vitit 2023 janë realizuar disa studime, ku ndër më kryesoret përmendim:

Përgatitja e modeleve të rrjetit për regjime dhe vite referencë të ndryshme, sigurimi i të dhënave dhe realizimi i studimit ose oponencës teknike, në kuadër të:

- Hartimit të një studimi për vendosjen dhe koordinimin e roleve mbrojtëse për rrjetin OST në përputhje me kriteret e ENTSO-se, në kuadër të projektit të Digjitalizimit të Sistemit të Transmetimit.
- “Studim mbi Ndikimin e Integritit të BRE-ve në shkallë të gjerë në rrjedhat ndër rajonale të energjisë në CSE”, zhvilluar në kuadër të grupit të punës rajonal të planifikimit SECI.
- Përgatitja e modeleve për simulimin e rrjetit për vitet referencë 2025, 2030 dhe 2040, në kuadër të Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit European të ENTSO-E (TYNDP 2024).
- Simulime dhe llogaritje për vlerësimin e nevojës dhe efektivitetit të projekteve të ndryshme për zhvillimin e rrjetit të transmetimit në kuadër të përgatitjes së planit të investimeve për periudhën 2023 dhe 2023-2025 sipas analizës kosto-përfitim.
- Vijimi i hartimit të Programit të ri të zhvillimit 2026÷2036 i strukturuar në përputhje me Studimin e Master Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2018÷2033 sipas rekomandimeve të ERE.
- Hartimi i studimit, “Parashikimi i kërkesës për energji elektrike 2022-2042” në të cilin është realizuar parashikimi i kërkesës afatgjatë në vend për energji dhe specifikisht për energji elektrike, sipas metodologjisë së përdoruesve fundorë (duke shfrytëzuar modelin MAED).

Kalkulime për ;

- Shpërndarjen e flukseve të fuqisë për sistemin në tërësi duke patur në konsideratë parashikimet afatgjatë të zhvillimit të ngarkesës dhe të gjenerimit bazuar në kërkesat për pikë lidhje në rrjet.
- Vlerësimin e kriterit të sigurisë statike N-1.
- Shpërndarje specifike të flukseve të fuqisë janë realizuar për rajone të veçanta për identifikimin e zonave të rrjetit që kanë nevojë për fuqizime.
- Llogaritje të rrymave të lidhjeve të shkurtra për pika të ndryshme të sistemit.

Software që përdoret për modelimin dhe simulimin e skenarëve të ndryshëm të zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit është PSSE.

PROJEKTET ME FINANCIME TË HUAJA GJATË VITIT 2023

PROJEKTI “EFIÇENCA ENERGJETIKE”

FINANCIMI: Ky projekt financohet nga një kredi prej 40,000,000.00 Euro e akorduar nga Qeveria Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW. Vlera e realizuar gjatë vitit 2023, është 892 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Ky projekt, do të bëjë të mundur rritjen e besueshmërisë së funksionimit të rrjetit 220 kV të rajonit të Durrësit dhe të Jugut të Shqipërisë duke plotësuar kriteret teknike të sigurisë dhe cilësisë. Gjithashtu, ky projekt do të përmirësojë kushtet aktuale të furnizimit me energji elektrike të qytetit të Tiranës, duke konsideruar që një pjesë e rëndësishme e rrjetit unazor 110 kV që furnizon me energji elektrike nënstationet e sistemit të shpërndarjes në zonën e Tiranës, i ndërtuar përpara mbi 40 vjetësh i përbërë nga linja ajrore të amortizuara dhe kapacitetet transmetimi të limituar.

NDËRTIMI I LINJËS SË INTERKONEKSIONIT 400 KV ELBASAN 2 (SHQIPËRI) – BITOLA (MAQEDONI) DHE ELBASAN 2 – FIER SI DHE ZGJERIMI I NËNSTACIONEVE ELBASAN 2 DHE FIER

FINANCIMI: Financimi i këtij projekti, do të sigurohet nga bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar i Zhvillimit. Tashmë janë angazhuar fondet për një kredi të zhvillimit deri në 50.000.000 Euro për Qeverinë Shqiptare. Përveç kësaj, për të mbuluar financimin e plotë të projektit, do të vihet në dispozicion një grant nga WBIF prej 13.720.000 Euro. Gjithashtu, rreth 1.131.000 Euro, do të angazhohen nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano-Shqiptar, fonde të cilat do të përdoren për përgatitjen e dizajnit kryesor. OST sh.a., është angazhuar të mbulojë gjatë implementimit të projektit dhe kostot lokale, të cilat janë përlllogaritur të jenë rreth 5 milion Euro. Vlera e realizuar gjatë vitit 2023, është 501 milionë Lekë.

PËRFITIMET: Ky projekt përforcon lidhjet interkonektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike, dhe si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian.

MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

KULTURA E KOMPANISË BAZUAR NË VLERA

Struktura organizative e kompanisë është mjaft fleksibël, dhe krijon mundësi të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme. Politikat e burimeve njerëzore kanë në fokus përzgjedhjen dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar, zhvillimin e njohurive, menaxhimin e performancës dhe vlerësimin në vlerat e stafit. Barazia gjinore dhe mos-diskriminimi, përbëjnë gjithashtu një vlerë të kompanisë.

TRANSFERIM I NJOHURIVE DHE AFTËSIVE PËRMES BASHKËPUNIMIT

Krahas zhvillimit të programeve të vazhdueshme të trajnimeve për stafin e ri dhe atë me eksperiencë, çdo departament në OST sh.a. është i balancuar në një mënyrë të tillë ku stafi më me eksperiencë mund të ndajë aftësitë dhe njohuritë e tyre me stafin e ri, duke bërë të mundur në këtë mënyrë që OST sh.a. të vijojë të ruajë në vijimësi ekspertizën e çmuar të saj.

765



Numri mesatar i konsoliduar
i punonjësve gjatë vitit 2023

48

Mosha mesatare e punonjësve

238

Inxhinierë



Numri Total

Nivele Drejtuese

POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE

Politika që ndjek OST në lidhje me burimet njerëzore synon të sigurojë përzgjedhjen e personelit të kualifikuar, me eksperiencë dhe aftësi profesionale në të gjitha nivelet e shërbimit në OST sh.a., me qëllim që të mbështesë nevojat e kompanisë në të gjitha fushat ku OST sh.a. operon.

TRAJNIMET E PUNONJËSVE

Ambiciet tona për ku duam të shkojmë kërkojnë kualifikim të vazhdueshëm, për të qenë në nivel me të ngjashmit tanë në vendet e zhvilluara. Ndaj trajnimet kanë shërbyer jo vetëm për rritjen e kapaciteteve tona por më së shumti për të arritur objektivat e përbashkëta.

Trajnimi i kapaciteteve tona njerëzore është i detyrueshëm për t'u përshtatur me progresin që fusha jonë arrin çdo ditë por nga ana tjetër dhe për të qenë të gatshëm për sfidat e papritura e të vështira që mund të lindin në situata të rralla si Covid 19, ku stafi ynë i'a doli më së miri.

Për këtë arsye, OST sh.a., ka ngritur infrastrukturën e posaçme ligjore për trajnimet duke i dedikuar një kapitull të veçantë në manualin e burimeve njerëzore me qëllim mirëadministrimin e bazës së të dhënave për zhvillimin e trajnimeve. OST sh.a vlerëson kapacitetet profesionale dhe harton plane trajnimi për zhvillimin profesional të punonjësve të saj. Çdo vit në buxhetin e OST sh.a. ka një zë të veçantë të programuar për trajnime brenda apo dhe jashtë vendit. Këto trajnime janë gjithëpërfshirëse dhe ndihmojnë në rritjen e performancës jo vetëm të punonjësve por dhe kompanisë.

Kur ndihemi pjesë e diçkaje më të madhe se vetja, në rrisim bashkëpunimin, përpjekjen, pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen e dobishme nga ana organizative por dhe përmbajtësore.

SIGURIA E JETËS DHE E SHËNDETIT NË PUNË

OST sh.a., i kushton një vëmendje të veçantë, në mënyrë të vazhdueshme sigurisë së jetës dhe shëndetit në punë.

Nga ana e OST sh.a., janë marrë masat e nevojshme në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 "PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE TË INSTALIMEVE ELEKTRIKE", "Rregullores së shfrytëzimit teknik të centraleve elektrike, nënstacioneve, VKM Nr.483, datë 17.06.2020 "Për miratimin e rregullës teknike, "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, Mbi 1 kV" dhe "Rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike".

MJEDISI

Në kuader të Ligjit Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” OST sh.a. zbaton mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të rrjetit të transmetimit si një prej përgjegjësive të saj parësore dhe është vazhdimisht duke punuar për përmirësimin e performancës mjedisore në të gjithë aktivitetin e saj.

Në kuadër të përmirësimit të performancës mjedisore, OST sh.a., zbaton Sistemin e Menaxhimit Mjedor sipas standardeve ISO 14001:2015 me të cilin është ricertifikuar me 29.11.2023.

Gjatë vitit 2023, Sektori i Mjedisit ka zbatuar praktikatat si më poshtë :

1. Hartimi dhe ndjekja e procedurave për Ricertifikimin e OST sh.a. me Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit sipas standardeve ISO 14001:2015. OST sh.a., është ricertifikuar dhe pajisur me Certifikatë Nr. 0360A2023 në Dhjetor 2023, Standardi: S SH EN ISO/IEC 14001:2015 - Environmental Management Systems.
2. Jane hartuar, finalizuar dhe implementuar, kontratat e marrjes në përdorim të fondit pyjor dhe kullor për të gjitha bashkitë që preken nga “Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri - Maqedoni e Veriut”.
3. Janë hartuar dhe ndjekur procedurat për marrjen e lejeve mjedisore për projektet e konstruksionit dhe rikonstruksionit të linjave: “Ndërtimi i unazës të linjave 110 kV të Tiranës (Tirana 1; Traktori linjë kablore 110 kV, Tirana 3; Traktori linjë 110 kV pjesërisht kablore dhe pjesërisht ajrore, Tirana 3; Selita linjë 110 kV pjesërisht kablore dhe pjesërisht ajrore.”, VNM Nr. AN210920230001, datë: 26.09.2023 si dhe marrjen e lejes mjedisore (Deklaratë Mjedisore) për projektin “Ndërtim i linjës së re 220 kv dopjo qark Fier – Hoxharë me përcjellës acsr 490/65, si dhe Ndërtimi i nënstacionit të ri 220/110/20 kv Hoxharë, bashkë me dy dalje linje 220kv”.
4. Janë hartuar dhe aplikuar të gjitha Procedurat dhe Termat Teknike për pajisjen e projekteve të konstruksionit dhe rikonstruksionit të linjave me leje mjedisore përmes Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në varësi të projektit, në të cilin përshkruhen dhe vlerësohen efektet e drejtpërdrejta dhe indirekte të projektit tek njerëzit, flora dhe fauna, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klimën,

terrenin, si edhe ndërveprimin e këtyre faktorëve me trashëgiminë kulturore, shoqërore dhe mjedisore.

5. Janë hartuar masat e nevojshme që duhet të merren për parandalimin apo eliminimin e ndikimeve negative në mjedis për të gjitha projektet e konstruksionit dhe rikonstruksionit të cilat u janë dërguar kontraktorëve për zbatimin e masave mitiguese në terren.
6. Janë ndjekur dhe monitoruar zbatimet e masave mitiguese në terren për projektet: “Rikonstruksioni i Linjës 110 kV Cërrik – Kajan – Kuçovë - Jagodinë”; “Rikonstruksioni i linjës ekzistuese 110 kV Lushnje-Fier dhe demontimi i linjës ekzistuese”;. “Rikonstruksioni i linjës 110 kV Librazhd-Prrerjas”.
7. Pas vlerësimit të efekteve që mund të shkaktohen në mjedis, janë kërkuar dhe vlerësuar raportet 6-mujore të monitorimit të masave mitiguese të cilat janë përcjellë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si kusht ligjor i zbatimit të masave dhe kushteve të VNM dhe/apo Deklaratës Mjedisore për projektet si më sipër cituar.
8. Pjesë e rëndësishme e punës së Sektorit të Mjedisit, mbetet monitorimi i mjedisit në nënstacionet dhe objektet e Njësive Operative të OST sh.a., i cili ka në fokus identifikimin e problematikave mjedisore, reagimin e personelit për zbatimin e detyrave të lëna në inspektimet e mëparshme si edhe përcaktimi i masave dhe detyrave për parandalimin e ndikimeve negative në mjedis, me qëllim rritjen e vazhdueshme të performancës mjedisore të aktivitetit operacional dhe institucional të OST sh.a. Gjatë vitit 2023, janë organizuar dhe kryer inspektime në periudhën kohore Mars-Prill 2023 dhe Shtator-Tetor 2023 në të gjitha Njësitë Operative të OST sh.a. si: Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë, Burrel dhe Shkodër.
9. SM ka koordinuar dhe mundësuar bashkëpunimin dhe finalizimin e procedurave të inspektimeve mjedisore të iniciuara nga AKM, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjensitë Rajonale të Mjedisit në Tiranë, Berat dhe Fier.

OST sh.a. zbaton ligjin mjedisor për të gjitha projektet që në fazën e parë të projektimit, gjatë zbatimit si dhe pas realizimit të projekteve. Gjatë vitit 2023, janë realizuar procedurat për mbrojtjen e mjedisit për projektet e mëposhtme :

- Projekti “Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri- Maqedoni e Veriut”;
- Projekti “Rikonstruksioni i Linjës 110 kV Cërrik – Kajan – Kuçovë - Jagodinë”;
- Projekti “Ndërtim e montim i Linjës 220 kV me dy qarqe Komsit – Shumat” dhe “Ndërtim i Nënstacionit 220/110/35 kV, Shumat dhe traktit 220 kV, në Nënstacionin 220/110/10 kV Komsit”;

- Projekti “Nënstacioni i Rrashbullit - Nënstacioni Tirana 2” dhe “Linja Unaza e Tiranës”;
- Projekti “Rikonstruksioni i linjës ekzistuese 110 kV Lushnje-Fier dhe demontimi i linjës ekzistuese”;
- Projekti “Ndërtimi i linjës së re 110 kV, dopjo qark Elbasan – Cërrik”
- Projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV dopjo qark Nënstacioni Elbasan – Nënstacioni Fibër”
- Projekti “Rikonstruksioni i linjës 110 kV Librazhd-Prenjas”;
- Projekti “Ndërtimi i linjës 220 kV Fier- Hoxharë dhe Nënstacioni Hoxharë”;
- Projekti “Ndërtimi i linjës së re me dy qarqe 110 kV Burrel-Bulqizë dhe rehabilitimi i Nënstacioneve 110 kV”;

Për çdo projekt janë realizuar procedurat si më poshtë :

- Procedurat për zbatimin e legjislacionit për pyjet e kullotat në rast se projekti kalon në sipërfaqet pyjore e kullosore, duke bërë të mundur sigurimin e të gjitha dokumentacioneve si: Kontrata me Bashkitë për marrjen me qera të sipërfaqeve pyjore, Urdhër Ministri/ Projektvendim/ Projektligj për heqje nga Fondi pyjor/ kullosor, në bazë të sipërfaqes pyjore/kullosore të kërkuara.
- Informimit dhe ndërgjegjësimin e grupeve të interesit në zonat e zbatimit të projektit, në lidhje me ndikimet negative që mund të shkaktohen si pasojë e zbatimit të projekteve, në rastet e kërkuara nga legjislacioni dhe institucionet.
- Hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit Mjedisor duke u bazuar në kushtet mjedisore të vendosura në Deklaratën Mjedisore apo Vendimin për VNM Paraprake të miratuar për projektin, duke marrë masat për të shmangur, reduktuar apo pakësuar të gjitha ndikimet e padëshirueshme në mjedis.

Proceset e monitorimit dhe inspektimit mjedisor në terren të projekteve të ndërtimit të nënstacioneve e linjave gjatë fazës së ndërtimit si edhe zbatimin e të gjitha kushteve të vendosura në VNM Paraprake apo Deklaratën Mjedisore pas përfundimit të zbatimit të tyre.

PJESËMARRJE NË ORGANIZMAT RAJONALE

OST sh.a. është vazhdimisht në kërkim të përmirësimit të performancës së saj teknike dhe financiare, për të përmbushur standardet më të mira ndërkombëtare të Komunitetit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe të organizatave evropiane, të cilat nxisin dhe monitorojnë hapjen e tregut të brendshëm të energjisë elektrike, si dhe integrimin e këtij tregu në tregun rajonal dhe evropian të energjisë. Sfidat e tregut të përbashkët të energjisë elektrike janë të shumta dhe OST në përpjekje për t'u integruar në këtë treg si të gjithë operatorët e tjerë të sistemit të transmetimit, bashkëpunon me partnerë të ndryshëm :

- Bashkëpunimi rajonal (projekte të ndryshme ku OST merr pjesë në nivel rajonal);
- Anëtarësime (anëtarësimet në organizma të ndryshme si ENTSOE, MED-TSO etj);
- Aksionet e shoqërisë (shoqëri apo organizma ku OST merr pjesë si aksionar).

BASHKËPUNIMI RAJONAL

- **WB6 MoU:** Në datë 27 Prill 2016, ndërmjet Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, Autoriteteve Rregullatorë Kombëtarë në fushën e energjisë, Bursave të Energjisë (PX) dhe Ministrive përgjegjëse për energjinë të shteteve





përkatëse të Ballkanit Perëndimor - WB6 (Shqipëri, Bosnje- Hercegovinë, Maqedoni, Kosovë, Mali i Zi dhe Serbi), u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit, nëpërmjet të cilit palët angazhohen për të ndjekur një iniciativë rajonale të tregut të energjisë që konsiston në krijimin e Bursave të Energjisë (PX) dhe një tregu rajonal të balancimit, me qëllim integrimin

efikas të tregjeve të energjisë elektrike të ditës në avancë të shteteve të WB6, në mënyrë që t'u sigurojë pjesëmarrësve të tregut mundësi të reja biznesi dhe më shumë tregti ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor për të arritur efikasitet, çmime konkurruese dhe standarde të larta të shërbimeve. Synimi përfundimtar i palëve është integrimi i tregjeve të energjisë të vendeve të WB6 me bashkimin e tregut të ditës në avancë (day-ahead Multi-Regional Coupling (MRC) të BE-së, në

përputhje me Rregulloren e Komisionit të BE 2015/1222 CACM. Gjatë vitit 2017, aderuan në Memorandumin e Mirëkuptimit të WB6, Operatori Italian i Sistemit të Transmetimit, Autoriteti Italian Rregullator Kombëtar, Bursa Italiane e Energjisë, si dhe Bursa e Energjisë e Malit të Zi. Në Qershor të vitit 2021, në Memorandumin e Mirëkuptimit të WB6, aderoi ALPEX – Bursa Shqiptare e Energjisë.

- **Bashkimi i tregut Shqipëri – Kosovë:** OST së bashku me KOSTT, është pjesë e iniciativës për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës dhe gjatë vitit 2023 ka punuar shumë në drejtim të konkretizimit të hapave ligjore dhe teknike që duhen ndërmarrë në kuadër të realizimit të planit të bashkimit të tregut të Shqipërisë dhe Kosovës, në përputhje me angazhimet e ndërmarra nga ana e të dy Qeverive, në kuadër të Memorandumeve të Mirëkuptimit, të firmosur në Nëntor të vitit 2017 nga ana e tyre, Memorandumit të Mirëkuptimit të firmosur mes OST, KOSTT, ERE dhe ZRE në Qershor 2018 si dhe Marrëveshjes Kornizë të firmosur në Tetor 2021 mes ERE, ZRE, OST dhe KOSTT. Në bazë të kësaj Marrëveshje Kornizë OST, KOSTT dhe ALPEX, ngritën Komitetin Drejtues dhe filluan punën për hartimin e Marrëveshjes Operacionale të Bashkimit të Tregut të Ditës në avancë dhe zhvilluan të gjitha testet e nevojshme për realizimin me sukses të operimit të bashkimit të tregjeve të ditës në avancë, të Shqipërisë dhe Kosovës.
- **Bashkimi i tregjeve Greqi-Shqipëri-Kosovë-Maqedoni e Veriut:** OST është pjesë e Iniciativës për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë në Europën Juglindore (SEE Electricity Day-Ahead Market Coupling), e udhëhequr nga Shoqata Amerikane e Energjisë (USEA), në bashkëpunim me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Kjo iniciativë u formalizua nëpërmjet nënshkrimit, në Athinë, Greqi, në datën 13 Nëntor 2023, të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Enteve Rregullatore të Energjisë, Operatorëve të Sistemit të Transmetimit dhe Bursave të Energjisë, përkatëse të Greqisë, Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Palët kanë marrë përsipër të punojnë së bashku për të përfshirë zonat e tyre të ofertimit dhe kufijtë e përbashkët ndërkufitarë përkatës, në Tregun e Brendshëm të Integruar European të Energjisë. Kjo do të arrihet duke integruar tregjet kombëtare me shumicë të energjisë elektrike në nivelin e ditës në avancë, duke zbatuar Modelin e synuar të BE-së për alokimin implicit të kapaciteteve, nëpërmjet aderimit dhe pjesëmarrjes në organizatat ekzistuese Bashkimit Unik të Tregut të Ditës në avancë (Single Day-Ahead Market Coupling [SDAC]) dhe grupeve përkatëse të punës.


ANËTARËSIME


- 
MED-TSO: Që prej muajit Dhjetor 2011, OST është e anëtarësuar në organizatën “Mediterranean Transmission System Operators, e cila ka për qëllim kryesor promovimin dhe sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet OST-ve të rajonit të Mesdheut dhe të përfaqësimit të interesave dhe vizionit të anëtarëve të saj si dhe suportimi i ideve dhe projekteve të përbashkëta të cilat mund të ndihmojnë në forcimin e sigurisë së sistemeve elektroenergjetike dhe integrimin e sistemeve elektrike të rajonit në atë Evropian.
- 
ENTSO-E Rrjetit Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike, që prej muajit Mars 2017, duke finalizuar një proces të nisur që në vitin 2004 dhe që u bë i mundur vetëm pas certifikimit nga ana e ERE-s dhe kryerjes së investimeve të rëndësishme në rrjetin e transmetimit dhe vendosjes si prioritet dhe objektivi kryesor i shoqërisë OST sh.a. .

Si rezultat i nënshkrimit dhe ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar të “Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë të vendeve të Evropës Juglindore” miratuar me ligjin Nr. 9501, datë 03.04.2006, në bazë të të cilit shtetet nënshkruese marrin përsipër implementimin e legjislacionit kyç të energjisë elektrike në BE, brenda një afati kohor të përcaktuar, OST sh.a. merr pjesë dhe jep kontributin përkatës në aktivitetet e Komunitetit të Energjisë objektivi kryesor i të cilit është zgjerimi i rregullave dhe principeve të tregut të përbashkët evropian të energjisë tek vendet e Evropës Juglindore, Rajonit të Detit të Zi e më gjerë, në bazë të një kuadri të detyrueshëm ligjor (acquis communautaire). Në datën 15 Dhjetor 2022, Këshilli Ministerial i Komunitetit të Energjisë, me Vendimin Nr. 03/2022, miratoi paketën ligjore të Energjisë së Pastër (Clean Energy Package), e cila reflekton aktet ligjore evropiane të miratuara dhe adoptuara më së fundmi nga vendet e Komunitetit Evropian, në fushën e energjisë elektrike. Afati i adoptimit të kësaj pakete ligjore nga vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, ishte 15 Dhjetori i vitit 2023. Gjatë këtij viti, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mbështetjen e Bankës Botërore, ka angazhuar konsulencë të kualifikuar me qëllim përgatitjen e ligjit të ri të sektorit të energjisë dhe implementimin nëpërmjet akteve nënligjore të Kodeve të Rrjetit, pjesë e paketës ligjore të adoptuar nga Komuniteti i Energjisë. Implemetimi i kësaj pakete, është një sfidë shumë e rëndësishme për vendin tonë dhe të gjitha vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë, si dhe veçanërisht për OST-në, si kompania që jo vetëm

ka përgjegjësi për operimin e Sistemit të Transmetimit Shqiptar, por luan edhe një rol qendror në mirëfunksionimin dhe koordinimin e gjithë Sistemit Elektroenergetik Shqiptar dhe ka rolin kryesor në proceset e bashkimit të tregjeve të energjisë (market coupling).

AKSIONET E SHOQËRISË

- 

SEE CAO: OST sh.a. është një prej shoqërive themeluese të SEE CAO (South East Europe Capacity Allocation Office) së bashku me shoqëritë e transmetimit të Malit të Zi, Kroacisë, Greqisë, Kosovës, Bosnje-Hercegovinës, Turqisë, dhe Maqedonisë, ku OST merr pjesë si bashkëpronare me të drejta të barabarta vote. SEE CAO është një provë reale e përpjekjeve të bashkëpunimit rajonal ndërmjet OST-ve të rajonit dhe krijon kushtet e përshtatshme për zhvillimin e tregut të përbashkët të energjisë në rajon.
- 

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike: Në zbatim të nenit 57 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” (i ndryshuar), VKM Nr. 322 datë 15.05.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të operatorit të tregut”, me Vendimin Nr. 130, datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka miratuar pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - **ALPEX sh.a.**, me 57.25 % të kapitalit themeltar; si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat janë nënshkruar nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.. Në datën 05 Tetor 2020, përfaqësuesit ligjorë të OST sh.a. dhe KOSTT sh.a., kanë firmosur Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX.

RAPORTI I AUDITUESVE LIGJORË

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA 2023

SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Audituesit Ligjorë


Mazars sh.p.k	Studio Vlar Consulting sh.p.k	Rajmonda Revelli	Crowe AL sh.p.k	Moore Albania sh.p.k
Adresa: Rr. Emin Durraku, Pall. Bujakut Nr. 1, Hyrja Nr. 5, Kati 2, Tiranë	Adresa: Rr. Llogi Gurakuq, Nd.Nr.18 H4 Kati 6 Tiranë	Adresa: Rr. Komuna Parisit, Hyrja 6 Ap.10, Tiranë	Adresa: Rr. Brigada 8, Pall. 8/1, Ap.14, Tiranë	Adresa: Rr. Tish Dajja, Kompleksi Koka 2, Objekti 7, Shkalla 7, Kati 5, Tiranë

RAPORT I AUDITUESVE LIGJORË TË PAVARUR

**Drejtuar: Ministrisë së Financave
(Aksionerit të Vetëm)**

Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a

Administratorit të OST sh.a



Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë OST sh.a. (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2023, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimit për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2023, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përkrahur në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare të konsoliduara. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (BSNEPK) si dhe kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shoqipëri dhe kemi përmbytur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet e Rëndësishme të Auditimit

Çështje të Rëndësishme të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qenë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qenë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.

Audituesit Ligjorë

Mazars sh.p.k	Studio Vlar Consulting sh.p.k	Rajmonda Revelli	Crowe AL sh.p.k	Moore Albania sh.p.k
Adresa: Rr. Emin Duraku, Pall. Benjakut Nr. 1, Hyrja Nr.5, Kati 2, Tiranë	Adresa: Rr. Laçig Gurakapi, Nd.Nr.18 H4, Kati 6 Tiranë	Adresa: Rr. Komuna Parisut, Hyrja 6 Ap.10, Tiranë	Adresa: Rr. Brigada 8, Pall. 8/1, Ap.14, Tiranë	Adresa: Rr. Tish Dajç, Kompleksi Kika 2, Objekti 7, Shkallë 7, Kati 5, Tiranë

Cështja e rëndësishme e auditimit	Si i ka adresuar auditimi jonë cështjet e rëndësishme të auditimit
Rivlerësimi aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale Me 01.01.2023 shoqëria ka kryer rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale në përputhje me kërkesat e SNK 16 dhe SNK 38.	Procedurat tona të auditimit përfshijnë: (1) Ne rishikuar raportet e rivlerësimit të aseteve për të gjitha njësitë me 01.01.2023 dhe gjykojmë nëse supozimet e ngritura për vlerësimin dhe kalkulimet e kryera ishin të sakta. (2) Ne kontrolluam nëse efekti rivlerësimit të AAM dhe AAJM është pasqyruar korrekt në pasqyrat financiare.
Njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve financiare Shoqëria klasifikon, njeh dhe mat aktivet dhe detyrimet e saj financiare në përputhje me kërkesat e SNRF 9.	Procedurat tona të auditimit përfshijnë: (1) Rishikimin e metodologjisë së vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare në përputhje me parimet dhe kërkesat e SNRF 9. (2) Morëm në konsideratë inpaktin e supozimeve të kryera nga Shoqëria si dhe faktorët e konsideruar prej saj në metodologjinë e aplikuar. (3) Kontrolluam aplikimin e saktë të metodologjisë mbi aktivet dhe detyrimet financiare sipas klasifikimeve përkatëse. (4) Kryem procedurat e auditimit mbi vlerësimet kontabël sipas kërkesave të SNA.

Cështje për tu theksuar

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin e mëposhtëm, i cili përshkruan situatën dhe gjykimet në tepricat e zërave përkatës. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë cështje.

Në pikën 11 të Shënimeve Shpjeguese - Llogari të Arkëtueshme është dhënë informacion për analizën e klientëve për produkte e shërbime të shoqërisë OST sh. a, ku është përfshirë edhe analiza e marrëdhënieve me OSHEE sh.a tepricat në periudhat ushtrimore të cilat paraqiten si më poshtë:

Pala e tretë	Viti 2023	Viti 2022
OSHEE sh.a	18,196,330,299	17,716,649,714

ku në të arktëtueshme nga OSHEE përfshihen edhe vlerat 2,378,241,772 lekë të cilat përfaqësojnë fatura të lëshuara nga OST për sistemin e faturave të shërbimeve të balancimit për vitet paraardhëse 2016/2017 të papranuara nga OSHEE (me shkresën OSHEE Nr. 10615/1 date 11.06.2018), cështje e cila ka kaluar në proces gjyqësor ndërmjet OST dhe OSHEE.

Me 15 prill 2021 ndërmjet OSHEE sh.a dhe OST sh.a është firmosur "Marrëveshja për pagesën e detyrimeve të prapambetura" në shumën 9,687,768,309 lekë. Marrëveshja përfshin një skemë pagese duke filluar nga data 1 korrik 2021 për një shumë minimale prej 360 milionë lekë në vit ose 6.5% të faturave aktuale vjetore, të cilat do të shlyejnë tepricat e mbartura. Bazuar në këtë marrëveshje shumat totale të papaguara nga OSHEE sh.a kundrejt OST sh.a do të shlyhen deri në vitin 2047.

Përgjatë vitit 2023 nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në statusin e cështjeve pasi pritet vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit.




Audituesit Ligjorë

Mazars sh.p.k	Studio Vjar Consulting sh.p.k	Rajmonda Revelli	Crowe AL sh.p.k	Moore Albania sh.p.k
Adresa: Rr. Eman Doraku, Palli Brigadieri Nr. 1, Hyrja Nr.5, Kati 2, Tiranë	Adresa: Rr. Lutj Gurabaj, Nr.18 .H4. Kati 6 Tiranë	Adresa: Rr. Komuna Parizit, Hyrja 6 Ap.10, Tiranë	Adresa: Rr. Brigada 8, Palli 8/1, Ap.14, Tiranë	Adresa: Rr. Tish Dajja, Kompleksi Kika 2, Objekti 7, Salla 7, Kati 5, Tiranë

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2022 janë audituar nga disa auditues të tjerë të cilët kanë shprehur një opinion te pamodifikuar në datë 27 Prill 2023.

Informacione të Tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë raportin e drejtimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare të konsoliduara apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përmidryshe, nëse, duket se përbajnë anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se këto informacione përbajnë anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me palët e ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF dhe ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për

Audituesit Ligjorë

Mazars sh.p.k	Studio Vlar Consulting sh.p.k	Rajmonda Reveli	Crowe AL sh.p.k	Moore Albania sh.p.k
Adresa: Rr. Emin Durraku, Pall. Bujakët Nr. 1, Hyrja Nr.3, Kati 2, Tiranë	Adresa: Rr. Lwig Gurahaqi, Nd.Nr.18 ,H4. Kan 6 Tiranë	Adresa: Rr. Komuna Parisit, Hyrja 6 Ap.10, Tiranë	Adresa: Rr. Brigada 8, Pall 8/1, Ap.14, Tiranë	Adresa: Rr.Tah Dajja, Kompleksi Kika 2, Objekti 7, Shkalla 7, Kati 5, Tiranë

opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

12 Prill 2024

mazars

Emin Durraku Str., Bujakët Build,
No.5, 1013, Tiranë, Albania
NUIIS: K32123006W



Diana Ylli
Mazars sh.p.k

Audituesit ligjorë



Fatime Allu
Studio Vlar
Consulting sh.p.k



Rajmonda Reveli



Nexhmije Çela
Crowe AL sh.p.k

Desara Liko



Moore Albania sh.p.k

MOORE
Moore Albania sh.p.k
NUIIS: M31904014L
Rr. Tah Dajja, Kati 2, P. 7, Kati 5, Tiranë, Shqipëri

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA 2023

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR

(të gjitha shumat në lekë)

		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
AKTIVET	Shënime		
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	56,126,767,093	48,928,765,928
Aktive afatgjata jomateriale	7	268,119,659	178,449,077
Aktive me të drejtë përdorimi	8	73,739,322	28,038,847
Aktive afatgjata financiare	9	12,107,508	11,471,758
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	11	8,429,229,200	8,787,768,309
<i>Totali i aktiveve afatgjata</i>		64,909,962,782	57,934,493,919
Aktivet Afatshkurtra			
Inventarë	10	707,435,563	714,637,057
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	11	11,308,216,302	12,386,744,460
Aktive afatshkurtra financiare	9	20,090,000	20,815,750
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	12	1,480,786,281	1,564,988,039
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	13	5,116,917,526	4,706,171,573
<i>Totali i aktiveve afatshkurtra</i>		18,633,445,672	19,393,356,879
Totali i aktiveve		83,543,408,454	77,327,850,798
Kapitali neto dhe detyrimet			
Kapitali aksionar	14	25,055,608,000	25,055,608,000
Rezerva ligjore	14	868,186,507	822,807,118
Rezerva rivlerësimi	14	7,805,859,990	5,421,483,544
Rezerva të tjera	14	875,711,845	13,868,508
Fitime të pashpërndara		875,499,615	453,195,480
Fitimi i Vitit		5,526,800,290	907,587,774
<i>Totali i kapitalit për pronarin</i>		41,007,666,247	32,674,550,424

Kapital i pakicës	14	106,875,000	106,875,000
Rezerva të tjera të pakicës	14	(475,235)	(202,646)
Fitime të pashpërndara të pakicës		(36,174,290)	(13,937,127)
Fitimi i Vitit		(32,582,789)	(22,237,162)
Total interesat jo-kontrolluese		37,642,686	70,498,065
Totali i kapitalit aksionar		41,045,308,933	32,745,048,489
Detyrimet afatgjata			
Huatë afatgjata	15	10,100,140,897	13,418,044,467
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	16	2,371,103,621	3,417,124,425
Grantet	17	1,179,631,419	1,155,575,856
Detyrimi i qirasë	8	59,681,953	26,991,103
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	18	1,529,693,131	781,655,599
Totali i detyrimeve afatgjata		15,240,251,021	18,799,391,450
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	16	11,903,078,262	9,959,035,190
Parapagimet nga klientët	19		260,796,227
Të ardhura të shtyra	20	218,103,124	87,472,993
Hua afatshkurtër	15	14,942,052,998	15,143,428,546
Detyrimi i qirasë	8	20,835,163	3,359,918
Tatim fitimi	28	173,778,953	329,317,985
Totali i detyrimeve afatshkurtra		27,257,848,500	25,783,410,859
Totali i detyrimeve		42,498,099,521	44,582,802,309
Totali i kapitalit neto dhe pasiveve		83,543,408,454	77,327,850,798

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara.


Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 4 Prill 2024 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Administratori
Skeën Drenova




OPERATOR
I SISTEMEVE
TE TRANSMETIMIT

Drejtori / Drejtorisë
Ekonomike
Artur Kurti



Shefe e sektorit
të Kontabilitetit dhe Taksave
Arjola Qirko



PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE


		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Shënime			
Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	21	6,043,749,703	5,882,286,134
Të ardhura nga alokimet e kapaciteteve	21	2,507,858,138	1,829,594,040
Të ardhura nga disbalanca	21	1,313,422,828	2,992,902,683
Të ardhura të tjera	21	219,533,104	158,252,284
<i>Total të ardhura nga veprimtaria e shfrytëzimit</i>		10,084,563,773	10,863,035,141
Shpenzime për veprimtaritë e shfrytëzimit			
Shpenzime për materiale	22	(104,060,733)	(116,746,178)
Kosto transmetimi	23	(3,307,521,901)	(3,881,270,568)
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	24	(1,031,483,313)	(931,365,649)
Shpenzime të personelit	25	(1,211,555,191)	(1,255,997,685)
Rënia në vlerë, zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7,8	(2,565,598,477)	(2,255,972,874)
Humbje nga rënia në vlerë e aseteve	6,7	2,545,908,523	(2,596,653,373)
Provigjione/fshirje të llogarive	26	(121,421,566)	123,298,001
<i>Total i shpenzimeve nga veprimtaritë e shfrytëzimit</i>		(5,795,732,658)	(10,914,708,326)
<i>Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit</i>		4,288,831,115	(51,673,185)
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Shpenzime interesi	27	(413,758,538)	(447,486,322)
Kostot financiare neto	27	2,270,936,127	1,326,350,679
<i>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare, neto</i>		1,857,177,589	878,864,357
<i>Fitimi para tatimit</i>		6,146,008,704	827,191,172
Fitimi para tatimit			
Shpenzimi i tatimit mbi fitimit	28	(679,465,167)	(580,009,613)
Shpenzimet/(të ardhurat) e tatimit të shtyrë	18	27,673,964	638,169,053

<i>Fitimi pas tatimit</i>		5,494,217,501	885,350,612
I cili i përket:			
OST sh.a. me 57.25% aksione		5,526,800,290	907,587,774
Interesat e pakicës me 42.75% aksione		(32,582,789)	(22,237,162)
<i>Të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse:</i>		(422,941,773)	(439,590,620)
Totali të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		5,071,275,728	445,759,992

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara.

PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

	Kapitali Nënshkruar	Rezerva nga rivlerësimi	Rezerva Ligjore
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2021</i>	22,146,576,634	7,858,369,996	789,775,831
Fitimi neto për periudhën ushtrimore			
Shpërndarja e fitimit të vitit 2021			33,031,287
Rritje kapitali vendimi i Asamblesë së Përgjithshme	2,909,031,366		
Kontabilizimi i testit të zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale		(2,053,042,051)	
Kontabilizimi i vlerësimit të huave		55,413,952	
Realizimi i rezervës së rivlerësimit		(439,258,353)	
Rezerva përkthimi			
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2022</i>	25,055,608,000	5,421,483,544	822,807,118
Fitimi neto për periudhën ushtrimore			
Shpërndarja e fitimit të vitit 2022			45,379,389
Efekti i rivlerësimit të huave afatgjata		3,623,048,329	
Tatimi i shtyrë për rezervën e rivlerësimit të aktiveve afatgjata		(775,711,496)	
Kontabilizimi i vlerësimit të huave		(40,656,253)	
Realizimi i rezervës së rivlerësimit		(422,304,134)	
Rezerva përkthimi			
Gjendja më 31 dhjetor 2023	25,055,608,000	7,805,859,990	868,186,507



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali kapitalit	Interesat e pakicës	Totali i kapitalit aksionar
517,627,527	2,452,430,983	33,764,780,971	92,877,271	33,857,658,242
	907,587,774	907,587,774	(22,237,162)	885,350,612
627,594,442	(660,625,729)			
(1,131,163,239)	(1,777,868,127)			
		(2,053,042,051)		(2,053,042,051)
		55,413,952		55,413,952
	439,258,353			
(190,222)		(190,222)	(142,044)	(332,266)
13,868,508	1,360,783,254	32,674,550,424	70,498,065	32,745,048,489
	5,526,800,290	5,526,800,290	(32,582,789)	5,494,217,501
862,208,385	(907,587,774)			
		3,623,048,329		3,623,048,329
		(775,711,496)		(775,711,496)
		(40,656,253)		(40,656,253)
	422,304,134			
(365,048)		(365,048)	(272,591)	(637,639)
875,711,845	6,402,299,904	41,007,666,247	37,642,685	41,045,308,931

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
<i>Fitimi para tatimit</i>	6,146,008,704	827,191,172
Rregullime për:		
Amortizimin e aktiveve	2,565,598,477	2,255,972,874
Humbje nga rënia në vlerë e asetëve	(2,545,908,523)	2,596,653,373
Humbje nga rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme	121,421,566	(123,298,001)
Të ardhura jomonetare nga grantet	(95,533,824)	(62,931,913)
Të ardhura nga interesi	(6,360,160)	(391)
Shpenzime interesi	413,758,538	447,486,322
<i>Fitime neto nga kursi i këmbimit</i>	(2,264,916,627)	(1,380,081,432)
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:		
Parapagime për furnitorë	84,201,758	48,012,346
Inventarë	(19,312,191)	(70,699,901)
Llogari të arkëtueshme tregtare e të tjera	1,055,851,545	182,990,957
Llogari të pagueshme tregtare e të tjera	848,314,296	433,934,432
Parapagime nga klientë	(260,796,227)	156,307,381
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(103,681,372)	4,484,346,047
Interes i paguar	(226,990,876)	(1,086,949,798)
Tatim fitimi i paguar	(505,686,214)	(250,691,628)
<i>Flukset neto të parasë gjeneruar nga aktivitetet operative</i>	5,309,650,242	3,973,895,793
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(3,637,846,076)	(2,732,551,609)
Vlera e AAM dhe inventareve të nxjerra jashtë përdorimi		118,153,783
Shlyerje të kredive të palëve të treta	90,000	815,750
Interesa të arkëtuar	6,360,161	391
<i>Flukset neto të parasë përdorur në aktivitetet investuese</i>	(3,631,395,915)	(2,613,581,685)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese		
Të hyra nga huamarrje afatgjata	930,947,301	1,250,690,018
Shlyerje të huamarrjeve	(2,300,598,397)	(1,694,133,940)
Shlyerje qiraje	(17,446,666)	(8,610,420)
Të hyra nga grantet	119,589,388	53,323,807
<i>Flukset neto të parasë të gjeneruara në aktivitetet financuese</i>	(1,267,508,374)	(398,730,535)
Rritje / (Rënie) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre	410,745,953	961,583,573
Mjetet monetare në fillim të vitit financiar	4,706,171,573	3,744,588,000
Mjetet monetare në fund të vitit financiar	5,116,917,526	4,706,171,573

Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve Monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara.

SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

1. Informacion i përgjithshëm

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. një Shoqëri publike me 100 % të aksioneve në pronësi të shtetit.

Administratori i Shoqërisë është Z. Skerdi Drenova. Shoqëria është e regjistruar me NIPT K42101801N.

Shoqëria u krijua në korrik të vitit 2004 bazuar në Vendimin nr. 797 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 4 dhjetor 2003. Në bazë të këtij vendimi Shoqëria u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergetike Shqiptare Sh.a. (“KESH”) me kapital fillestar prej 2,000 mijë Lekë. Ndarja nga KESH u krye bazuar në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 30 qershor 2006. Shoqëria përgatiti pasqyra financiare të konsoliduara si një njësi ekonomike e veçantë duke filluar prej 1 korrik 2006 dhe jo prej vitit 2004 kur nisën të kryheshin transaksionet e para të Shoqërisë. Në vitin 2006 Shoqëria mori licencën për transmetim energjie nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri dhe në vijim nënshkroi një marrëveshje për shërbime transmetimi me KESH Bazuar në urdhrin nr. 329 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes (‘Ministria’) datë 9 maj 2008, pronësia e OST iu transferua Ministrisë. Me anë të urdhërit numër 10540/17 të Ministrisë, Shoqëria, prej datës 1 janar 2008 filloi të faturonte shërbimet e saj, aktivitetet i cili me parë kryhej nëpërmjet KESH.

Shoqëria aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet 6 Njësive Operative (me qendër në Shkodër, Burrel, Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë), Njësia e Mirëmbajtjes së Transmetimit (me qendër në Tiranë) dhe Administrata Qendrore e cila është edhe selia e shoqërisë me adresë Autostrada Tiranë – Durrës, Km 9 Yrshek Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë

të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike. OST, është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Me Vendimin nr. 12 datë 08.09.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., si dhe me Vendimin nr. 130 datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratuan pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar; si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a. .

Në datën 05 Tetor 2020, përfaqësuesit ligjor të OST sh.a. dhe KOSTT sh.a., firmosën Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX.

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX, është regjistruar tashmë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë me NIPT M02223006B. Objektivi kryesor i aktivitetit të shoqërisë është krijimi, menaxhimi dhe administrimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike, nëpërmjet platformës së tregut në bazë të ditës në avancë dhe brenda të njejtës ditë.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të OST sh.a. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë, duke përfshirë edhe ndryshimet gjatë vitit, janë të përfshira në Shënimin 4.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të cilat maten me vlerën e rivlerësuar dhe huave afatgjata të cilat njihen me vlerën e drejtë në momentin fillestar dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.3 Baza e konsolidimit

- **Filialet**

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston atëherë kur Grupi ka fuqinë të drejtojë politikat financiare dhe operationale të një njësie, me qëllim që të përfitojë nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit, merren në konsideratë të drejtat potenciale votuese që janë aktualisht në fuqi. Pasqyrat financiare të

filialeve janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke u bazuar në politika kontabël uniforme për transaksione të ngjashme dhe çështje të tjera në kushte të njëjta.

- ***Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit***

Tepricat brenda grupit, dhe ndonjë shumë e parealizuar e të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet brenda grupit (përveç fitimeve ose humbjeve nga këmbimet në monedha të huaj), janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e parealizuar janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuar, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

2.4 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Standarde dhe interpretime të reja

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Grupit.

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

2.5.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023

Disa standarde të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive nga 1 janari 2023 dhe që janë miratuar, nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Shoqërisë. Për këtë arsye, informacioni shpjegues lidhur me këto Standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Shoqërisë.

Në vitin aktual, Shoqëria ka aplikuar standarde të reja dhe të ndryshuara të kontabilitetit në bazë të SNRF të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BNSK) dhe të miratuara nga Bashkimi Evropian (BE) që kanë hyrë në fuqi dhe janë efektive në politikat kontabël që më 1 janar 2023. Miratimi i tyre nuk ka patur ndonjë ndikim material në përfundimet apo në shumatat e raportuara në këto deklarata financiare.

- **SNRF 17** – Kontratat e Sigurimit (duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17 në qershor 2020 dhe dhjetor 2022). Shoqëria nuk ka asnjë kontratë që përmbush kriteret për tu klasifikuar si një kontratë sigurimi sipas SNRF 17.
- Ndryshimet në **SNK 1** – Paraqitja e Pasqyrave Financiare – Materialiteti - Shoqëria ka adoptuar ndryshimet në SNK 1 për herë të parë në vitin aktual, në lidhje me politikat kontabël, në dhënien e informacioneve shpjeguese. Ndryshimi zëvendëson të gjitha rastet ku përmendet termi “politika të rëndësishme kontabël” me “informacion material të politikave kontabël”. Informacioni i politikave kontabël është material nëse, në rast se shqyrtohet së bashku me informacionet e përfshira në pasqyrat financiare të Shoqërisë, mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme vendimet që përdoruesit primarë të pasqyrave financiare marrin në bazë të këtyre pasqyrave financiare. Paragrafët mbështetës të SNK 1 janë amenduar gjithashtu për të sqaruar se informacioni i politikave kontabël që ka të bëjë me transaksione, ngjarje apo kushte jomateriale nuk duhet të vendosen si informacione shpjeguese. Informacioni i politikave kontabël mund të jetë material për shkak të natyrës së transaksioneve të lidhura, ngjarjeve apo kushteve të tjera, edhe nëse shuma janë jomateriale. Megjithatë, jo të gjitha informacionet e politikave kontabël që kanë të bëjnë me transaksionet materiale, ngjarje apo kushte të tjera janë në vetvete materiale. Adoptimi i këtij ndryshimi nuk ka ndikim material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë.
- Ndryshimet në **SNK 8** – Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet- Shoqëria ka adoptuar ndryshimet në SNK 8 për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet zëvendësojnë përkufizimin e një “ndryshimi në vlerësimet kontabël” me përkufizimin “vlerësimet kontabël”. Sipas përkufizimit të ri, vlerësimet kontabël janë “shuma monetare në pasqyrat financiare që subjekt i pasigurisë së llogaritjes”. Përkufizimi i një ndryshimi në vlerësimet kontabël është fshirë. *Adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë.*
- Ndryshimet në **SNK 12** - Tatimi i shtyrë i lidhur me Aktivet dhe Detyrimet nga një transaksion i vetëm – Shoqëria ka miratuar ndryshimet në SNK 12 për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet paraqesin një përjashtim të mëtejshëm nga përjashtimi fillestar i njohjes. Sipas ndryshimeve, një njësi ekonomike nuk zbaton përjashtimin nga njohja fillestare për transaksionet që sjellin diferenca të barabarta të përkohshme të tatueshme dhe të zbritshme. Në varësi të ligjit

tatimor në fuqi, diferenca të përkohshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme mund të lindin në njohjen fillestare të një aktivi dhe detyrimi në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe nuk ndikon as në fitimin kontabël as fitimin e tatueshëm.

Pas ndryshimeve në SNK 12, një njësie ekonomike kërkohet të njohë aktivin dhe detyrimin tatimor të shtyrë, me njohjen e çdo aktivi tatimor të shtyrë që i nënshtrohet kritereve të rikuperueshmërisë në SNK 12. *Adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë.*

2.5.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Ka një numër standardesh dhe interpretimeve të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Shoqëria planifikon ti aplikojë këto ndryshime në datat kur këto standarde do të jenë efektive.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri janë publikuar, por ende nuk janë efektive :

- Ndryshimi i SNRF 16 – Qiratë
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshime në SNK 1)
- Ndryshimet në SNK 1 – Paraqitja e pasqyrave financiare – Detyrimet afatgjata me premtime kufizuese

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë në periudhën e zbatimit fillestar.

3. Përdorimi i gjykimeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi ka ushtruar gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë prej këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhat e ardhme.

3.1 Gjykimet

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efekte materiale në vlerat e njohura, në pasqyrat financiare të konsoliduara është përfshirë në shënimet si më poshtë :

- Shënimi 4(d)- aktivet afatgjata materiale; zgjedhja e metodës së rivlerësimit;
- Shënimi 4(e)-instrumentat financiare.

3.2 Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimeve

Informacioni rreth supozimeve dhe pasigurive të vlerësimeve që kanë një risk të konsiderueshëm për të sjellë një rregullim material në fund të vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 është përfshirë më poshtë dhe në shënimet vijuese :

- Shënimi 4.k dhe 6.ii - Testi i zhvlerësimit:supozimet kyçe që janë bazë e vlerës së rikuperueshme;
- Shënimi 5: Instrumentat Financiare - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut edhe rritja e riskut të kreditimit;
- Shënimi 6: i Matja e vlerës së drejtë – hierarkia e vlerës së drejtë;
- Shënimi 28: Shpenzimi i tatimit mbi fitimit

Matja e vlerës së drejtë

Një numër politikash kontabël dhe shënimesh shpjeguese të shoqërisë kërkojnë matje sipas vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare.

OST ka bashkëpunuar me vlerësues të pavarur për të përcaktuar matje të vlerës së drejtë, përfshirë vlerën e drejtë të Nivelit 3 për aktivet jo-financiare. Drejtimi vlerëson evidencën e marrë nga palët e treta për të mbështetur përfundimin se këto vlerësime përputhen me kërkesat e SNRF, duke përfshirë edhe nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilin vlerësime të tilla duhen klasifikuar.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë që nuk shiten në një treg aktiv përcaktohet nga teknikat e vlerësimit. Shoqëria përdor gjykimin për të zgjedhur një numër të ndryshëm metodash dhe bën supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet aktuale të tregut në çdo përllogaritje apo datë raportimi. Shoqëria përdor analizën e skontuar të flukseve të parasë për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk shiten në tregjet aktive.

Kur një aktiv ose detyrim matet me vlerën e drejtë, Grupi përdor të dhëna tregu të vëzhgueshme për sa është e mundur. Vlerat e drejta janë të kategorizuara në nivele të ndryshme hierarkie në bazë të të dhënave të përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë:

- **Niveli 1:** çmimi i kuotuar (i pa rregulluar) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta apo identike;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera përveç çmimit të kuotuar të përfshirë në Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme, drejtpërdrejt (p.sh. çmimi) ose indirekt (p.sh. ato që derivojnë nga çmimi) për aktivin ose detyrimin;
- **Niveli 3:** të dhëna për aktivin ose detyrimin të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna tregu të vëzhgueshme (të dhëna të pavëzhgueshme).

Nëse të dhënat e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi janë në nivele të ndryshme hierarkie, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj në nivelin më të ulët hierarkik ku përfshihen të dhënat kryesore që përdoren për matjen e vlerës së drejtë.

Shoqëria i njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

Informacione të mëtejshme për supozimet e bëra në matjen e vlerës së drejtë janë përfshirë në Shënimin 5.

Rritja e konsiderueshme në riskun e kreditit

Siç shpjegohet dhe më poshtë, humbjet e pritshme të kreditit maten si një provizion i barabartë me humbjen e pritshme 12-mujore për instrumentet e fazës 1, ose humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetës për instrumente të fazës 2 ose 3. Një instrument financiar lëviz në fazën 2 kur risku i tij i kreditit është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. SNRF 9 nuk e përcakton çfarë nënkupton një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kreditit.

Për të vlerësuar nëse risku i kreditit të një instrumenti është rritur ndjeshëm apo jo, Shoqëria merr parasysh informacion cilësor dhe sasior të arsyeshëm dhe të parashikuar. Bazuar në vlerësimin e menaxhimit “Qasja e përgjithshme” është aplikuar për llogaritë e arkëtueshme me OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a. .

Duke u bazuar në faktin se OSHEE është një entitet shtetëror, me një mbështetje të madhe nga qeveria shqiptare, vlerësojmë që risku i kreditit të kompanisë është i ndërlidhur pozitivisht me riskun e sovranitetit të Shqipërisë. Përveç kësaj, ne e konsiderojmë qeverinë shqiptare si suportues të OSHEE në rast vështirësie financiare, duke e ulur riskun e kreditit. Qeveria është plotësisht e angazhuar për të përmirësuar efikasitetin, kapacitetin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare.

Më 17 dhjetor 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë miratuan “Planin e masave për uljen e detyrimeve të detyrueshme në sektorin e energjisë elektrike”.

Më 15 prill 2021, ndërmjet OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. është firmosur “Marrëveshja për pagesën e detyrimeve të prapambetura” në shumën 9,687,768,309 leke. Marrëveshja përfshin një skemë pagese duke filluar nga data 1 korrik 2021 për një shumë minimale prej 360 milionë lekë në vit ose 6.5 % të faturave aktuale vjetore, të cilat do të shlyejnë tepricat e mbartura. Bazuar në këtë marrëveshje shumat totale të papaguara nga OSHEE sh.a. kundrejt OST sh.a. do të shlyen deri në vitin 2047.

Ndonëse në balancën e arkëtueshme nga OSHEE përfshihen fatura të cilat janë të pashlyera për një periudhë kohore që tejkalon 90 ditë, e cila përmendet në SNRF 9 si kriter, e cila do ta klasifikonte OSHEE në Fazën 3 dhe do të kërkonte një provigjion 100 % të balancës, ne kemi gjykuar që nuk është mjaftueshëm e arsyeshme për të klasifikuar OSHEE në fazën 3 për shkak të arsyeve :

- për shkak të industrisë në të cilën OST dhe OSHEE operojnë;
- për shkak të marrëveshjes në fuqi midis palëve për pagesën me këste për të gjithë balancën.
- shumat e faturuara nga ana e OST sh.a. kundrejt OSHEE sh.a. për tregtimin e energjisë për periudhat aktuale shlyen në kohë.

Duke marrë në konsideratë sa më lart, kriteret e mospagimit do të ndodhnin vetëm nëse politika e qeverisë do të duhej të hiqte dorë nga këto borxhe dhe do t’i kërkonte OST të ruante humbjen e saj. Prandaj, teprica e papaguar nga OSHEE lidhur me llogaritë rrjedhëse është klasifikuar në Fazën 1. Megjithatë, duke qenë se kushtet e kontratës (kushti për marrjen e një minimumi prej 360 milionë lekë në vit) nuk u plotësua deri më dhjetor 2023, balanca e papaguar sipas marrëveshjes është klasifikuar në Fazën 2 sipas SNRF 9 dhe janë llogaritur humbjet e pritshme të kredisë gjatë jetës së aktivitetit.

Sipas klasifikimit të riskut të kreditit të KESH-it, (megjithëse ka një balancë të prapambetur që tejkalon periudhën prej 90 ditë) ne kemi konsideruar të klasifikohet në Fazën 1 për arsyet e mëposhtme:

- KESH është një entitet shtetëror dhe garantues i saj është qeveria shqiptare;
- Nuk është e mundur që KESH të hyjë në falimentim;
- Nga qeveria shqiptare është zbatuar “Plani i masave për uljen e detyrimeve në sektorin e energjisë elektrike”.

Gjithashtu, më datë 05.10.2021 ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a. është firmosur “Marrëveshja për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” sipas së cilës detyrimi i OST sh.a. do të shlyet deri më korrik 2026 sipas një skeduli të përcaktuar në këtë marrëveshje. Për këtë detyrim do të zbatohet e njëjta qasje si ajo e marrëveshjes me OSHEE ku balanca do të matet me koston e amortizuar.

Klasifikimi në fazën 2 për KESH do të ishte i aplikueshëm në rast se:

- Çdo ent në pronësi të qeverisë mund të falimentojë;
- do të pritej një ndryshim i konsiderueshëm në rezultatet operative të KESH si rënie e të ardhurave dhe marzheve të fitimit për shkak të :
 - uljes së përgjithshme të konsumit të energjisë në vend;
 - në rast se performanca financiare e njëjësive do të përkeqësohet për shkak të faktorëve të ndryshëm nga moti.

Klasifikimi në fazën 3 do të ishte i aplikueshëm në rast se:

- do të kishte plane për OSHEE dhe KESH për t’u dhënë me koncesion;
- ose nëse OSHEE/KESH do të rrezikonin të falimentonin për shkak të vështirësive financiare të mëdha.

Llogaritja e provizionit

Gjatë matjes së humbjes së pritshme të kredisë, Shoqëria përdor informacion të arsyeshëm dhe të parashikuar, i cili bazohet në supozimet për lëvizjet e ardhshme të faktorëve të ndryshëm nxitës ekonomikë dhe se si këto faktorë do të ndikojnë tek njëri-tjetri.

Humbja nga mos shlyerja është një vlerësim i humbjes që vjen nga mospagimi, duke u bazuar në diferencën midis fluksit monetar kontraktual që paguhet dhe asaj që pritet të merret. Implementimi i “Qasjes së thjeshtuar” është përdorur për aktivet financiare dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera. Analiza e vjetërsisë nuk është kryer e ndarë në 1-30 ditë, 30-60 ditë, 69-90 ditë edhe më shumë se 90 ditë, prandaj janë identifikuar vetëm gjendjet që nuk janë paguar për më shumë se 365 ditë.

Në shumicën e rasteve, këto balanca përbëhen nga klientët që janë në një proces gjyqësor me Shoqërinë. Në lidhje me aktivet financiare, këto balanca përfshijnë kreditë e dhëna drejt punonjësve. Prandaj, Menaxhimi ka parë të arsyeshme të aplikojë një normë të humbjes prej 100 % për të gjitha balancat e papaguara mbi 365 ditë. Ndërkohë që, duke u bazuar në një normë të humbjes së kreditit historik, një normë prej 1.16 % është aplikuar në balancat që janë nën 365 ditë pa paguar.

Humbja e pritshme e kredisë llogaritet veçmas për të arkëtueshmet tregtare nga klientët dhe debitorët e tjerë me një normë të humbjes së kreditit 6.6 %, më 31 dhjetor 2023. (2022: 8.64%)

Mundësia e mosshlyerjes përbën një faktor kyç në matjen e humbjes së pritshme të kreditit. Mundësia e mosshlyerjes është një vlerësim i mundshëm i mospagesës në një periudhë të caktuar kohor, llogaritja e të cilës përfshin të dhëna historike, supozime dhe pritshmëri për kushtet e ardhshme.

Nëse normat e humbjes së pritshme të kreditit mbi llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme me më pak se 365 ditë vonesë, do të kishin qenë 1 % më të larta (apo më të ulta) më 31 dhjetor 2023, provizioni i llogarive të arkëtueshme do të rritej/(ulej) me 11,218,438 Lekë (2022: 14,127,270 Lekë).

SNRF 9 gjithashtu kërkon një qasje të thjeshtuar për matjen e provizionit, në shumë të barabartë përgjatë gjithë jetës së llogarive të arkëtueshme dhe të tjera, si dhe aktiveve financiare. Impakti në aktivet financiare, si dhe në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre është jomaterial, ndaj Shoqëria ka vendosur të mos i përfshijë në pasqyrat financiare që lidhen me këto zëra.

4. Politika të rëndësishme kontabël

OST sh.a. ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

a) *Transaksionet në monedhë të huaj*

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kosos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kosos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike, konvertohen me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë, konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë.

b) *Inventari*

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kosos dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e kosos specifike për secilin artikull

dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së tyre në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur kostot e vlerësuara të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

c) **Aktivet afatgjata jo-materiale**

Aktivet afatgjata jo-materiale të blera nga Grupi, janë paraqitur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar të rënies në vlerë. Shpenzimet e mëpasshme të aktiveve afatgjata jo-materiale kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të aktiveve specifike me të cilat lidhen.

Të gjitha shpenzimet e tjera regjistrohen në momentin që ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktiveve. Jeta e dobishme e vlerësuar është 5 vite.

d) **Aktivet afatgjata materiale**

- Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar janë paraqitur me vlerën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit së cilës i zbritet amortizimi i akumuluar dhe çdo humbje pasardhëse e akumuluar nga rënia e vlerës.

Rivlerësimet janë kryer me rregullsi të mjaftueshme, të tillë që vlerat kontabël nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato që do të përcaktoheshin duke përdorur vlerën e drejtë në fund të çdo periudhe raportimi.

Çdo tepricë nga rivlerësimi njihet në të Ardhurat e tjera Gjithëpërfshirëse ('ATGj'), me përjashtim të masës në të cilën teprica anullon rëniet në vlerë të mëparshme të rivlerësimit të të njëjtit aktiv, rast në të cilin kreditimi njihet në fitim ose humbje.

Çdo rënie në vlerë nga rivlerësimi njihet në fitim ose humbje, me përjashtim të masës që kjo anullon një tepricë të mëparshme të rivlerësimit të të njëjtit aktiv, rast në të cilin debitimi njihet në ATGj. Për këtë arsye, tepricat dhe rëniet në vlerë nuk mund të netohen edhe brenda të njëjtës klasë aktivesh. Rezerva e rivlerësimit transferohet tek fitimet e mbartura përgjatë përdorimit të aktivit.

Nëse pjesë të konsiderueshme të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë ato njihen si aktive të ndara më vete (komponentë kryesore) në aktivet afatgjata materiale.

Ndërtimet në proces mbahen me kosto, pakësuar me humbjet e njohura nga zhvlerësimi (nëse ka) dhe klasifikohen në kategoritë e duhura të aktiveve afatgjata materiale kur përfundohen dhe janë të gatshme për përdorim. Kosto përfshin të gjithë shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me përfitimin e aktivit. Këto shpenzime

përfshijnë tarifatat profesionale, dhe për aktivet e kualifikuara kostot e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikatat kontabël të shoqërisë.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material, njihet në fitim ose humbje.

- Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohen nëse pritet që Grupi të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga këto shpenzime.

- Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet për të anuluar shumatat e rivlerësuara të aktiveve afatgjata materiale duke i zbritur vlerën e mbetur sipas metodës lineare të amortizimit, përgjatë jetës së dobishme dhe njihet në fitim ose humbje.

Jetët e dobishme të aktiveve afatgjata materiale për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si më poshtë:

	2023	2022
Përmirësimet e tokës dhe ndërtesat	7 - 65	5 - 65
Instalime teknike, pajisje dhe makineri	5 - 58	3 - 55
Mjete transporti	3 - 14	4 - 14
Pajisje zyre dhe informatike	5 - 15	5 - 15

Toka dhe ndërtimet në proces nuk amortizohen.

Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

Grupi bazuar në kërkesat e SNRF 13 “Matja me vlerën e drejtë” ka kryer testin e zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale. Testi i zhvlerësimit për aktivet afatgjata materiale është në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 36 “Zhvlerësimi i aktiveve”. Në bazë të llogaritjeve përkatëse, vlera e rikuperueshme (vlera në përdorim) e aktiveve fikse të OST që rezultoi më 31.12.2022, është më e ulët se vlera kontabël, duke treguar kështu një zhvlerësim në shumën 4,650 milionë lekë (shënimi 6 dhe shënimi 7).

e) **Instrumentet financiarë**

- *Aktive financiare joderivative*

OST sh.a. fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen. Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

OST ç'registron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktiviteti financiar në një transaksion në të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit financiar transferohen. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare netohen dhe paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Grupi ka një të drejtë ligjore për të netuar shumatat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

- *Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Aktive, të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Grupi gjithmonë mat provizionin për llogaritë e arkëtueshme në shumë të barabartë me humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetëgjatësisë. Humbjet e pritshme për llogaritë e arkëtueshme përlllogariten duke përdorur një matricë provizioni me referencë nga eksperiencia e kaluar e mosshlyerjes nga ana e klientit dhe nga një analizë e pozicionit aktual financiar të tij, e rregulluar për faktorë që janë specifikë për klientin, kushtet ekonomike të përgjithshme të industrisë në të cilën klientët operojnë dhe një vlerësim i rrjedhës së parashikuar dhe aktuale të kushteve në datën e raportimit.

Shoqëria ka njohur një provizion 100 % kundrejt të gjitha llogarive të arkëtueshme mbi 365 ditë vonesë, sepse eksperiencia historike ka treguar se këto llogari janë përgjithësisht të parekuperueshme ndërsa për llogaritë e arkëtueshme me më pak se 365 ditë vonesë është përdorur normë humbje 6.6 %.

Shoqëria e anulon një llogari të arkëtueshme kur ka informacion që tregon se klienti është në vështirësi financiare dhe nuk ka një perspektivë realiste të rimëkëmbjes, p.sh. kur klienti është në proces likuidimi ose ka hyrë në procedura të falimentimit, ose kur një llogari e arkëtueshme është mbi dy vjet e pashlyer, cilado që të ndodhë më herët.

- *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalente e tyre përfshijnë mjetet monetare gjendje si dhe depozitat me afat fillestar maturimi jo më të madh se tre muaj. Llogaritë debitore bankare që përbëjnë një pjesë të menaxhimit të mjeteve monetare të shoqërisë, përfshihen në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në pasqyrën e flukseve monetare.

- *Detyrimet financiare joderivative*

Grupi fillimisht i njeh detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Grupi e ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyen ose anulohen apo përfundojnë. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare joderivative të shoqërisë janë si vijojnë; hua dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin.

Për huatë e marra drejtpërdrejt nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit, norma e tregut përcaktohet duke u nisur nga perspektiva e bankave të zhvillimit dhe përgjithësisht është e barabartë me normën e kontratës, për shkak se bankat e zhvillimit përbëjnë tregun për shoqërinë.

Për fondet e financuara fillimisht nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit dhe më pas të nën-huazuara tek OST sh.a. nga Qeveria apo KESH, norma e tregut fillimisht është përcaktuar duke iu referuar normave të ofruara nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit, me diferencën midis vlerës së drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit, të konsideruar si kontribut nga aksionari dhe të kontabilizuar si rezervë rivlerësimi në kapital.

Për huamarrje të tilla, përdoret gjykimi i menaxhimit në përcaktimin se Qeveria apo KESH janë duke vepruar në cilësinë e aksionarit kur nën-huazojnë fondet për OST sh.a. .

Pas njohjes fillestare këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

f) ***Kostot e huamarrjes***

Grupi kapitalizon kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar si pjesë e koston së atij aktivi.

g) **Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Grupi ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi i zbritjes në kohë njihet si kosto financiare.

h) **Grantet**

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Grupi do të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur atyre. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

i) **Kapitali aksionar dhe dividendët**

• **Kapitali aksionar**

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

• **Dividendët**

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionari i OST sh.a. .

j) **Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësimin e tyre. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivitetet që nuk mund të testohen individualisht janë grupuar bashkë në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse hyrëse të

parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesisht të pavaruara nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve (njësia e gjenerimit të parasë ose 'NJGJP').

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e NJGJP-së së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NJGJP-të shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (grupin e njësive) në mënyrë përpjestimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritej amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

k) *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Modeli i zhvlerësimit në SNRF 9 bazohet në modelin e humbjeve të pritshme ("ECL") dhe zëvendëson modelin e humbjeve të pësuar të SNK 39, duke rezultuar në njohjen e një provigjioni humbjesh përpara se të ndodhë humbja e kredisë. Sipas kësaj qasje, Shoqëria merr në konsideratë kushtet aktuale dhe informacionin e arsyeshëm që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme gjatë vlerësimit të humbjeve të pritura të kredisë. SNRF 9 përcakton një "Qasje të përgjithshme" për zhvlerësimin. Modeli ECL zbatohet për instrumentet financiare të regjistruara me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Parimi udhëzues i modelit ECL është të pasqyrojë modelin e përgjithshëm të përkeqësimit, ose përmirësimit, në cilësinë e kredisë së instrumenteve financiare. Një aktiv financiar i mbajtur jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse të dhëna objektive tregojnë se ka ndodhur një ngjarje e cila ka sjellë humbje pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka pasur efekt negativ mbi flukset monetare të parashikuara nga ai aktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme.

Qasja e përgjithshme

Bazuar në "Qasje-n e përgjithshme", një provizion për humbjet e pritshme të kredisë njihet për një instrument financiar nëse ka patur një rritje të konsiderueshme të riskut të kredisë (e matur duke përdorur probabilitetin jetëgjatë të falimentimit) që

nga njohja fillestare e aktivitetit financiar. Nëse në datën e raportimit, risku i kredisë për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, atëherë njihet një provigjion për humbjet e pritura 12 mujore të kredisë.

Me fjalë të tjera, “Qasja e përgjithshme” ka dy baza për të matur humbjet e pritura të kredisë :

- a) Humbja e pritur 12 mujore e kredisë është pjesa e humbjeve të pritura të kredisë gjatë gjithë jetës që paraqesin humbjet e pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e falimentimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.
- b) Humbjet e pritura gjatë gjithë jetës është humbja e pritur e kredisë që rezulton nga të gjitha ngjarjet e mundshme të falimentimit gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

Në përcaktimin e zhvlerësimit sipas “Qasjes së thjeshtuar”, Shoqëria përdor humbjen historike të probabilitetit të mospagimit, kohën e arkëtimit dhe shumën e humbjes së shkaktuar. Kjo normë më pas korrigjohet sipas gjykimit të drejtuesve, nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredidhënies, janë të tilla që, humbjet aktuale ka të ngjarë të jenë më të mëdha ose më të vogla se sa sugjerohet nga tendencat historike.

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari provizioni që pakëson llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme sjell zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim rimerret në fitim humbje.

l) *Njohja e të ardhurave*

Kompania është e përfshirë në transmetimin e energjisë, si dhe kryerjen e shërbimeve të lidhura. Të ardhurat nga shërbimet e transmetimit njihen kur transmetimi i energjisë ndodh, bazuar në sasinë e vërtetë të energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes, matur në pikën e shpërndarjes.

Të ardhurat përfaqësojnë vlerën fikse ose të përcaktueshme të çfarë është marrë në këmbim ose është e arkëtueshme. Të ardhurat njihen me shumën e faturuara për konsumatorët dhe përjashtojnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, zbritjet dhe skontimet.

m) *Të ardhura dhe shpenzime financiare*

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e investuara dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje kur maturohen, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen mbi bazë neto. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi kreditë. Kostot e huave që nuk janë direkt të lidhura me

blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv.

n) **Tatim mbi fitim**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përveç rasteve kur lidhen me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi mbi fitimin e periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose arkëtuar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, dhe që nuk ndikon fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Grupi pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyer vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që priten të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës në baza neto, ose aktivet dhe pasivet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Taksat e tjera që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Grupi, njihen në të njëjtën kohë si detyrimi për të paguar dividendin e lidhur me të.

Një aktiv tatimor i shtyrë për humbje tatimore të papërdorura, njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

o) **Qiratë**

Qiratë 'kapitalizohen' duke njohur vlerën aktuale të pagesave të qirasë dhe duke i paraqitur ato ose si aktive qiraje (aktive me të drejtë përdorimi). Nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, një kompani njih gjatë një detyrim financiar që përfaqëson detyrimin e saj për të bërë pagesat e qirasë në të ardhmen.

SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e qirasë operative lineare për ato qira që zbatojnë SNK 17 me një tarifë amortizimi për aktivin e qirasë (të përfshirë në kostot e funksionimit) dhe një shpenzim interesi mbi pasivin e qirasë (përfshirë në kostot financiare).

Duke zbatuar SNRF 16, një kompanie i kërkohet që: (a) të njohë aktivet dhe detyrimet e qirasë në bilanc, të matura fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të qirasë të pashmangshme; (b) njohin zhvlerësimin e aktiveve të qirasë dhe interesin mbi detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së qirasë; dhe (c) të ndajë shumën totale të mjeteve monetare të paguara në një pjesë të principalit (të paraqitur në kuadër të aktiviteteve financiare) dhe interesit (zakonisht të paraqitur në kuadër të aktiviteteve operative ose financiare) në pasqyrën e fluksit monetar.

SNRF 16 nuk kërkon që qiramarrësi të njohë aktivet dhe detyrimet për (a) qiratë afatshkurtra (d.m.th. qiratë prej 12 muajsh ose më pak) dhe (b) qiratë e aktiveve me vlerë të ulët (për shembull, një qira e një kompjuteri personal).

p) **Përfitimet e punonjësve**

- Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Grupi është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga Qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

- Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Grupi është i angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur njih kosto rishtrukturuimi. Nëse përfitimet nuk priten të zgjidhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontojnë.

q) **Çështjet që lidhen me klimën**

Rreziku i krijuar nga ndryshimet e klimës mund të ketë ndikim në pasqyrat financiare të shoqërisë. Këto rreziqe përfshijnë ndikimin në vjetërsim më të shpejtë sesa koha e pritshme në vlerën e mbetur të asetëve. Çështjet e lidhura me klimën mund të shkaktojnë indikacione se një aktiv (ose një grup asetesh) është zhvlerësuar. Shoqëria do të marrë parasysh nëse çështjet e lidhura me klimën kanë një ndikim në planet e

biznesit dhe supozimet financiare dhe operacionale të përdorura lidhur me vlerën në përdorim gjatë përcaktimit të shumës së rikuperueshme (p.sh. në ndikimin e saj tek norma e skontimit, norma e rritjes afatgjatë etj).

Këto çështje, mund të kenë efekt në kontratat e qirasë duke qenë se aktivi i marrë me qera mund të ekspozohet nga kushtet atmosferike duke bërë që shoqëria të rinegociojnë afatin e qirasë dhe të bëjë rimatjen e aktivitetit të qirasë dhe detyrimit të qirasë.

Gjithashtu, çështjet klimatike mund të ndikojnë në ekspozimin e një njësie ekonomike ndaj humbjeve të kredisë (p.sh. nëse biznesi i kreditorit preket negativisht nga rregulloret e reja mjedisore, ose nëse ka pësuar dëme fizike në aktivitetet e saj kryesore) dhe rrjedhimisht matjen e ECL.

Këto çështje, mund të kenë impakt negativ në fitimet e ardhshme të tatueshme mbi të cilat bazohet njohja e aktiveve tatimore të shtyra. Pritet që plani i biznesit i përdorur për njohjen e aktiveve tatimore të shtyra të bazohet në të njëjtat supozime të përdorura gjatë vlerësimit të shumës së rikuperueshme të aktiveve afatgjata.

Çështjet e lidhura me klimën mund të reflektojnë në njohjen dhe matjen e provizioneve për shkak të një përshpejtimi të ndryshimeve klimatike dhe nevojës për të ndërmarrë disa masa mjedisore më shpejt, lidhur me kontratat të cilat ndikohen nga ndryshimet klimatike dhe mund të ulin potencialisht të ardhurat e njëjësive dhe/ose të rrisin shpenzimet e saj operative. Rreziqet shtesë ndaj të cilave një njësi ekonomike është e ekspozuar për shkak të vendndodhjes ose aktivitetëve të saj, mund të shkaktojnë gjithashtu detyrime të reja.

Drejtimi vlerëson vazhdimisht ndikimin e çështjeve të lidhura me klimën në aktivitetin e shoqërisë.

Supozimet mund të ndryshojnë në të ardhmen në përgjigje të rregulloreve të ardhshme mjedisore dhe rregullatore, si edhe angazhimeve të reja të marra.

5. Instrumentet financiarë - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut

5.1 Klasifikimet kontabël dhe vlera e drejtë

OST nuk ka paraqitur vlerat e drejta të aktiveve financiare të tilla si të arkëtueshme dhe të pagueshme tregtare afatshkurtër, sepse vlera e tyre kontabël është një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë.


5.1.1 Aktive financiare që nuk maten me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve, të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera të arkëtueshme vlerësohet të jetë e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qenë se janë instrumente afatshkurtër ose që nuk mbartin interes.

5.1.2 Detyrimet financiare që nuk maten me vlerë të drejtë

OST është palë në kontrata për hua afatgjata dhe drejtimi ka kryer analiza për të përcaktuar vlerën e tyre të drejtë.

Tabela e mëposhtme tregon vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të huave në 31 dhjetor 2023 dhe 2022:



Më 31 dhjetor 2023		Më 31 dhjetor 2022	
Vlera kontabël	Vlera e drejtë	Vlera kontabël	Vlera e drejtë
25,042,193,895	24,883,109,887	28,561,472,063	28,408,772,096

Vlera e drejtë është vlerësuar si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën e interesit të huave të ngjashme në datën e raportimit. Normat e interesit të përdorura për të skontuar flukset e ardhshme më 31 dhjetor 2023 janë në intervalin prej 0.84 % deri në 5.38 % (2022: 0.84 % deri 5.38 %) dhe janë përcaktuar duke përdorur perspektivën e bankave të zhvillimit.

Normat e tregut në datat e raportimit që janë përdorur në llogaritje, janë përcaktuar duke u bazuar në normat e ofruara nga bankat e zhvillimit. Drejtimi arriti në përfundimin se nuk ka në dispozicion të dhëna publike për tregun që mund të përdoren pa rregullime të rëndësishme në përcaktimin e vlerave të duhura të drejta të huave afatgjata.

Një numër rreziqesh dhe rrethanash ndikojnë në përcaktimin e vlerave të drejta të këtyre instrumenteve financiare, duke përfshirë shumën e instrumentit financiar, maturitetin, klasifikimin e kredive, llojin e interesit, monedhës, qëllimin e kredisë, garancive, mjedisin ekonomik në të cilin palët e instrumentave financiarë veprojnë, dhe vet riskut të mos performimit.

Për shkak të mungesës së të dhënave të drejtpërdrejta të vëzhgueshme të tregut në lidhje me rreziqet dhe rrethanat e këtyre instrumenteve financiare, vlera e drejtë e paraqitur më lart mund të konsiderohet vetëm si e përafërt e arsyeshme për vlerën e drejtë dhe për të përmbushur kriteret për klasifikim në nivelin e tretë të hierarkisë së vlerës së drejtë. Edhe pse Grupi konsideron se vlerat e drejta të vlerësuara janë të sakta, përdorimi i metodologjive dhe supozime të ndryshme mund të rezultojë në vlera të drejta të ndryshme.

5.2 Menaxhimi i riskut financiar

Grupi është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme që vijnë prej aktiveve dhe detyrimeve financiare:

- Risku i kreditimit
- Risku i tregut
- Risku i likuiditetit

Funksioni i menaxhimit të riskut brenda shoqërisë kryhet duke marrë në konsideratë risqet financiare (të kredisë, tregut, monedhës, likuiditetit dhe normës së interesit), risqet operationale dhe risqet ligjore. Objektivi kryesor i funksionit të menaxhimit të riskut financiar është të vendosë limite risku, dhe më tej të sigurohet se ekspozimi ndaj risqeve mbahet brenda këtyre limiteve. Funksionet e riskut operacional dhe ligjor janë parashikuar të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar risqet operationale dhe ligjore. Grupi operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike me zhvillime dinamike.

Përshtjellimi i mëtejshëm i saj mund të ketë impakt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë. Drejtimi kryen monitorime të rregullta mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe zhvillimeve të tregjeve ndërkombëtare. Bazuar në këtë, drejtimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe kërkon të implementojë masat e duhura në lidhje me riskun e kreditimit, riskun e tregut (kryesisht të normës së interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke limituar kështu efektet e mundshme negative. Për më tepër, OST është financuar nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit apo nën-huazuar nga Qeveria ose palët e lidhura (si KESH). Në këtë mënyrë, OST i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut duke ruajtur pozicione të qëndrueshme kapitali.

5.2.1 Risku i kreditimit

Grupi ekspozohet ndaj riskut të kreditimit, i cili është risku që njëra nga palët në një aktiv financiar të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Ekspozimi kryesor i shoqërisë ndaj riskut të kreditimit lind për shkak të të arkëtueshmeve financiare, tregtare dhe të tjera.

Maksimumi i ekspozimit të OST ndaj riskut të kredisë për kategori të aktiveve financiare dhe për kundërparti, përpara kolateraleve dhe shtesave të tjera është si vijon :

Risku i kredisë	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Mjete monetare në bankë	5,116,917,526	4,706,171,573
Llogari të arkëtueshme		
Shoqëri private	1,185,028,296	1,527,781,540
Shoqëri të zotëruara nga shteti	18,332,239,426	17,690,290,963
Hua dhe llogari të arkëtueshme	32,197,508	32,287,508
Llogari të arkëtueshme nga personeli	409,080	4,458,779
Parapagime për furnitorë	1,480,786,281	1,564,988,039
Tvsh e arkëtueshme	86,057,567	296,948,239
Të tjera	133,711,132	1,655,033,248
Ekspozimi total ndaj riskut të kredisë	26,367,346,816	27,477,959,889

- Menaxhimi i riskut të kreditimit

Grupi ekspozohet ndaj riskut të kreditimit në aktivitetet e tij të përditshme, sepse mundet që klientët e tij të dështojnë në plotësimin e detyrimeve financiare. OST strukturon nivelet e riskut të kreditimit që merr përsipër duke vendosur limite ndaj shumave të pranuar të riskut në lidhje me kundërpartitë. Limitet në nivel të riskut të kreditimit aprovohen rregullisht nga drejtimi. Këto risqe monitorohen mbi baza përsëritëse dhe janë subjekt i rishikimeve vjetore apo edhe më të shpeshta.

- Përqëndrimi i riskut të kreditimit

OST ekspozohet ndaj përqëndrimit të riskut të kreditimit. Drejtimi monitoron përqëndrimin e riskut të kreditimit por përballet me vështirësi në aplikimin e praktikave më të mira të politikave të menaxhimit përkundrejt ekspozimit të Shoqërisë ndaj këtij risku. Përqëndrimi kryesor ka të bëjë me OSHEE Sh.a. . Në këto kushte, masat e diversifikimit janë të vështira të aplikohen. Më 31 dhjetor 2023, balancat e arkëtueshme nga OSHEE Sh.a. përfaqësojnë 69 % të ekspozimit maksimal total ndaj riskut të kreditimit (2022: 64 %).

Depozitat bankare të shoqërisë mbahen në tetë banka në vend (2022: tetë banka në vend).

- Të arkëtueshmet e zhvlerësuara

Të arkëtueshmet për të cilat Grupi përcakton se është e mundshme që nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumat përkatëse në përputhje me termat kontraktuale të marrëveshjes/(ve) zhvlerësohen.

Të arkëtueshmet në vonesë por të pa zhvlerësuara më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, lidhen kryesisht me shumën të arkëtueshme nga OSHEE, një entitet i kontrolluar nga qeveria shqiptare, për shitjet e bëra në 2019 dhe vitet paraardhëse.

Lëvizjet në zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme janë paraqitur më poshtë:

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Gjendja më 1 janar	794,676,382	921,095,715
Write off i aktivitetit financiar më 31 dhjetor		(3,121,332)
Humbje nga zhvlerësimi më 31 dhjetor	121,421,566	(123,298,001)
Gjendja më 31 dhjetor	916,097,948	794,676,382

OST sh.a. ka llogaritur një total provigjonesh prej 3,121,332 lekë në 31 dhjetor 2015 dhe 2016.

Sipas SNRF 9 – Ç’regjistrimi i aktiveve financiare, një njësi ekonomike do të ç’regjistrojë një aktiv financiar, kur dhe vetëm kur :

- a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar, ose
- b) transferon aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për ç’regjistrim

Në lidhje me këto aktive financiare, asnjë fluks monetar nuk është marrë deri më 31 dhjetor 2022 dhe nuk priten pagesa as në të ardhmen dhe për këto arsye këto të drejta janë ç’regjistruar (fshirë) nga bilanci kontabël.

Tabela në vijim paraqet profilin e rrezikut të llogarisë së arkëtueshme dhe të tjera, bazuar në matricën e provizionit të Shoqërisë.

Duke qenë se eksperiencia historike e humbjes për Shoqërinë nuk tregon modele humbjeje të konsiderueshme për segmente të ndryshme të klientëve, provizioni që bazohet në statusin me vonesë nuk bën një dallim midis bazës së ndryshme të klientëve të Shoqërisë për entitetet private.

Në lidhje me gjendjet e OSHEE dhe KESH vlerësimi ka qenë individual.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2023 (përfshirë OSHEE-në dhe KESH-in)

Përcaktoni humbjen e pritshme	Më pak se 365 ditë me vonesë	Më shumë se 365 ditë me vonesë
Shumat e pa paguara në ditën e raportimit	1,106,757,583	3,226,718
Norma e humbjes së pritshme të kreditit	6.64%	100%
Provizioni i humbjes së pritshme të kreditit	73,488,704	3,226,718

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2022 (përfashtuar OSHEE-në dhe KESH-in)

Përcaktoni humbjen e pritshme të kreditit	Më pak se 365 ditë me vonesë	Më shumë se 365 ditë me vonesë
Shumat e papaguara në ditën e raportimit	1,409,246,632	2,839,916
Norma e humbjes së pritshme të kreditit	8.64%	100%
Provizioni i humbjes së pritshme të kreditit	121,758,909	2,839,916

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2023 për OSHEE-në dhe KESH-in

EAD në monedhë vendase	Humbja e pritshme (12 muaj) në monedhë vendase
135,817,059	1,661,725
10,147,222,323	124,151,488
TOTALI	125,813,213

EAD në monedhë vendase	Humbja e pritshme (12 muaj) në monedhë vendase
8,909,229,200	528,063,585
TOTALI	528,063,585

EAD në monedhë vendase	Humbja e pritshme (12 muaj) në monedhë vendase
73,069,514	73,069,514
TOTALI	73,069,514

EAD në monedhë vendase	Humbja e pritshme (12 muaj) në monedhë vendase
123,455,688	1,412,763
10,678,632,160	122,200,773
TOTALI	123,613,536

EAD në monedhë vendase	Humbja e pritshme (12 muaj) në monedhë vendase
9,329,229,200	434,086,714
TOTALI	434,086,714

- Politika e fshirjes

OST fshin balancat e të arkëtueshmeve (dhe çdo fond lidhur me humbje nga zhvlerësimi) kur drejtimi vendos se të arkëtueshmet janë të pambledhshme. Ky vendim arrihet pasi konsiderohen informacione të tilla si masat domethënëse që janë ndërmarrë për rikuperimin e shumës, dhe se nuk ka mundësi të tjera për mbledhjen e balancave të papaguara.

- Kolaterali

Përgjithësisht nuk mbahet kolateral ndaj të arkëtueshmeve dhe më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 nuk është mbajtur ndonjë kolateral i tillë.

5.2.2 Risku i tregut

Risku i tregut është risku nga humbja që rezulton prej ndryshimeve në çmimet e tregut të brendshëm, kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Niveli i riskut të tregut ndaj të cilit ekspozohet Grupi në një moment të caktuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive për çmimet e ardhshme ose ndryshimet në normat e tregut dhe përbërjen e aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave.

Drejtimi cakton limite mbi vlerat e riskut që mund të pranohen, të cilat monitorohen mbi baza mujore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre limiteve në rast të ndryshimeve më të rëndësishme të tregut.

- Risku i kursit të këmbimit

Risku i kursit të këmbimit rrjedh prej faktit që të ardhurat e shoqërisë dhe pjesa më e madhe e të arkëtueshmeve janë të shprehura në LEK, ndërsa pjesa më e madhe e huave të OST janë shprehur në monedhë të huaj (përfshirë EUR, USD, CHF, YEN dhe KRW). Risku është që vlera e flukseve të parasë në monedhë funksionale që lind prej ripagimit të huave dhe interesave respektivë do të ndryshojë si rezultat i lëvizjeve në kurset e këmbimit, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë domethënëse fitimet e shoqërisë.


Në lidhje me riskun e kursit të këmbimit, drejtimi vendos limite mbi nivelin e ekspozimit për monedhë dhe në total.

Tabela më poshtë përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare dhe përmbledh ekspozimin e OST ndaj kurseve të këmbimit në datën e raportimit :

	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
€	2,733,987,893	(20,858955,694)	(18,124,967,801)
\$	627,747	(2,964,045,435)	(2,963,417,688)
¥	-	(2,554,644,519)	(2,554,644,519)
F	-	(1,013,699,703)	(1,013,699,703)
¥	-	(404,063,905)	(404,063,905)
TOTALI	2,734,615,640	(27,795,409,256)	(25,060,793,616)

	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
€	2,265,994,261	(23,984,464,536)	(21,718,470,275)
\$	1,219,719	(3,127,263,261)	(3,126,043,542)
¥	-	(2,565,613,391)	(2,565,613,391)
F	-	(1,037,216,412)	(1,037,216,412)
¥	-	(488,425,242)	(488,425,242)
TOTALI	2,267,213,980	(31,202,982,842)	(28,935,768,862)

Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë si vijon :



Menaxhimi i riskut të kurseve të këmbimit plotësohet përmes monitorimit të ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë ndaj skenarëve të ndryshëm standarde dhe jo standarde të kurseve të këmbimit. Skenarët standardë që konsiderohen në mënyrë të rregullt përfshijnë një rritje ose rënie paralele në kurset e këmbimit prej 100 pikësh bazë (pb).

Një analizë e ndjeshmërisë së shoqërisë ndaj një rritjeje ose rënieje në vlerën e lekut përkundrejt monedhave të huaja (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike dhe një pozicion financiar të qëndrueshëm) është si vijon:

	2023		2022	
	100 bp	100 bp	100 bp	100 bp
	Rritje	Ulje	Rritje	Ulje
Efeksi i parashikuar në fitim / (humbje)	(250,607,936)	250,607,936	(289,468,296)	289,468,296

- *Risku i normës së interesit*

OST ekspozohet ndaj riskut të normave të interesit sepse vlera e drejtë e huave me normë fikse dhe flukset e parasë të lidhura me huatë me norma të ndryshueshme do të variojnë me ndryshimin e normave të interesit. Shënimi 15 detajon normat e interesit mbi huatë e OST.

Tabela paraqet shumat e agreguara të aktiveve dhe detyrimeve financiare me vlerë kontabël, të kategorizuara sipas afatit më të hershëm midis riçimit të interesit kontraktual dhe datës së maturitetit.

Në LEK	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Detyrimet më 31 dhjetor 2023				
Llogari të pageshme e të tjera	17,938,117,616	1,800,000,000	6,629,229,200	26,367,346,816
Kredi dhe hua	(26,845,131,261)	(5,013,037,327)	(7,458,207,191)	(39,316,375,779)
Totali i pagesave të ardhshme	(8,907,013,646)	(3,213,037,327)	(828,977,991)	(12,949,028,964)
Detyrimet më 31 dhjetor 2022				
Llogari të pageshme e të tjera	18,690,191,579	1,800,000,000	6,987,768,309	27,477,959,888
Kredi dhe hua	(25,102,463,736)	(7,296,816,818)	(9,538,352,073)	(41,937,632,627)
Totali i pagesave të ardhshme	(6,412,272,157)	(5,496,816,818)	(2,550,583,764)	(14,459,672,739)

Menaxhimi i riskut të normës së interesit kundrejt limiteve të hendekut të normës së interesit plotësohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aseteve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë kundrejt skenarëve standarde dhe jo-standarde të normës së interesit. Skenarët standardë që konsiderohen në bazë të rregullt përfshijnë një rritje ose ulje paralele prej 100 pikësh bazë në të gjitha kurbat e interesit.

Një analizë e ndjeshmërisë së shoqërisë përballë një rritjeje ose një rënijeje në normat e interesit (duke supozuar që nuk do të ketë asnjë lëvizje asimetrike dhe qëndrim konstant të pozicionit financiar) është si më poshtë:

	2023		2022	
	100 bp	100 bp	100 bp	100 bp
	Rritje	Ulje	Rritje	Ulje
Efekti i parashikuar në fitim / (humbje)	(129,490,290)	129,490,290	(144,596,727)	144,596,727

- *Risku i çmimeve të tjera*

Çmimi i kapitalit

OST sh.a. nuk ka ekspozim ndaj riskut të çmimit të kapitalit sepse nuk mban aktive financiare që përmbajnë elementë kapitali në datën e raportimit. Nuk është politikë e shoqërisë që të blejë instrumenta të tillë dhe të ekspozohet si rrjedhim ndaj riskut të çmimit të lidhur me lëvizjet në treguesit e tregut të kapitalit.

Tarifat e transmetimit

Sipas modelit aktual të tregut të energjisë, shoqëria faturon vetëm një tarifë fikse për çdo njësi energjie të transmetuar. Tarifat e transmetimit dhe vlerësimi i kërkesës për energji në tregun lokal janë veçanërisht të rëndësishëm për OST në këto rrethana. Tarifa e transmetimit që OST do të jetë në gjendje të zbatojë janë objekt i miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, duke krijuar në këtë mënyrë risk çmimi.

5.2.3 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. OST është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, shoqëria përballlet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve që i ka bërë OSHEE sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë. Drejtimi monitoron çdo muaj parashikimet e flukseve të parasë.

Procesi i adoptuar nga drejtuesit për menaxhimin e likuiditetit përfshin edhe vendosjen e kufizimeve ndaj degëve për shpenzimet në lidhje me aktivitetet e përditshme si shërbimet, furnizimet, investimet, shtyrjen e pagesave ndaj disa kreditorëve, riskedulimin e marrëveshjeve midis palëve dhe parashikimin e pagesave të kredive duke siguruar që këto të jenë të mbuluara.

Tabela e mëposhtme tregon detyrimet më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 sipas maturimit të tyre të kontraktuar. Shumat e paraqitura në tabelën e maturimit janë flukse të kontraktuara të skontuara të parasë.

Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma që paraqitet është përcaktuar duke i'u referuar kushteve që kanë ekzistuar në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin ditor të këmbimit në datën e raportimit.

Analiza e maturitetit të detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 është si vijon:


Ne Lekë	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Detyrimet më 31 dhjetor 2023				
Llogari të pagueshme e të tjera	(11,903,078,264)	(1,613,249,455)	(757,854,166)	(14,274,181,885)
Kredi dhe hua	(14,942,052,998)	(3,399,787,872)	(6,700,353,025)	(25,042,193,895)
Totali i pagesave të ardhshme	(26,845,131,262)	(5,013,037,327)	(7,458,207,191)	(39,316,375,780)
Detyrimet më 31 dhjetor 2022				
Llogari të pagueshme e të tjera	(9,959,035,190)	(2,539,270,259)	(877,854,166)	(13,376,159,615)
Kredi dhe hua	(15,143,428,546)	(4,757,546,560)	(8,660,497,907)	(28,561,473,013)
Totali i pagesave të ardhshme	(25,102,463,736)	(7,296,816,819)	(9,538,352,073)	(41,937,632,628)

5.3 Menaxhimi i Kapitalit

Objektivat e shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e saj për vijimësi të biznesit me qëllim sigurimin e kthimeve për aksionarët dhe të përfitimeve për grupet e tjera të interesit dhe të mbajë një strukturë optimale të kapitalit e cila mundëson reduktimin e koston së kapitalit.

Njëlloj me shoqëritë e tjera në industri, OST monitoron kapitalin bazuar në raportin e detyrimeve ndaj kapitalit. Ky raport llogaritet si totali i detyrimeve pjesëtuar me kapitalin nën drejtim. Shoqëria konsideron si total kapitali, kapitalin e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar.

	2023	2022
Totali i detyrimeve	42,498,099,521	44,582,802,309
Totali i kapitalit aksionar	41,045,308,933	32,745,048,489
	104%	136%



6. Aktive afatgjata materiale

	Toka & Ndërtesa	Makineri e Pajisje
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2021</i>	5,516,109,901	46,500,615,585
Sistemime për efektin e testit të zhvlerësimit	(568,032,940)	(4,696,518,809)
Sistemime për efektin e kapitalizimit të interesave		
Shtesa blerje të reja	600,000	5,114,014
Riklasifikime dhe shtesa të tjera	22,748,206	1,625,109,964
Transferime në aktive afatgjatë jo materiale		
Riklasifikime në aktive të tjera		
Nxjerrje jashtë përdorimit	(450,819)	(86,548,242)
Kalime nga (në) magazina (riklasifikime)		
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2022</i>	4,970,974,348	43,347,772,512
Efekti i rivlerësimit 01.01.2023	924,766,040	8,524,242,571
Sistemime për efektin e kapitalizimit të interesave		
Shtesa blerje të reja		386,000
Riklasifikime dhe shtesa të tjera	7,517,528	810,986,765
Transferime në aktive afatgjatë jo materiale		
Riklasifikime në aktive të tjera		(524,845)
Kalime nga (në) magazina (riklasifikime)		
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2023</i>	5,903,257,916	52,682,863,003
<i>Amortizimi i Akumuluar</i>		
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2021</i>	(235,243,080)	(6,253,649,462)
Sistemime për efektin e testit të zhvlerësimit	36,094,102	810,299,040
Sistemime për efektin e kapitalizimit të interesave të vitit		(28,678,921)
Amortizimi i vitit	(79,163,041)	(1,838,527,843)
Nxjerrje jashtë përdorimit dhe të tjera	22,041	21,053,588
Gjendja më 31 dhjetor 2022	(278,289,978)	(7,289,503,598)
Efekti i rivlerësimit 01.01.2023	(24,590,906)	(3,596,413,392)
Sistemime për efektin e kapitalizimit të interesave të vitit		(28,678,921)
Amortizimi i vitit	(80,691,336)	(2,292,719,215)
Nxjerrje jashtë përdorimit dhe të tjera		459,519
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2023</i>	(383,572,220)	(13,206,855,607)
VLERA NETO MË 31 DHJETOR 2022	4,692,684,370	36,058,268,914
VLERA NETO MË 31 DHJETOR 2023	5,519,685,696	39,476,007,396

Automjete	Pajisje Zyre	Investim ne proces	Total
407,676,518	852,274,200	8,044,804,257	61,321,480,461
(35,491,679)	(87,298,206)	(167,138,084)	(5,554,479,718)
		991,622	991,622
	16,555,000	2,678,844,595	2,701,113,609
	28,762,843	(1,532,912,920)	143,708,093
		(28,965,843)	(28,965,843)
	(3,719)	(1,415,539,031)	(1,415,542,750)
(65,000)	(1,941,333)	(3,224,608)	(92,230,002)
		(15,691,775)	(15,691,775)
372,119,839	808,348,785	7,561,168,213	57,060,383,697
(95,977,972)	(350,809,091)	169,696,584	9,171,918,132
		318,407	318,407
380,000	3,647,224	3,593,037,553	3,597,450,777
	58,741,399	(844,090,614)	33,155,078
		(30,525,737)	(30,525,737)
	(213,531)	(179,984)	(918,360)
		(6,475,053)	(6,475,053)
276,521,867	519,714,786	10,442,949,369	69,825,306,941
(139,649,947)	(317,328,995)		(6,945,871,484)
14,185,816	50,700,552		911,279,510
			(28,678,921)
(43,642,674)	(128,337,110)		(2,089,670,668)
40,000	208,165		21,323,794
(169,066,805)	(394,757,388)		(8,131,617,769)
168,138,645	388,527,695		(3,064,337,958)
			(28,678,921)
(33,348,905)	(67,652,462)		(2,474,411,918)
	47,199		506,718
(34,277,065)	(73,834,956)		(13,698,539,848)
203,053,034	413,591,397	7,561,168,213	48,928,765,928
242,244,802	445,879,830	10,442,949,369	56,126,767,093

6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 OST nuk i ka regjistruar të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Shoqëria është në proces të përgatitjes së një liste të detajuar përmbledhëse mbi pasuritë e paluajtshme për t'u regjistruar.

Nuk ka aktive të lëna si kolateral më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022.

Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimin e aktiveve të transmetimit, duke përfshirë kryesisht linja transmetimi dhe nënstacione.

Njohja e aktiveve afatgjata materiale bëhet me vlerën e drejtë në mënyrë periodike çdo 5 vjet.

• Matja e vlerës së drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e aktiveve afatgjata materiale u përcaktua nga një grup ekspertësh të jashtëm të caktuar me Vendim të Asamblesë së Aksionarit nr. 99 datë 15.09.2022 “Për rivlerësimin e asetëve të shoqërisë OST sh.a”. Grupi i ekspertëve përbëhet nga vlerësues të certifikuar të pasurive të paluajtshme dhe auditues ligjorë.

Gjatë vitit 2022, në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Aksionarit nr. 99 datë 15.09.2022 “Për rivlerësimin e asetëve të shoqërisë OST sh.a”, më datë 08.11.2022, OST sh.a. ka lidhur kontratën me objekt “Për rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale të OST sh.a sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe konkretisht SNK 16 “Aktivet afatgjata materiale” dhe SNK 36 “Zhvlerësimi i Aktive” me grupin e Ekspertëve Vlerësues dhe Audituesëve Ligjorë të përcaktuar me vendimin e lartpërmendur, efekti i të cilit do të përfshihet në pasqyrat financiare më datë 01.01.2023.

Në zbatim të kësaj kontrate, për datën 31 Dhjetor 2022, Grupi i ekspertëve, pas një analize të detajuar ka kryer testin e zhvlerësimit të aktiveve fikse.

TESTI I ZHVLERËSIMIT

Qëllimi i testit të zhvlerësimit është të sigurojë që Aktivët në pronësi të Shoqërisë, janë regjistruar në pasqyrat financiare në një shumë që nuk tejkalon vlerën e tyre të rikuperueshme.

Ndër metodat e vlerësimit të biznesit grupi i ekspertëve ka zgjedhur Metodën e Aktualizimit të Flukseve të Parasë (Discount Cash Flow) si më të përshtatshme për situatën dhe kushtet ku Shoqëria operon.

Testi i zhvlerësimit për aktivët afatgjata materiale është bërë duke u bazuar në Flukset Monetare që krijohen nga këto aktive.

Vlera e rikuperueshme e aktiveve është :

- Vlera e drejtë minus koston e shitjes
- Vlera në përdorim

Duke marrë në konsideratë se Shoqëria nuk ka konkurrentë të ngjashëm në treg si shumë e rikuperueshme e aktiveve afatgjata është marrë vlera në përdorim.

Për qëllimet e testit të zhvlerësimit, drejtimi i ka trajtuar të gjitha aktivet në një njësi gjeneruese të parasë (NJGJP). Shuma e rikuperueshme është bazuar në vlerën në përdorim, të përcaktuar nga skontimi i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare që do të gjenerohen nga përdorimi i vazhdueshëm i NJGJP -së.

Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e vlerës në përdorim janë paraqitur më poshtë:

10.03%

Faktori i skontimit

3%

**Norma e rritjes
terminale**

7.03%

Norma e kapitalizimit

Parashikimet e flukseve të parasë përfshijnë vlerësime specifike për pesë vjet dhe një normë të rritjes në përjetësi pas kësaj. Shkalla e rritjes në përjetësi është përcaktuar në bazë të vlerësimit të drejtimit të rritjes vjetore të përbërë të fitimit para interesave, taksave dhe amortizimit (EBITDA) brenda kapaciteteve normale të prodhimit të shoqërisë.

Marzhi i EBITDA ka pasur luhatje gjatë periudhës së analizës, pasi ka ndjekur trendin e biznesit, lidhur më së tepërmi me luhatjet në koston e transmetimit.

EBITDA e parashikuar u bazua në supozimet kryesore, të cilat përfaqësojnë vlerësimet e drejtimit si më poshtë:

Energjia totale e transmetuar në rrjetin e OST pritet të rritet gradualisht nga 9.44 TWh në 2022 në 9.85 TWh në 2026.

Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike është parashikuar të lëvizë nga 1.37 ALL/ KWh në 2023 në 1.79 ALL /KWh në 2026.

Të ardhurat priten të rriten nga 2022 në 2026 kryesisht për shkak të rritjes së tarifës së transmetimit. Pjesën më të madhe të të ardhurave nga transmetimi e përbën energjia e transmetuar ndaj OSHEE rreth 70 % të totalit.

Gjithahtu, shpenzimet operative pritet të rriten përgjatë viteve, duke reflektuar kështu normën e mundshme të inflacionit.

Shpenzimet për blerjen e energjisë për të mbuluar humbjet në rrjet priten të përbejnë pjesën më të konsiderueshme, prej 38 % totalit të shpenzimeve operative, kjo si pasojë e rritjes së konsiderueshme të çmimit të energjisë.

Vlerat e përcaktuara për supozimet kryesore paraqesin vlerësimin e drejtimit për trendin e ardhshëm në sektorin e energjisë elektrike dhe janë bazuar në të dhënat historike dhe zhvillimet e ardhshme nga burimet e jashtme dhe të brendshme.

Në përfundim, sipas metodologjisë së përdorur dhe llogaritjeve përkatëse, Vlera e Rikuperueshme (Vlera në Përdorim) e Aktiveve Fikse të OST që rezulton më 31.12.2022, është më e ulët se Vlera Kontabël, duke rezultuar kështu në zhvlerësim prej 4,650 milionë lekë.

Me shkresën nr. 3898/1 prot. datë 28.03.2023, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është vendosur përfshirja e efekteve të Testit të Zhvlerësimit të Aktiveve Afatgjata Materiale të OST sh.a. në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

NIVELI 3 | VLERËS SË DREJTË

Vlerat e drejta të aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë kategorizohen në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë.

Vlerë e Drejtë përcaktohet si: “Çmimi më i mundshëm, në datën e specifikuar, në para, ose në termat ekuivalente të parasë, ose në terma të tjerë të përcaktuar në mënyrë ekzakte, për të cilat të drejtat e specifikuar të aktiveve do të shiteshin pas një ekspozimi të arsyeshëm në një treg konkurrues, nën të gjitha kushtet e kërkuara për një shitje të drejtë, me blerës dhe shitës të cilët veprojnë me maturi, dije dhe sipas interesit vetjak, dhe duke supozuar që askush nuk vepron nën detyrim”. Metodologjitë dhe rregullimet e aplikuara për vlerësimin e aktiveve afatgjata të OST sh.a., i referohen datës së vlerësimit 1 janar 2023 e cila është edhe data efektive e rivlerësimit.

Rivlerësimi i aktiveve të shoqërisë “OST” sh.a. është bërë duke u bazuar në këto metoda :

- Metoda e Tregut ose Metoda e Krahasimit të drejtpërdrejtë
- Kosto e Zëvendësimit e Amortizuar

Metoda e Tregut ose Metoda Krahasimit të drejtpërdrejtë bazohet në evidenca të krahasueshme me aktive të ngjashme, si dhe në kërkimet e përgjithshme të tregut lokal. Metodologjia konsiston në një analizë të shitjeve dhe ofertave të tjera të pronave të ngjashme pranë pronave në fjalë ose dhe më larg tyre. Metoda e Kostos apo Metoda e Zëvendësimit të Kostos së Amortizuar është përdorur në mungesë të të dhënave (evidencave) të tregut për shitjen e aktiveve.

Metoda e kostos mat vlerën duke vlerësuar Koston e Re të Zëvendësimit ose Koston e re të Riprodhimit të pronës dhe pastaj duke përcaktuar zbritjet për amortizimin, i

cili duhet të reflektojë moshën, kushtet dhe gjendjen e aktivitetit gjatë së shkuarës dhe jetëgjatësinë ekonomike të ardhshme të propozuar.

Më poshtë jepet informacioni për metodologjinë e vlerësimit që është adoptuar për secilën klasë aktivi :

1. Toka – Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë
2. Ndërtesa – Metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar
3. Makineri dhe Pajisje – Metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar
4. Nënstationet – Metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar
5. Linjat e Transmetimit të Energjisë – Metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar
6. Mjetet e Transportit – Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë (përjashtim bëjnë disa automjete të cilat kanë të inkuorporuar pajisje teknologjike që ndihmojnë në realizimin e proceseve teknike, të cilat në pamundësi të gjetjes së të dhënave në treg janë vlerësuar në bazë të vlerës së regjistruar në kontabilitet duke ju bërë axhustimet në lidhje me amortizimin fizik sipas llojit dhe vitit të vënies në shfrytëzim).
7. Pajisje të zyrave dhe Pajisje Informatike – Metoda e tregut

Inputet kryesore të përdorur për nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë janë vlerësuar këto si më poshtë :

- a) Jetëgjatësia e aktiveve bazuar në llojin e përdorimit të tyre, cilësia, dhe gjendja e tyre faktike;
- b) Informacioni i tregut mbi vlerën e shitjes së pronave të ngjashme.

Nga rivlerësimi i kryer më 1 Janar 2023, efekti në aktivitet afatgjatë materiale dhe jomateriale ka qenë :

- Një rritje në vlerën bruto të aktiveve afatgjatë materiale në shumën 8,654,897,888 Lek;
- Një rritje në vlerën e amortizimit të aktiveve afatgjatë materiale në shumën 2,483,265,792 Lek;
- Efekti i kombinuar i të cilave ka çuar në rritjen neto të vlerës së aktiveve afatgjatë materiale më 1 Janar 2023 në shumën 6,171,632,096 Lek.

Raporti i Rivlerësimit të Aktiveve Afatgjatë Materiale është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. nr 14 datë 20.09.2023 si dhe me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve nr. 91 datë 31.10.2023 “Për miratimin e raportit të rivlerësimit të aktiveve afatgjatë materiale të shoqërisë OST sh.a. .

Data efektive e rivlerësimit të aktiveve afatgjatë materiale të OST është 1 janar 2023.

7. Aktive afatgjata jomateriale

	Programe Kompjuterike
Vlera Bruto	
<i>Gjendja më 1 janar 2022</i>	727,927,878
Sistemime për efektin e testit të zhvlerësimit	(28,810,472)
Shtesa blerje të reja	31,438,000
Shtesa nga investimet	28,965,843
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2022</i>	759,521,249
Efekti i rivlerësimit 01.01.2023	(517,020,245)
Shtesa blerje të reja	40,395,299
Shtesa nga investimet	30,525,744
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2023</i>	313,422,047
Amortizimi i Akumuluar	
<i>Gjendja më 1 janar 2022</i>	(474,269,987)
Sistemime për efektin e testit të zhvlerësimit	22,315,256
Amortizimi i vitit	(129,117,441)
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2022</i>	(581,072,172)
Efekti i rivlerësimit 01.01.2023	581,072,172
Amortizimi i vitit	(45,302,388)
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2023</i>	(45,302,388)
VLERA NETO MË 31 DHJETOR 2022	178,449,077
VLERA NETO MË 31 DHJETOR 2023	268,119,659

8. Aktive me të drejtë përdorimi

	Ndërtesa	Mjete transporti	Total
<i>Gjendja më 01 janar 2023</i>	7,429,070	29,115,621	36,544,691
Shtesa		63,446,390	63,446,390
Pakësime	(360,974)	(179,591)	(540,565)
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2023</i>	7,068,096	92,382,420	99,450,516
Amortizimi i Akumuluar			
<i>Gjendja më 01 janar 2023</i>	(2,682,720)	(5,823,124)	(8,505,844)
Amortizimi i vitit	(2,357,466)	(15,014,154)	(17,371,620)
Pakësime	130,352	35,918	166,270
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2023</i>	(4,909,834)	(20,801,360)	(25,711,194)
VLERA NETO MË 31 DHJETOR 2022	4,746,350	23,292,497	28,038,847
VLERA NETO MË 31 DHJETOR 2023	2,158,262	71,581,060	73,739,322

OST sh.a. ka lidhur kontratë qiraje me “EL” sh.p.k. me qëllim dhënien me qira të një ndërtese për të shërbyer si magazinë. Afati i qirasë është 36 muaj dhe pagesa mujore e qirasë është 220,000 lekë (amenduar më 26 prill 2022).

OST sh.a. ka lidhur 3 kontrata qiraje me OE “ASG” sh.p.k. lidhur me automjetet e dhëna me qira.

- Kontrata e pare lidhur më 16 Nëntor 2021 me afat maturimi 5 vjet, për një shumë totale 34 740 001 lekë.
- Kontrata e dyte lidhur më 14 Nëntor 2022 me afat maturimi për 5 vjet, për një shumë totale 42,540,000 lekë.
- Kontrata e tretë lidhur më 28 prill 2023 me afat maturimi 5 vjet, për një shumë totale 34,680,000 lekë.

Për të llogaritur aktivet me të drejtë përdorimi, është llogaritur vlera aktuale e pagesave të qirasë sipas afateve të tyre të maturimit dhe kushteve të kontratës. Shpenzimet e interesit janë llogaritur duke marrë në konsideratë normën e interesit sipas publikimit më të fundit nga Banka e Shqipërisë mbi normat mesatare të peshuara të interesit për kreditë e reja nga institucionet jofinanciare. Shpenzimet e zhvlerësimit janë llogaritur me metodën lineare gjatë jetës së qirasë.

Detyrimet e qirasë më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrimi i qirasë		
Pjesa afatshkurtër	20,835,163	3,359,918
Pjesa afatgjatë	59,681,953	26,991,103
TOTAL I DETYRIMEVE TË QIRASË	80,517,116	30,351,021

Përveç kësaj, OST sh.a. aplikon përjashtimin e njohjes së qirasë me afat të shkurtër për qiratë afatshkurtra (ato kontrata qiraje që kanë një afat prej 12 muajsh ose më pak nga data e fillimit dhe nuk përmbajnë një opsion blerjeje).

OST sh.a. aplikon gjithashtu përjashtimin mbi njohjen e qirave me vlerë të ulët për qiratë që konsiderohen të jenë me vlerë të ulët. Pagesat e qirasë për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët njihen si shpenzime me metodën lineare gjatë afatit të qirasë.

9. Aktivet financiare

Aktivët financiarë përfshijnë investime në aksione dhe kredi të arkëtueshme nga palët si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktive financiare afatgjata		
Entitete të tjera	5,603,600	5,603,600
Hua dhënë punonjësve	6,503,908	5,868,158
Total i aktive financiare afatgjata	12,107,508	11,471,758
Aktive financiare afatshkurtra		
Hua për palët e treta	20,000,000	20,000,000
Hua dhënë punonjësve	90,000	815,750
Total i aktive financiare afatshkurtra	20,090,000	20,815,750
TOTAL I AKTIVE FINANCIARE	32,197,508	32,287,508

Entitete të tjera përfshijnë pjesëmarrjen në kapital, të mbajtur me kosto historike, të South East Europe Capacity Allocation Office (SEE CAO) e cila është një shoqëri e vendosur në Mal të Zi dhe e themeluar së bashku me shoqëritë e transmetimit të Malit të Zi, Kroacisë, Greqisë, Kosovës, Bosnje Hercegovinës dhe Turqisë.

Gjithashtu, në entitete të tjera përfshihet pjesëmarrja e OST sh.a., si aksionare me 57.25 % të kapitalit themeltar në Bursën Shqiptare të Energjisë - Alpex sh.a. .Me Vendimin nr. 12 datë 08.09.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., si dhe me Vendimin

nr. 130 datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratuan pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a. .

Hua për palët e treta lidhet me huanë e dhënë për Albgaz sh.a. me vendimin nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. .Afati i maturimit të kredisë është dy vite. Sipas marrëveshjes mes OST dhe Albgaz sh.a. huamarrësi ka për detyrë kthimin e shumës së plotë të huasë me normë interesi 0 (zero) tek huadhënësi brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje. Më datë 22.10.2019 është firmosur Amendimi Nr.1 i marrëveshjes së mësipërme sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës së plotë të huasë tek Huadhënësi me normë interesi zero brenda tre viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes.

Më datë 07.08.2020 është firmosur Amendimi Nr.2 i marrëveshjes së mësipërme sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës së plotë të huasë tek Huadhënësi me normë interesi zero brenda katër viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes. Më datë 28.07.2021 është firmosur Amendimi Nr. 3 i marrëveshjes së mësipërme sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës së plotë të huasë tek Huadhënësi me normë interesi zero brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes. Me vendimin Nr. 20 datë 27.12.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. është miratuar shtyrja e afatit të huasë, Amendamenti Nr. 4 i marrëveshjes së mësipërme, sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës së plotë të huasë tek Huadhënësi me normë interesi zero brenda tetë viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes. Amendamenti Nr. 4 është firmosur nga palët me datë 15.01.2024.

10. Inventarët

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Materiale ndihmëse	228,698,289	222,886,302
Lëndë djegëse	18,709,915	13,861,217
Pjesë ndërrimi	130,911,888	132,503,282
Materiale të tjera	329,115,471	345,386,256
TOTALI I INVENTARIT	707,435,563	714,637,057

11. Llogari të arkëtueshme e të tjera

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të arkëtueshme afatgjata		
Klientë për mallra, produkte dhe shërbime	8,429,229,200	8,787,768,309
	8,429,229,200	8,787,768,309
Të arkëtueshme afatshkurtra		
Klientë për mallra, produkte dhe shërbime	11,088,038,523	10,430,304,194
Paradhënie për punonjësit	409,080	4,458,779
Shteti – TVSH e zbritshme	86,057,567	296,948,239
Debitorë të tjerë	976,739,566	2,376,640,116
Asete për tu marrë nga KESH sh.a.	73,069,514	73,069,514
Minus: provizioni për rënien në vlerë	(916,097,948)	(794,676,382)
	11,308,216,302	12,386,744,460
TOTAL	19,737,445,502	21,174,512,769

Klientë për mallra, produkte dhe shërbime analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
OSHEE sh.a.	18,196,330,299	17,716,649,714
KESH sh.a.	135,909,127	50,386,175
Shoqëri private	1,185,028,297	1,451,036,614
TOTAL	19,517,267,723	19,218,072,503

Pjesa më e madhe e të arkëtueshme nga OSHEE sh.a., më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, lidhen kryesisht me shumën për shitjet e bëra në vitet paraardhëse.

Më 17 dhjetor 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë miratuan “Planin e masave për uljen e detyrimeve të detyrueshme në sektorin e energjisë elektrike”.

Më 15 prill 2021 ndërmjet OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. është firmosur “Marrëveshja për pagesën e detyrimeve të prapambetura” në shumën 9,687,768,309 lekë. Marrëveshja përfshin një skemë pagese duke filluar nga data 1 korrik 2021 për një shumë minimale prej 360 milionë lekë në vit ose 6.5 % të faturave aktuale vjetore, të cilat do të shlyejnë teprricat e mbartura. Bazuar në këtë marrëveshje shumat totale të paguara nga OSHEE sh.a. kundrejt OST sh.a. do të shlyen deri në vitin 2047.

Të arkëtueshmet nga OSHEE përfshinë gjithashtu vlerat 540,513,321.21 lekë dhe 1,760,983,525 lekë të cilat përfaqësojnë fatura të lëshuara nga OST për sistemimin e

faturave të shërbimeve të balancimit për vitet 2016 dhe 2017 sipas vendimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) Nr. 110 datë 14.05.2018 janë të papranuara nga OSHEE sipas shkresës së OSHEE Nr. 10615/1 datë 11.06.2018. Në bazë të të njëjtit vendim OST ka njohur të pagueshme ndaj KESH duke pranuar faturat me të njëjtën vlerë të lëshuara prej saj (shënimi 16). OSHEE ka ankimuar vendimin e ERE në Gjykatën Administrative të shkallës së parë e cila me vendim Nr. 3851 datë 29.10.2018 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së OSHEE. Vendimi është ankimuar nga OSHEE në gjykatën e apelit dhe çështja është në proces.

OST nga ana e saj i është drejtuar gjykatës për të kërkuar njohjen e detyrimit nga OSHEE dhe shlyerjen e detyrimit me kërkesë padinë Nr. 7475 datë 31.10.2018. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim Nr. 3809 datë 13.03.2019 vendosi pezullimin e gjykimit me arsyetimin se duke qenë se padia e OST është mbështetur në vendimin e ERE Nr. 110 datë 14.05.2018, çështja nuk mund të zgjidhet pa u zgjidhur më parë çështja e ngritur nga OSHEE në gjykatën e apelit me vendim të formës së prerë. Përgjatë vitit 2023 nuk ka ndodh asnjë ndryshim në statusin e çështjeve pasi pritet vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit.

12. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet për furnitorët kanë të bëjnë me parapagimet për furnitorët e mallrave dhe shërbimeve, kontraktuar për qëllim të ndërtimit të aktiveve të transmetimit.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Parapagime për furnitorë	1,379,751,355	1,481,225,255
Shpenzime të shtyra	101,034,926	83,762,784
	1,480,786,281	1,564,988,039

13. Mjete monetare në arkë e bankë



Mjetet monetare analizohen si më poshtë :

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Para në bankë	4,556,057,361	4,701,069,408
Garanci bankare	5,102,165	5,102,165
Cash kolateral	555,758,000	
TOTAL	5,116,917,526	4,706,171,573

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të cilat klasifikohen si aktive financiare të matura me koston e amortizuar, kanë qenë subjekt i matjes së provizionit “Qasjes së përgjithshme”. Megjithatë, për shkak se llogaritë rrjedhëse janë në kërkesë, humbjet e pritshme 12-mujore dhe përgjatë gjithë jetës janë të njëjta. Kjo do të thotë se

humbjet e pritshme kanë qenë jomateriale.

Rreziku i kredisë në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre është i kufizuar duke qenë se janë depozituar në banka me vlerësime të larta të përcaktuara nga agjencitë ndërkombëtare të kreditit.

31 Dhjetor 2023	Monedha	Vlerësimi i Moody's
	Lek	A3
	Lek	Caa1
	Lek	B1
	Lek	Baa2
	Lek	A3
	Lek	B1
	Lek	B1
	Lek	Ba2

14. Kapitali

- Kapitali aksionar

Numri total i aksioneve të zakonshme më 31 dhjetor 2022 ishte 25,055,608 aksione (2022: 25,055,608 aksione) me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Të gjitha aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara.

Gjatë vitit 2022, ka pasur rritje kapitali bazuar në shkresën Nr.18565/2 datë 06.01.2022 vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr. 24 datë 06.01.2022 "Mbi Pasqyrat Financiare të shoqërisë OST sh.a. për vitin 2020", me anë të së cilës është caktuar eksperti për hartimin e raportit për rritjen e kapitalit nëpërmjet përfshirjes së fitimit të pashpërndarë në kapitalin e OST sh.a. .

Regjistrimi në QKB i rritjes së kapitalit është kryer në datën 30.05.2022.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, ka pasur rritje kapitali bazuar në shkresën Nr. 14247/1 datë 04.08.2022 vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr. 83 datë 04.08.2022 "Mbi Pasqyrat Financiare të shoqërisë OST sh.a. për vitin 2021", me anë të së cilës është caktuar eksperti për hartimin e raportit për rritjen e kapitalit

nëpërmjet përfshirjes së fitimit të pashpërndarë dhe grupit të rezervave të tjera (perveç rezervës ligjore dhe rezervës së rivlerësimit), në kapitalin e OST sh.a. .

Regjistrimi në QKB i rritjes së kapitalit është kryer në datën 23.11.2022.

Gjatë vitit 2023, nuk ka pasur lëvizje të kapitalit aksionar.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Gjendje më 1 janar	25,055,608,000	22,146,576,634
Rritje e kapitalit		2,909,031,366
GJENDJE MË 31 DHJETOR	25,055,608,000	25,055,608,000

- Rezerva të rivlerësimit

Rezervat e rivlerësimit në shumën ALL 7,805,859,990 lekë (2022: 5,421,483,544 lekë) përfaqësojnë diferencën pozitive të rivlerësimit që vjen nga vlerësimi i pavarur i aktiveve afatgjata materiale dhe huave afatgjata me vlerën e drejtë në momentin fillestar dhe mbajtjen e tyre më pas me kosto të amortizuar.

- Rezerva ligjore

Rezervat ligjore përfaqësojnë ndarjen e një pjese të fitimeve të pashpërndara në përputhje me ligjin Nr. 9901 “Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare” të datës 14 prill 2008, i cili kërkon që të paktën 5 % e fitimit, por jo më shumë se 10 % e kapitalit mbahet si rezervë ligjore.

- Rezerva të tjera

	Nr. i vendimit	Data e vendimit	Total
<i>Balanca më 31 dhjetor 2021</i>			517,627,527
Zvogëlim	52	04/05/2022	(454)
Rritje	83	04/08/2022	627,594,442
Zvogëlim	103	24/10/2022	(1,131,162,785)
Zvogëlim		31/12/2022	(190,222)
<i>Balanca me 31 dhjetor 2022</i>			13,868,508
Rritje	30	31/05/2023	862,208,385
Zvogëlim		31/12/2023	(365,048)
<i>Balanca më 31 dhjetor 2023</i>			875,711,845

Rezervat e tjera janë krijuar nga mbajtja e fitimeve të mbartura.

Gjatë vitit 2022, në bazë Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr 83 datë 04.08.2022, rezervat e tjera janë rritur me 627,594,443 lekë nga shpërndarja e rezultatit financiar të vitit 2021.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr 103 datë 24.10.2022, rezervat e tjera janë zvogëluar me 1,131,162,785 lekë si rezultat i përfshirjes së tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Gjatë vitit 2023, në bazë Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr 30 datë 31.05.2023, rezervat e tjera janë rritur me 862,208,385 lekë nga shpërndarja e rezultatit financiar të vitit 2022.

- Interesat e pakicës

Interesat e pakicës më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Kapitali pakicës	106,875,000	106,875,000
Rezerva të tjera	(475,236)	(202,646)
Humbje e mbartur	(36,174,290)	(13,937,127)
Humbje e vitit financiar	(32,582,789)	(22,237,162)
TOTAL	37,642,685	70,498,065

Interesat e pakicës përfaqësojnë pjesëmarrjen e KOSTT, si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 42.75% të kapitalit themeltar.

15. Huatë

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Hua Afatgjata		
Ministria e financave dhe ekonomisë	7,930,007,559	10,835,480,061
Marrëveshje nën-huaje me KESH	2,170,133,338	2,582,564,406
Totali i huasë afatgjatë	10,100,140,897	13,418,044,467
Hua Afatshkurtra		
Ministria e financave dhe ekonomisë	8,194,761,054	8,188,669,041
Marrëveshje nën-huaje me KESH	6,747,291,944	6,954,759,505
Totali i huasë afatshkurter	14,942,052,998	15,143,428,546
Ministria e financave dhe ekonomisë	16,124,768,613	19,024,149,102
Marrëveshje nën-huaje me KESH	8,917,425,282	9,537,323,911
TOTAL DETYRIME PËR HUA	25,042,193,895	28,561,473,013

Huatë kanë afate maturimi që variojnë nga një në pesëdhjetë vite dhe janë të garantuara nga Qeveria Shqiptare. Vlerat kontraktuale mesatare të interesit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 ishin si më poshtë:



Vlerat kontabël të huave të Shoqërisë që janë të shprehura në monedhat e mëposhtme :

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
EUR	18,205,535,062	21,415,028,402
USD	2,691,389,363	2,878,575,595
CHF	1,013,699,703	1,037,216,412
JPY	404,063,905	488,425,242
KRW	2,554,644,519	2,565,613,391
ALL	172,861,343	176,613,971
	25,042,193,895	28,561,473,013

Në momentin e ndarjes, KESH i ka nën-huazuar Shoqërisë (OST) disa hua nga institucione të ndryshme. Pas ndarjes së dy shoqërive, ndarja e huave midis OST dhe KESH u bazua në përqindjen e vlerësuar më 30 qershor 2006 dhe kjo përqindje u përdor për të transferuar pagesat e principalit dhe interesit tek OST.

16. Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrimet afatgjata		
Furnitorë për aktivet afatgjata materiale	1,013,249,455	1,939,270,259
Furnitorë për mallra dhe shërbime	1,357,854,166	1,477,854,166
Totali	2,371,103,621	3,417,124,425
Detyrimet afatshkurtra		
Furnitorë për aktive afatgjata materiale	241,879,418	136,987,842
Furnitorë për mallra dhe shërbime	10,313,521,380	8,725,083,886
Furnitorë për fatura të pambërritura	287,012,221	525,072,973
Kreditorë të tjerë	983,572,580	498,351,668
Detyrime tatimore	77,092,663	73,538,821
Totali	11,903,078,262	9,959,035,190
TOTALI	14,274,181,883	13,376,159,615

Llogaritë e pagueshme tregtare afatshkurtra për aktivet afatgjata materiale lidhen kryesisht me punimet dhe materialet e furnizuara, por të pagueshme në vitin pasardhës.

Llogaritë e pagueshme afatgjata për aktivet afatgjata materiale lidhen me garancitë e performancës të pagueshme me mbarimin e kontratës së furnizimit.

Furnitorë për mallra dhe shërbime afatgjata përfaqësojnë detyrimin afatgjatë të "Marrëveshjes për pagesën e detyrimeve të prapambetura" të firmosur ndërmjet OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. Marrëveshja përfshin një skemë pagese duke filluar nga data 1 korrik 2021 për një shumë minimale prej 360 milionë lekë në vit ose 6.5 % të faturave aktuale vjetore, të cilat do të shlyejnë tepricat e mbartura.

Bazuar në këtë marrëveshje shumat totale të papaguara nga OSHEE sh.a. kundrejt OST sh.a. do të shlyen deri në vitin 2047.

Gjithashtu, në llogarinë furnitorë për mallra dhe shërbime janë përfshirë fatura të lëshuara nga KESH për sistemimin e faturave të shërbimeve të balancimit për vitet 2016 dhe 2017 në vlerat 540,513,321 lekë dhe 1,760,983,525 lekë, sipas vendimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) Nr. 110 datë 14.05.2018.

Furnitorë për faturat e pambërritura përbëhet nga fatura të cilat janë lëshuar pas datës 31 dhjetor 2023 por që i korrespondojnë detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2023.

17. Grante

Grantet analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Grante të tjera nga KESH sh.a.	6,178,586	6,480,939
Grante nga OSHEE sh.a.	227,448,503	257,423,811
Grante të tjera për Linjë paraburgimi Fier	6,999,415	7,172,963
Grante të tjera për Linjë paraburgimi Elbasan	7,264,455	7,558,874
Grant shtylla 6/1 për linjën 110 KV “Elbasan – Metalurgji”	1,274,893	1,304,285
Grante për pjesët rezervë “Devoll Hydropower” Elbasan	24,146,587	24,146,587
Grante Linja e tensionit të lartë Hec Peshqesh	40,634,603	41,616,349
Grante nga KfW Linja 400KV Tiranë - Podgoricë	302,338,340	310,407,718
Grante nga KfW Linja 400KV Tiranë - Prishtinë	43,963,253	45,237,617
Grante nga KfW Linja Shqipëria e Jugut	77,646,928	79,828,846
Grante kontenjerë nga firma C&G D.O.O	3,325,853	3,325,853
Grant – KfW dhe EU për Linjën 400 kV Shqipëri - Maqedoni	427,125,747	359,808,116
Grant- Flexitranstore & Farcross	9,507,971	9,457,670
Grant CWI Transformator 110/10 kV 5MVA- Metalurgji 2	1,750,661	1,806,228
Grant nga Vodafone - Telefona	25,624	
TOTALI	1,179,631,419	1,155,575,856

Grantet lidhen me kostot dhe aktivet, dhe përfshijnë grante direkt nga qeveria ose nga donatorë për qeverinë shqiptare lidhur me aktivitetet e Shoqërisë dhe për të financuar aktivet.

Levizjet në grante paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Gjendja më 1 janar	1,155,575,856	1,165,183,962
Amortizimi i granteve gjatë vitit	(95,533,825)	(62,931,913)
Grante të marra gjatë vitit	119,589,388	53,323,807
GJENDJA MË 31 DHJETOR	1,179,631,419	1,155,575,856

18. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet me diferencat e përkohshme në mes të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe të shumave të përdorura për qëllime tatimi.

Tatimi i shtyrë llogaritet bazuar në normën tatimore të miratuar prej 15% (2022: 15 %).

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrime të shtyra tatimore	1,159,693,131	781,655,599
	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<i>Më 1 janar</i>	781,655,599	1,419,824,652
Regjistruar në të ardhurat gjithëpërfshirëse	775,711,496	
Përfshirë në rezultatin neto	(27,673,964)	(638,169,053)
<i>Më 31 dhjetor</i>	1,529,693,131	781,655,599

Lëvizjet në detyrimet e shtyra tatimore gjatë vitit janë si vijon :

	Aktive Afatgjata Materiale	Total
<i>Më 01 janar 2022</i>	1,419,824,652	1,419,824,652
Regjistruar në të ardhurat gjithëpërfshirëse		
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(638,169,053)	(638,169,053)
<i>Më 31 dhjetor 2022</i>	781,655,599	781,655,599
Regjistruar në të ardhurat gjithëpërfshirëse	775,711,496	775,711,496
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(27,673,964)	(27,673,964)
<i>Me 31 dhjetor 2023</i>	1,529,693,131	1,529,693,131

19. Parapagimet nga klientë

Parapagimet nga klientë analizohen si më poshtë:



Parapagimet nga klientë përfaqësojnë shërbime të faturuara në avancë ndaj shoqërisë SEE CAO për rezervim të drejtash transmetimi për muajin janar 2023 dhe të arkëtuara në dhjetor 2022.

31 DHJETOR 2022

260,796,227

20. Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra përfaqësojnë shërbime të faturuara në avancë ndaj shoqërisë SEE CAO për rezervim të drejtash transmetimi për muajin janar 2024.



31 DHJETOR 2023

218,103,124

31 DHJETOR 2022

87,472,993

21. Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	6,027,380,065	5,874,029,428
Të ardhura nga alokimet e kapaciteteve	2,507,858,138	1,829,594,040
Të ardhura nga disbalancat e energjisë	1,313,422,828	2,992,902,683
Të ardhura nga transmetimi ndërkufitar	16,369,638	8,256,706
Të ardhura nga transmetimi i të dhënave	39,964,610	39,084,894
Të ardhura nga grantet	95,533,824	62,931,913
Të tjera	84,034,670	56,235,477
TOTALI	10,084,563,773	10,863,035,141

22. Shpenzime për materiale

Shpenzime për materiale analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Materiale konsumi	62,079,020	71,929,497
Lendë djegëse	40,128,424	42,720,001
Të tjera	1,853,289	2,096,680
TOTALI	104,060,733	116,746,178

23. Kosto transmetimi

Kosto transmetimi analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzime të transmetimit ndërkufitar	377,555,076	230,801,768
Humbje teknike gjatë transmetimit	2,123,727,583	3,115,544,964
Shërbimet ndihmëse – KESH	806,239,242	534,923,836
TOTALI	3,307,521,901	3,881,270,568

OST i mban kostot që krijohen në formën e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit në kuadrin e modelit të tregut të energjisë që aplikohet nga viti 2008 e në vazhdim. Me vendim të ERE humbjet teknike gjatë transmetimit do të mbulohen nga OST përmes sigurimit të energjisë me çmimin e tregut përmes ankandeve të organizuara nga OST.

Me VKM Nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, duke filluar nga Muaji Korrik 2022, është percaktuar sigurimi i humbjeve të energjisë elektrike në transmetim nga ana e KESH sh.a. me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike. Referuar Vendimit të ERE Nr. 253, datë 21.12.2021, çmimi për vitin 2022 deri më datë 08.02.2023 është 8.5652lekë/kWh. Referuar Vendimit të ERE, Nr.27, Datë 16.02.2023, çmimi duke filluar nga data 09.02.2023 është 10 lekë/kWh. Prej datës 12.04.2023, me fillimin e operimit të ALPEX, OST sh.a. blen në bursë energjinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve duke u kompensuar nga KESH për diferencat çmimeve referuar kontratës përkatëse.

24. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Qira	10,808,286	10,728,139
Mirëmbajtje dhe riparime	164,162,269	153,024,603
Sigurime	16,205,159	14,789,295
Kërkime, trajnime dhe studime	75,417,243	44,589,396
Personel jashtë njësisë	234,359,301	175,757,930
Shpenzime për patenta, licenca	35,663,035	18,522,725
Publicitet, reklama	276,869	264,993
Transferime, udhëtime, dieta	18,609,630	22,610,144
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	11,758,757	12,454,944
Shpenzime për shërbimet bankare	1,928,120	1,784,374
Taksa dhe tarifa vendore	7,507,993	5,094,068
Taksa e regjistrimit	1,986,820	1,700,618
Tatime të tjera	70,950	37,662

Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	1,272,710	1,406,086
Gjoha dhe dëmshpërblime	239,336,807	229,776,167
Nxjerrje aktivesh jashtë përdorimit	-	118,153,737
Tarifa antarësimi	115,168,841	98,816,973
Shpenzime të tjera	96,950,523	21,853,795
TOTALI	1,031,483,313	931,365,649

Shpenzime për personel jashtë njësisë përfaqësojnë shpenzime të kryera për auditimin ligjor për certifikimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, shërbime vlerësimi, rritje kapitali si dhe shërbimi për ruajtjen fizike të aktiveve të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Vlerësim i asetëve dhe detyrimeve	1,860,000	1,900,000
Auditim i pasqyrave financiare nga auditues ligjorë caktuar nga MFE	5,700,000	5,750,000
Auditim i pasqyrave financiare nga shoqëri e pavarur audituese	1,250,000	1,250,000
Rritje kapitali e shoqërisë		3,620,000
Këshilli Mbikëqyrës	6,436,621	4,360,639
Shërbim konsulence dhe auditim për kontrollet e sigurisë	3,920,000	1,450,000
Vlerësim i aktiveve afatgjata materiale	48,510,000	20,790,000
Vlerësim i materialeve të nxjerra jashtë përdorimi		9,219,000
Anëtare të komisionit të posaçëm të shpronësimeve, akt ekspertime	450,000	250,000
Roje private	166,232,680	127,168,291
TOTALI	234,359,301	175,757,930

Vlerësimi i asetëve dhe detyrimeve është kryer për të dy vitet nga shoqëria Deloitte Albania procedurë e tenderuar nga OST sh.a. në bazë të kërkesave të Bankës Botërore dhe donatorëve të huaj.

Auditimi ligjor i pasqyrave financiare të vitit 2022 (shpenzim i vitit 2023) është kryer nga zj. Mirela Bushi, zj. Rajmonda Reveli, zj. Mimoza Ferzaj, z. Avni Tobli dhe shoqëria GMK Auditing përkatësisht me tarifën 1,140,000 lekë (pa tvsh) secili.

Auditimi i pasqyrave financiare nga një shoqëri e pavarur audituese (kusht i vendosur në marrëveshjet e huave afatgjata lidhur me Bankën Botërore dhe donatorë të huaj) për të dy vitet është kryer nga shoqëria Grant Thornton sh.p.k. procedurë e tenderuar nga OST.

Zmadhimet e kapitalit, gjatë vitit 2022, si rezultat i përfshirjes në kapital të fitimeve të pashpërndara dhe rezervave të tjera janë kryer nga zj. Vullnetare Hoxha dhe zj, Fatime Alliu përkatësisht me tarifat 1,770,000 lekë (pa tvsh) dhe 1,850,000 lekë (pa tvsh).

Vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale gjatë vitit 2022 dhe vitit 2023, është kryer nga grupi i ekspertëve të jashtëm të caktuar me Vendim të Asamblesë së Aksionarit Nr. 99 datë 15.09.2022 “Për rivlerësimin e asetëve të shoqërisë OST sh.a.". Grupi i ekspertëve përbëhet nga zj. Vullnetare Cela (Hoxha) dhe Studio Load sh.p.k. si vlerësues të certifikuar të pasurive të paluajjtshme; si dhe zj. Fatime Alliu, zj. Engjëllushe Rami, zj. Mimoza Cara, z. Egin Kocollari dhe z. Ilia Cece si auditues ligjorë , përkatësisht me tarifat 9,900,000 lekë (pa tvsh) secili.

Lidhur me këtë shërbim, gjatë vitit 2022 është paguar pagesa paraprake në formën e paradhënies në masën 30 % të vlerës së kontratës, përkatësisht 2,970,000 lekë (pa tvsh) secili ndërsa gjatë vitit 2023 pjesa e mbetur 70 % përkatësisht 6,930,000 lekë (pa tvsh) secili.

25. Shpenzime personeli

Shpenzime personeli analizohen si më poshtë ;

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Pagat dhe shpërblimet e personelit	816,843,009	831,711,646
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	161,803,035	161,348,095
Kompesime shpenzimesh për personelin	232,909,147	262,937,944
TOTALI	1,211,555,191	1,255,997,685

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2023 ishte 765 (31 dhjetor 2022: 790).

26. Provigjione/fshirje të llogarive

Provizionet për llogaritë e arkëtueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Provigjon i llogarive të arkëtueshme	(121,421,566)	123,298,001
TOTALI	(121,421,566)	123,298,001

27. Të ardhura dhe shpenzime financiare neto

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzime për interesa	(413,758,538)	(447,486,322)
Shpenzime financiare	(789,740)	(54,500,000)
Fitime neto nga kursi i këmbimit në aktivitetet financiare	2,264,916,627	1,380,081,432
Të ardhura nga interesat, kreditë dhe depozitat	6,809,240	769,247
TOTALI	1,857,177,589	878,864,357

Shpenzimet financiare të njohura nga Grupi gjatë viteve 2023 dhe 2022 lidhen me interesat për huatë. Shpenzimet e interesit lidhen me kostot për aktivet që janë gati për përdorimin e tyre të synuar.

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

OST e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Në vitin 2022 norma e tatimit mbi fitimin ishte 15 % e të ardhurës së tatueshme (2020: 15%).

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Tatimi mbi fitimin e periudhës	679,465,167	580,009,613
Tatimi i shtyrë mbi fitimin (Shënimi 17)	(27,673,964)	(638,169,053)
TOTALI	651,791,203	(58,159,440)

Në vijim jepet një rakordim i tatimit mbi fitimin i përllogaritur në bazë të normës së tatimit të aplikueshme ndaj shpenzimit të tatim fitimit:

	Norma	31 dhjetor 2023	Norma	31 dhjetor 2022
Fitimi para tatimit		6,146,008,704		827,191,172
Tatimi i përllogaritur me normën	15.2%	933,333,863	15.0%	131,881,189
Tatimi i përllogaritur për shpenzime të pazbritshme	2.2%	133,347,421	51.0%	448,128,424
Të ardhura të patatueshme		(387,216,117)		
SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN	11.1%	679,465,167	66.0%	580,009,613

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse taksa dhe interesa të tjera mund të jenë të detyrueshme.

Drejtimi beson se përllogaritjet e tij të detyrimeve tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet e hapura fiskale bazuar në vlerësimin prej tij të shumë faktorëve, përfshirë interpretimin e ligjit mbi tatimet dhe eksperiencat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në çmuarje dhe supozime dhe mund të përfshijnë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme.

Shoqëria mund të ndryshojë gjykim nën dritën e informacionit të ri që mundësohet, në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese. Këto ndryshime ndaj detyrimeve tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor gjatë periudhës në të cilën ky përcaktim bëhet.

29. Palët e lidhura

OST kontrollohet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit e Republikës së Shqipërisë, e cila zotëron 100 % të aksioneve të saj. Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet me palët e lidhura paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
(a) Shitje mallrash dhe shërbimesh		
OSHEE sh.a.	6,655,620,597	7,343,555,124
KESH sh.a.	332,627,429	400,308,876
	6,988,248,026	7,743,864,000
(b) Blerje mallrash dhe shërbimesh		
OSHEE sh.a.	90,497,264	240,388,348
KESH sh.a.	4,024,175,874	4,187,482,584
	4,114,673,138	4,427,870,932
(c) Shpërblimi i drejtuesve kryesorë		
Paga dhe shpërblime të tjera afat-shkurtra për punonjësit	57,638,438	56,247,885
Këshilli Mbikëqyrës	6,436,620	4,360,639
	64,075,058	60,608,524
(d) Balancat e fund-vitit me palët e lidhura		
Autoritetet fiskale (TVSH)	86,057,567	296,948,239
OSHEE sh.a.	18,196,330,299	17,639,904,788
KESH sh.a.	135,909,127	50,386,174
	18,418,296,993	17,987,239,201

(e) Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
KESH sh.a.	9,953,562,150	9,021,606,377
OSHEE sh.a.	949,142,661	841,098,123
Autoritetet fiskale (tatim mbi të ardhurat personale)	7,754,354	11,088,231
Autoritetet fiskale (sigurime shoqërore)	23,370,834	23,115,761
Autoritetet fiskale (tatim në burim)	829,062	1,025,576
Autoritetet fiskale (tatim fitimi)	173,778,953	329,317,985
	11,108,438,014	10,227,252,053
(f) Kredi dhe hua dhënë palëve të lidhura		
ALBGAZ	20,000,000	20,000,000
	20,000,000	20,000,000
(g) Kredi dhe hua nga palë të lidhura		
KESH sh.a.	8,917,425,282	9,537,323,911
Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Shqipërisë	16,124,768,613	19,024,149,102
	25,042,193,895	28,561,473,013

Huatë e marra nga OST sh.a. janë garantuar nga Qeveria e Shqipërisë.

30. Detyrime të mundshme

Në rrjedhën normale të biznesit, shoqëria ka hasur në kërkesa ligjore dhe gjyqësore; Drejtimi konsideron se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet e tjera të mbetura deri më 31 dhjetor 2023. Bazuar në kontratën Nr. 1008 datë 02.02.2018 “Marrëveshja për trajtimin e të drejtave dhe detyrimeve të OST Security Sha” ndërmjet Shoqërisë OST sh.a. dhe OST Security, OST ka detyrime të kushtëzuara lidhur me pretendimet për proceset e vazhdueshme ligjore kundër OST Security sh.a. në shumën 22,466,500 lekë (2022: 22,902,500 lekë).

Më 31 dhjetor 2023, OST kishte angazhime në shumën 4,251,183 mijë lekë (2022: 4,274,769 mijë lekë) lidhur me projektet për ndërtimin e asetëve për transmetimin e energjisë.

31. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të cilat do të kërkonin korrigjim të pasqyrave financiare të ndodhura midis datës së raportimit 31 dhjetor 2023 dhe datës së autorizimit të këtyre pasqyrave financiare.

